

## NË EMËR TË POPULLIT

## REPUBLIKA E KOSOVËS

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Afërdita Bytyçi, kryetare e trupit gjykues, dhe gjyqtarët profesionist Arben Hoti dhe Lindita Jakupi, anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Fairije Beha, në çështjen penale kundër të akuzuarve: M. K. për shkak të dy veprave penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, Xh. K. për shkak të dy veprave penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, H. R. për shkak të dy veprave penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe një veprë penale, Mashtrimi në detyrë nga neni 426 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, E. S. për shkak të veprës penale, Mashtrimi nga neni 335 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, S. K. për shkak të veprës penale, Mashtrimi nga neni 335 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, N. G. për shkak të dy veprave penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, R. H. për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, B. P. për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, B. A. për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Mashtrimi nga neni 335 par.5 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, Sh. K. për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Mashtrimi nga neni 335 par.5 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, B. K. për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Mashtrimi nga neni 335 par.5 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, H. D. për shkak të veprës penale, Mashtrimi në detyrë nga neni 426 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, dhe veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, A. S. për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe A. P., për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, të akuzuar nga Prokuroria Speciale e Kosovës, më aktakuzën, PPS.nr.136/2014, datë 08.05.2015, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, të mbajtura në prezenc të prokurorit special Agron Bajrami, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar av.N. M. sipas autorizimit, të akuzuarve M. K. dhe mbrojtësit e tij av. F. I. dhe av. R. D. H. R. dhe mbrojtësi i tij av. N. S., E. S. dhe mbrojtësi i tij av. E. K., N. G. dhe

mbrojtësi i tij av. F P , R H dhe mbrojtësja e tij av. H A ,  
Sh K dhe mbrojtësi i tij av. S M , B K dhe mbrojtësi i tij av.  
B J , A P dhe mbrojtësi i tij av. G B , H D , A S ,  
B P dhe B A , me datë 19.05.2017, mori dhe shpalli publikisht këtë:

## AKTGJYKIM

### I

Të akuzuarit:

- 1. M K** , i biri i Xh dhe nënës H , e gjinisë D , i lindur me dt , në fshatin S , Komuna e O , tani me vendbanim në O , në rrugën “ ” pn, ka të kryer Fakultetin e Xehtarisë, i martuar, baba i 4 fëmijëve, punon si profesor në K privat H në F , i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. Xh K** , i biri i S dhe nënës A , e gjinisë S , i lindur me dt. në fshatin B Komuna e O , ku edhe tani jeton, me profesion Gjeodet, ka të përfunduar shkollën e mesme të gjeodezise, i martuar baba i 5 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 3. H P** i biri i Z dhe nënës A , e gjinisë B , i lindur me dt. në fshatin K , Komuna e C , me vendbanim në P , lagja “ ”, rruga “ ”, Llamella , hyrja nr. , ka të kryer Fakultetin e Ndërtimarisë dhe Artikuturës-sektori i ndërtimarisë, me profesion Inxhinier i ndërtimarisë, punon si ingjnier me angazhim privat, i martuar baba i 2 fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 4. N G** , i biri i A dhe nënës H , e gjinisë R , i lindur me dt. në fshatin S , tani me vendbanim në F -K , rruga “ ”, Objekti-C , Llamella , hyrja , i martuar, baba i 5 fëmijëve, ka të kryer Fakultetin e Ndërtimarisë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 5. R H** , i biri i L dhe nënës Z , e gjinisë R , i lindur me dt. , në O , ku edhe jeton, në O e V , rruga “ ”, nr. , ka të kryer Fakultetin Ekonomik, me profesion Inspektor i ndërtimit, i martuar , baba i 4 fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 6. B P** , i biri i M dhe nënës H , e gjinisë H , i lindur me dt. në fshatin C , Komuna e O , ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme , i martuar, baba i dy fëmijëve, gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

7. H D , e bija e M dhe B , e gjinisë Z , i lindur me dt. në fshatin S e P , Komuna e V , tani me vendbanim në O , rruga “ ” nr. , e martuar, nënë e 2 fëmijëve, ka të kryer Fakultetin e Artitekturës, e gjendjes së mesme ekonomike, e pa punë, Shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

8. A S , i biri i N dhe nënës N e gjinisë P , i lindur me dt. në fshatin P , Komuna e P , tani me vendbanim në P , lagja “ ”, rruga “ ”, nr. , ka të kryer shkollën e lartë ekonomike, i pa punë, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

9. A P , i biri i A dhe nënës H , e gjinisë Th , i lindur me dt. në fshatin H , Komuna e O , me vendbanim në F K , rruga “ ” nr. , ka të kryer Fakultetin Teknik, i pa punë, i martuar, baba i 2 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së,

## LIROHEN NGA AKTAKUZA

Sepse

**I. Të akuzuarit M K , Xh K dhe H R ,**

Në periudhën kohore në mes të datës 27.08.2012 deri me 24.11.2012 si persona zyrtar, më saktë i akuzuari M K si person zyrtar në cilësi të k të k së O , i pandehuri Xh K në cilësinë e organit mbikëqyrës për realizimin e projektit “A i rrugës në B – Lagja K ” në gjatësi L=1650m, dhe i akuzuari H R gjatë muajit Prill të vitit 2013 në cilësinë e personit zyrtar i ngarkuar me detyrë si m i p për realizimin e projektit “Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në B – Lagja K dhe asfaltimi i rrugës në fshatin K ” me numër të prokurimit , ku të pandehurit e lartcekur në bashkë kryerje duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar kanë vepruar jashtë autorizimeve zyrtare dhe jashtë kompetencave të tyre reale, në atë mënyrë që me dashje direkte dhe me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie, O “D I ” Sh.p.k. me pronar E S , të pandehurit e lartcekur i tejkalojnë kompetencat e tyre si dhe nuk i përmbushin detyrat e tyre zyrtare, ku si pasojë kompanisë “D I ” Sh.p.k. i kanë sjellë dobi materiale në shumën 18,683.54 €, dhe me këtë i shkaktojnë dëm të madh Buxhetit të Kosovës, me saktë Komunës së Obiliqit,

1. I akuzuari M K ka urdhëruar verbalisht të pandehurin Xh K që të veprojë jashtë kontratës “Asfaltimi i rrugës në B – Lagja K ” në gjatësi prej L=1650m, më saktë ka kërkuar që i njëjti si organ mbikëqyrës të kërkojë nga O “D

I ” që të shtroj edhe 250 metra rrugë më shumë se sa ishte paraparë me kontratën me gjatësi prej 1650 metra, ndërsa me pas kjo pjesë prej 250 metra shtesë do të mbulohet me Kontratën e ardhshme me titull “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në B – Lagja K dhe asfaltimi i rrugës në fshatin K ” me numër të prokurimit

2. I akuzuari Xh K në bazë të vendimit Nr. të dt. 27.08.2012 i caktuar si organ mbikëqyrës për realizimin e projektit “Asfaltimi i rrugës në B – Lagja K ” në gjatësi prej L=1650m, sipas kontratës së lidhur ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe O “D I ” Sh.p.k. me seli në P me numër të kontratës të dt. 22.08.2012, në atë mënyrë që i pandehuri Xh K , duke vepruar sipas urdhrit verbal të pandehurit M K , ka kërkuar që të kryhen punimet shtesë nga Operatori Ekonomik i lartcekur edhe për 250 metra tjera, jashtë kontratës së lartcekur;

3. I akuzuari H R me rastin e caktimit si M i P “ Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në B – Lagja K ” e ka ditur se 250 metra rrugë në Lagjen K ishin punuar/kryer jashtë kontratës “Asfaltimi i rrugës në B – Lagja K ” dhe i njëjti pranon që këto 250 metra të pranohen zyrtarisht në kuadër të projektit tjetër në të cilin ky ishte caktuar si menaxher i projektit, dhe te njëjtat i pranon si punë të mbikëqyruar nga ai duke përpiluar raportin e dt. 16.04.2013 “raport i punëve të kryera”, se kinse kjo rrugë është e përfshirë në kuadër të projektit në të cilin është caktuar si menaxher i projektit , -

- me këtë kishin për të kryer veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

## II. I akuzuari H R ,

Se në periudhën kohore nga muaji Prill 2013 deri në muajin shtator 2013 si persona përgjegjës, në cilësinë e personit zyrtar në Komunën e O , i ngarkuar me detyrë si M i P për realizimin e projektit të lartcekur, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për O “D I ” bënë përpilimin e rremë të raporteve mbi punët e kryera, raporteve të pranimit, duke e vënë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesave të kundërligjshme, në atë mënyrë që i pandehuri i lartcekur, personit përgjegjës në kuadër të drejtorisë kompetente pranë Komunës së O i dorëzon raportet e përpiluara dhe nënshkruara nga ana e tij, se kinse O “D I ” punët i ka kryer në përputhje me pikat e përcaktuara në kontratë, ku për rrjedhojë nga ekspertizat laboratorike të punuara nga laboratorit I ë cekura më lartë ka rezultuar se punët janë kryer në kundërshtim të plotë me kushtet e përcaktuara me kontratë, me ç ‘rast të pandehurit e lartcekur i kanë shkaktuar dëm të madh Komunës së Obiliqit, gjegjësisht Buxhetit të Kosovës, e në këtë rast përfitim të kundërligjshëm O “D I ”, lidhur me projektin e lartë cekur në shumë të përgjithshme prej 44,954.53 € , -

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale, Mashtrimi në detyrë nga neni 426 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

### III. Të akizuarit N G , R H dhe B P ,

Me datën 09.10.2013 si persona zyrtar, të cilët ishin caktuar përgjegjës në cilësinë e anëtarëve të komisionit për pranim teknik, në bazë të Vendimit Nr. të dt. 04.10.2013, lidhur me pranimin e projektit final "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në B – Lagja K dhe asfaltimi i rrugës në fshatin K" sipas Kontratës së lidhur me datë 03.12.2012, ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe O "D I" me nr. të Prokurimit , ashtu që të pandehurit e lartcekur duke vepruar në bashkëkryerje kanë shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, të përcaktuara në vendimin e lartcekur, me dashje direkte dhe me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie O "D I" me pronar E S , në atë mënyrë që të njëjtit përpilojnë raportin e datës 09.10.2013, me titull "raporti përfundimtar i komisionit" se kinse ky O i lartcekur i ka kryer punë sipas kontratës, i cili raport ka rezultuar që të jetë në kundërshtim me pikat e përcaktuara në kontratë, më saktë gjendjen faktike të punëve të kryera nga O i lartcekur, e që vërtetohet nga raportet e ekspertizës laboratorike nga laboratorit I , ashtu siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të kësaj aktakuze,-

- me këtë kishin për të kryer veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

### IV. E akuzuara H D ,

Në periudhën kohore në mes të datës 24.05.2013 deri me 19.08.2013 si persona përgjegjës, e akuzuara H D në cilësinë e personit zyrtar në Komunën e O , e ngarkuar me detyrë si menaxhere e projektit për realizimin e projektit, sipas kontratës dhe aneks kontratës "Asfaltimi i rrugëve rurale" me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për O "B C" bënë përpilimin e rremë të raporteve mbi punët e kryera, raporteve të pranimit, duke e vënë në lajthim personin e autorizuar zyrtar që të kryej pagesa të kundërligjshme, në atë mënyrë që e pandehura e lartcekur, personit zyrtar në kuadër të drejtorisë kompetente pranë Komunës së O i dorëzon raportet e përpiluara dhe nënshkruara nga ana e saj, se kinse O "B C" punët i ka kryer në përputhje me pikat e përcaktuara në kontratë dhe aneks kontratë, ku për rrjedhojë nga ekspertizat laboratorike të punuara nga laboratorit I të cekura më lartë ka rezultuar se, punët janë kryer në kundërshtim të plotë me kushtet e përcaktuara me kontratë dhe aneks kontratë, me ç'rast të pandehurit e lartcekur i kanë shkaktuar dëm në shkallë të madhe Komunës së Obiliqit, gjegjësisht Buxhetit të Kosovës, e në këtë rast përfitim të kundërligjshëm O "B C", lidhur me projektin e lartcekur në shumë të përgjithshme prej 157,942.53€,-

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale, Mashtrimi në detyrë nga neni 426 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

### V. Të akuzuarit H R , N G dhe Xh K ,

Me datën 20.08.2013 si persona zyrtar, të cilët ishin caktuar me detyra në cilësinë e anëtarëve të komisionit për pranim teknik, në bazë të Vendimit Nr. [redacted] të dt. 20.08.2013, lidhur me pranimin e projektit final "Asfaltimi i rrugëve rurale", sipas kontratës së lidhur me datë 24.05.2013, ndërmjet Komunës së O [redacted] dhe O "B C [redacted]", me nr. të Prokurimit [redacted] dhe sipas aneks kontratës së datës 15.08.2013, ashtu që të pandehurit e lartcekur duke vepruar në bashkëkryerje kanë shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar duke mos i përmbushur detyrat zyrtare të përcaktuara në vendimin e lartcekur, me dashje direkte dhe me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie O "B C [redacted]" me pronar B A [redacted], në atë mënyrë që të njëjtit përpilojnë raportin e datës 20.08.2013, me titull "raporti i komisionit për pranim teknik të projektit (asfaltimi i rrugëve rurale)" se kinse ky O [redacted] i lartcekur i ka kryer punë sipas kontratës dhe aneks kontratës, i cili raport ka rezultuar që të jetë në kundërshtim me pikat e përcaktuara në kontratë dhe aneks kontratë, më saktë gjendjen faktike të punëve të kryera nga O [redacted] i lartcekur, e që vërtetohet nga raportet e ekspertizës laboratorike nga laboratorit I [redacted], ashtu siç është përshkruar në pikën IV të dispozitivit të aktakuzës,-

- me këtë kishin për të kryer veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

#### VI. Të akuzuarit H D [redacted], A S [redacted], M K [redacted] dhe A P [redacted],

Me datë 15.08.2013, është lidhur aneks kontrata me numër të prokurimit [redacted], si pjesë e kontratës bazë të dt. 24.05.2013 me titull "Asfaltimi i rrugëve rurale" ndërmjet Komunës së O [redacted] dhe O "B C [redacted]", me pronar B A [redacted], në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, Neni 35.2.4 (i) dhe (ii), si dhe dispozitave të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, pasi që ka rezultuar se punët që veç kishin qenë të përcaktuara në kushtet e kontratës bazë sipas para masës dhe para llogarisë, të njëjtat parashihen edhe në aneks kontratë më saktë para masa dhe para llogaria, dhe në këtë rast nuk ka lindur ndonjë punë e pa parashikuar me kontratën bazë e as nevoja për material shtesë, ashtu që të pandehurit e lartcekur kanë kontribuar në bashkë kryerje duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar kanë vepruar jashtë autorizimeve zyrtare dhe jashtë kompetencave të tyre reale, me dashje direkte dhe me qëllim që t'i mundësohet O "B C [redacted]" Sh.p.k me pronar B A [redacted], që të përfitoj në mënyrë të kundërligjshme dobinë pasurore prej 7,710.00 € dhe për pasojë të lartcekurit i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm Komunës së Obiliqit, gjegjësisht Buxhetit të Kosovës, në shumë si më lartë, e krejt kjo vërtetohet edhe nga ekspertiza e ekspertit financiar,

1. E akuzuar H D [redacted] person zyrtar, e caktuar me detyrë si M [redacted] e P [redacted] për realizimin e projektit "Asfaltimi i rrugëve rurale" me qëllim që t'i mundësoj përfitimin e dobisë pasurore në shumën si më lartë për personin tjetër, me saktë O "B C [redacted]" me pronar B A [redacted], paraqet dy kërkesat e datës 02.07.2013 të protokolluara me datë 02.08.2013 me të cilat iu drejtohet të pandehurve të lartcekur për aprovimin e punëve shtese, e të cilat kërkesa ishin të aprovuara (në mënyrë të kundërligjshme) nga i pandehuri M K [redacted], po ashtu e pandehura H D [redacted], punoi edhe para masat dhe parallogarit e punëve shtesë të cilën e ka drejtuar për miratim të i pandehuri A S [redacted], edhe pse të njëjtat ishin në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura dhe gjendjen faktike,

2. I akuzuari A S person zyrtar në cilësinë e D të P.N.K.Z. pranë Komunës së O , ka bërë nënshkrimin e kërkesës për aprovimin e punëve shtesë të dt. 02.07.2013 e protokolluar me datë 02.08.2013 dhe miratimin e para masës dhe para llogarisë së punëve shtesë të muajit korrik 2013, të cilat ja kishte drejtuar për nënshkrim dhe miratim e pandehura H D edhe pse e njëjta ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura dhe gjendjen faktike,
3. I akuzuari M K person zyrtar në cilësinë e K të K së O , gjegjësisht si zyrtar administrativ ( ) në këtë organizatë buxhetore (komunë) duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, neni 10 dhe Rregulla Financiare e Thesarit Nr. 01/2010, neni 3 dhe neni 4, par.1, me qëllim që t'i mundësoj përfitimin e dobisë pasurore në shumën si më lartë për personin tjetër, me saktë O "B C " me pronar B A , ka aprovuar dy (2) kërkesa që mbajnë datën 02.07.2013 të protokolluara me datë 02.08.2013 të paraqitura për aprovimin e punëve shtesë edhe pse të njëjtat ishin në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura dhe gjendjen faktike,
4. I akuzuari A P person zyrtar, në cilësinë e M të zyrës së P , pranë Komunës së O , ka bërë nënshkrimin e aneks kontratës të dt. 15.08.2013, duke vepruar sipas kërkesës së të pandehurës H D , e cila kërkesë ishte aprovuar nga i akuzuari M K dhe nënshkruar nga i akuzuari tjetër A S , edhe pse e njëjta ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura dhe gjendjen faktike, -

- me këtë kishin për të kryer veprën penale, **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Shpenzimet e procedurës penale paguhën nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 454 par.1 të KPPRK-së

E dëmtuara Komuna e Obiliqit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil konform nenit 463 par.3 të KPPRK-së.

## II

Të akuzuarit:

1. E S i biri i B dhe nënës Sh , e gjinisë V , i lindur me dt. në fshatin H , Komuna e F , ku edhe jeton, rruga " " nr. , i martuar, baba i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollen e mesme të ndërtimarisë, i gjendjes se mesme ekonomike, pronari i kompanis " " Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. S K i biri i G dhe nënës N , e gjinisë K , i lindur me dt. në R , Komuna e P , Republika e S , tani me vendbanim në P ,

rruga“ ” nr. , i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer Fakultetin e Ndertimarise, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3. B A i biri i Z dhe nënës H , e gjinisë Q , i lindur me dt në Gjilan, ku edhe tani jeton, rruga “ ” nr. , ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, me profesion menaxher i ndërtimit , i martuar, baba i 2 fëmijëve, pronare i kompanis “B C ”, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

4. Sh K i biri i N dhe H e gjinisë K , i lindur me dt. në fshatin S , Komuna e O , tani me vendbanim në P , rruga “ ” , i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në kompanin private-ndërtimore “ ” në S , gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

5. B K biri i B dhe nënës Xh , e gjinisë S , i lindur me dt. në fshatin R , Komuna e Gj , tani me vendbanim në rrugën “ ( ” nr. Gj , i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, pronar i kompanisë “ ”, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 365 të KPPRK-së,

## JANË FAJTORË

Sepse

### I. Të akuzuarit E S dhe S K ,

Në periudhën kohore nga muaji Prill 2013 deri në muajin shtator 2013 si persona përgjegjës, gjegjësisht i pandehuri E S në cilësinë e pronarit të Operatorit Ekonomik “D I ” Sh.p.k dhe S K në cilësinë e menaxherit përgjegjës pranë G “D I ” Sh.p.k për realizimin e projektit “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në B – Lagja K dhe asfaltimit i rrugës në fshatin K ” sipas Kontratës së lidhur ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe OE “Delta ING” me datë 03.12.2012, me numër të Prokurimit , me çmim në shumën prej 44,954.53 €, me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për organizatën e biznesit C “D I ” me anë të paraqitjes së rreme të fakteve si dhe duke i fshehur faktet e sjellin në lajthim personin tjetër, më saktë personin zyrtarë në kuadër të drejtorisë kompetente pranë Komunës së O që të veprojë në dëm të pasurisë së saj, përkatësisht Buxhetit të Kosovës që rezulton me dëm të madh në vlerë prej 26,270.75 €, në atë mënyrë që të pandehurit e lartcekur duke vepruar me dashje direkte, e në bashkëkryerje, në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratën e dt. 03.12.2012 me titull “Vazhdimi i



asfaltimit të rrugës në B. - Lagja K ” me Nr. të Prokurimit , më saktë te lartcekurit duke mos i kryer punimet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, ku në bazë të raporteve të ekspertizës laboratorike nga laboratorit I të ekzaminimit të cilësisë së rrugëve të punuara nga O i lartë cekur, ka rezultuar se trashësia e Zhavorrit është 7.18 cm, kurse në bazë të kontratës është dashur të jetë së paku 25 cm, ndërsa mesatarja e trashësisë së asfaltit ka rezultuar të jetë 4.72 cm, kurse në bazë të kontratës është dashur të jetë 8 cm, kurse kompaktësia mesatare e këtyre rrugëve ka rezultuar të jetë 95.93% e që është nën minimumin e lejuar 97%, me ç ‘rast të pandehurit e lartcekur i kanë shkaktuar dëm të madh Komunës së Obiliqit, gjegjësisht Buxhetit të Kosovës, e në këtë rast përfitim të kundërligjshëm O “D I ”, lidhur me projektin e lartë cekur në shumë të përgjithshme prej 44,954.53 €,-

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Mashtrimi nga neni 335 par. 3 lidhur me par. 1, si dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

## II. Të akuzuarit B A , Sh K dhe B K ,

Në periudhën kohore në mes të datës 24.05.2013 deri me 19.08.2013 si persona përgjegjës, më saktë i pandehuri E A në cilësinë e pronarit të Operatorit Ekonomik “B C ” Sh.p.k. fitues formal i tenderit, i pandehuri Sh K në cilësinë e personit përgjegjës pranë O “B C ” Sh.p.k në pozitën Inxhinier përgjegjës për realizimin e projektit “Asfaltimi i rrugëve rurale” dhe i pandehuri B K pronar i kompanisë “B C ” në cilësinë e nën-kontraktorit të kundërligjshëm të fituesit formal të tenderit të cekur si më lartë, më saktë si kryerës faktik i punimeve në këtë projekt, ashtu që te pandehurit e lartcekur duke vepruar sipas kontratës së lidhur ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe O “B C ” me datë 24.05.2013, me numër të Prokurimit , me çmim në shumën prej 150,232.53 € si dhe sipas aneks kontratës se dt. 15.08.2013, me çmim në shumë prej 7,710.00 €, me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për, organizatën e biznesit O “B C ” me anë të paraqitjes së rreme të fakteve si dhe duke i fshehur faktet e sjellin në lajthim personin tjetër, me saktë personin zyrtar në kuadër të drejtorisë kompetente pranë Komunës së Obiliqit, që të veprojë në dëm të pasurisë së saj, përkatësisht Buxhetit të Kosovës që rezulton me dëm në shkallë të madhe në shumën prej 157,942.53€ (150,232.53€ + 7,710€), në atë mënyrë që të pandehurit e lartcekur duke vepruar me dashje direkte, e në bashkëkryerje në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratën dhe aneks kontratën e lartcekur, për më tepër i pandehuri B K udhëzon mbikëqyrësin e këtyre punimeve të pandehurin Sh K duke i dërguar disa herë mesazhe elektronike (SMS) që shtresën e asfaltit ta shtroj në trashësi prej 4.5 cm, e jo ashtu siç është parapare në bazë të kriterëve të përcaktuara në kontratë dhe aneks kontratë, më saktë të lartcekurit duke mos i kryer punimet sipas kushteve të përcaktuara në atë kontratë dhe aneks kontratë, ku në bazë të ekspertizës laboratorike nga laboratorit I të ekzaminimit të cilësisë së rrugëve të punuara nga ky Operator, ka rezultuar se mesatarja e trashësisë së zhavorrit është 6.40 cm, kurse në bazë të kontratës është dashur të jetë së paku 20-30 cm, ndërsa mesatarja e trashësisë së asfaltit ka rezultuar të jetë 4.94 cm, kurse në bazë të kontratës është dashur të jetë 8 cm, ndërsa kompaktësia mesatare e këtyre rrugëve ka rezultuar të jetë 92.28% e që është nën minimumin e lejuar 97%, me ç ‘rast të pandehurit e lartcekur i kanë shkaktuar dëm në shkallë të madhe Komunës së Obiliqit, gjegjësisht Buxhetit të Kosovës, e në

këtë rast përfitim të kundërligjshëm O “B C”, lidhur me projektin e lartcekur në shumë të përgjithshme prej 157,942.53€,-

- **Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Mashtrimi nga neni 335 par. 5, lidhur me par. 3 dhe par. 1, si dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform dispozitave të cekura më lartë dhe neneve 2,4,41,46,47,50,51 lidhur me 45, 52, 73,74 dhe neni 335të KPRK-së, dhe neneve 359, 365, 366, 368, 450, 452 dhe 463 të KPPRK-së, i

### GJYKON

1.Të akuzuarin E S më dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhes verifikuese prej 2 (dy) vitesh nuk kryen vepër tjetër penale.

2.Të akuzuarin S K më dënim më burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhes verifikuese prej 2 (dy) vitesh nuk kryen vepër tjetër penale.

3.Të akuzuarin B A më dënim më burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhes verifikuese prej dy (2) vite nuk kryen vepër tjetër penale, dhe me dënim më gjobë në shumë prej 4000 € (katërmijë euro), të cilën gjobë duhet paguar pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

4.Të akuzuarin S K më dënim më burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhes verifikuese prej dy (2) vite nuk kryen vepër tjetër penale, dhe me dënim më gjobë në shumë prej 4000 € (katërmijë euro), të cilën gjobë duhet paguar pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

5.Të akuzuarin B K me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhes verifikuese prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale, dhe me dënim më gjobë në shumë prej 3000 € (tremijë euro), të cilën gjobë duhet paguar pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 46 par.2 dhe 3 të KPRK-së, obligohen të akuzuarit që dënimin me gjobë t'a paguajnë, pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, nëse të njëjtit nuk e paguajnë gjobën, gjykata mund t'a zëvendësojë dënimin më gjobë në dënim më burgim, duke ju llogaritur një ditë burgim më 20 euro gjobë.

Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor, secili veç e veç, shumën prej nga 100 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuar, Komuna e Obiliqit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil, konform nenit 463 par.2 të KPRK-së.

## Arsyetim

-I-

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritë aktakuzën, PPS.nr.136/2014, datë 08.05.2015, kundër të akuzuarve: M K për shkak të dy veprave penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, Xh K për shkak të dy veprave penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, H R për shkak të dy veprave penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe një veprë penale, Mashtrimi në detyrë nga neni 426 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, E S për shkak të veprës penale, Mashtrimi nga neni 335 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, S K për shkak të veprës penale, Mashtrimi nga neni 335 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, N G për shkak të dy veprave penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, R H për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, B P për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, B A për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Mashtrimi nga neni 335 par.5 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, Sh K për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Mashtrimi nga neni 335 par.5 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, B K për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Mashtrimi nga neni 335 par.5 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, H D , për shkak të veprës penale, Mashtrimi në detyrë nga neni 426 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, dhe veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, A S për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe A P , për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me dt.02.11.2015, dhe pas leximit të aktakuzës i akuzuari B K e ka pranuar fajësinë, për veprën penale në bashkëveprim, Mashtrimi nga neni 335 par.5 par.3 dhe 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, ndërsa të akuzuarit tjerë nuk e kanë pranuar fajësinë. Meqenëse të akuzuarit tjerë të përfshirë në këtë çështje penale nuk kanë pranuar fajësinë lidhur me veprat penale për të cilat akuzohen, Gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Prokurori i Prokurorisë Speciale Agron Bajrami, pas përfundimit të procedurës së provave, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit Xh. K., M. K., H. R., A. P., A. S., B. A., B. K., H. D., R., H., S. K., Sh. K. dhe E. S. kanë kryer veprat penale të përshkruara si në dispozitivet e aktakuzës. Më tutje ka shtuar se kjo gjendje faktike, u vërtetua nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe atë nga raporti i ekspertizës së "I" datë 11.03.2014 është vërtetuar se për dallim nga kontratat e lidhura dhe aneks kontrata sipas të cilave mesatarja e trashësisë së zhavorrit do duhej të ishte së paku 20-30 cm, ka rezultuar që mesatarja e trashësisë së zhavorrit ishte 6.40 cm, ndërsa sipas kontratave trashësia e asfaltit duhej të ishte 8 cm, e që sipas ekspertizës rezulton të jetë 4.94 cm, ndërsa që kompaksia mesatare e këtyre rrugëve sipas ekspertizës rezulton të jetë 92.28 % e që është nën minimumin e lejuar 97 % të përcaktuar me kontratë. E po ashtu nga raporti plotësues i ekspertizës së "I" dt. 12.01.2015 rezulton se të gjitha rrugët e shtruar në bazë të kontratave dhe aneks kontratës, të lidhura nga autoritet kontraktues dhe këta operator ekonomik (tani e tutje OE) "D" dhe "B C" mund të konsiderohen si dëm, meqenëse asnjë nga rrugët nuk është shtruar në përmbushja të kushteve të parapara në kontrata dhe aneks kontratë. Më tutje ka shtuar se nga fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes vërtetohet se gjendja faktike e rrugëve të shtruara nga OE është në kundërshtim me kontratat dhe aneks kontratën. Po ashtu ka shtuar se nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar dt.15.10.2014 vërtetohet se aneks-kontrata e lidhur në mes të autoritetit kontraktues KK-Obiliq dhe OE "B C" nuk ka mbështetje ligjore dhe është në kundërshtim me nenin 35 par. 2 nënpar.4 pika i dhe ii të Ligjit të Prokurorimit Publik nr. 04L /L-042 (tani e tutje LPP), duke shtuar njëherit se punimet e kryera nga OE "D I" në segmentin K në gjatë prej L-250 metra, janë realizuar pa u lidhur fare kontratë dhe pa u zbatuar dispozitat të parapara me ligj. Gjithashtu ndryshe nga konstatimet e komisioneve teknike të themeluara nga autoriteti kontraktues Komuna e Obiliqit sipas të cilave implementimi i kontratave është kryerë në mënyrë profesionale dhe në harmoni me rregullat teknike të ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore, të dy projektet e lartë cekura për të cilat punimet i ka kryer OE "B C" nga Gj. lidhur me projektin "Vazhdim i asfaltimit të asfaltit të fshatit B - lagjia", dhe projektin tjetër "Asfaltimi i rrugës i fshatit K", për të cilën punimet i ka kryer OE "D -I" nga P, nuk janë implementuar në përputhje me kriteret e caktuara në kontratë. Me tutje ka shtuar se nga transkriptet për masat e fshehta të regjistrimit të bisedave telefonike tregojnë se i pandehuri B K, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarin S. K., dhe se i njëjti në vazhdimësi ka qenë i përfshirë si nënkontraktues i kundërligjshëm duke marr pjesë aktive në punimet e zhvilluara nga OE "B C", si fitues formal i tenderit, e po ashtu nga këto transkripte rezulton se i pandehuri B K, në vazhdimësi i ka dhënë instruksione të akuzuarit Sh. K., lidhur me trashësinë e zhavorrit dhe asfaltit që duhet shtruar në ato rrugë, dhe se në cilat pjesë të rrugës trashësia e zhavorrit dhe asfaltit duhet të jetë në përputhje me kushtet e kontratës e që nga ato pjesë edhe do merreshin mostrat lidhur me vlerësimin e përmbushjes të projekteve në pajtim me kontratën. Prandaj, në këtë gjendje të vërtetuar faktike, ka propozuar që të gjithë të akuzuarit të shpallen fajtor dhe duke marrur parasysht rrethanat rënduese dhe lehtësuese të dënohen sipas ligjit.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës - Komuna e Obiliqit, av. N M në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale kundër të akuzuarve dhe ushtron kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësit e të akuzuarit M K, av.F L dhe R D në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, kanë deklaruar se nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe nga provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor në asnjë mënyrë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tyre ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar. Më tutje kanë shtuar se nga provat e propozuara nga prokuroria e të administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tyre ka ndërmarrur ndonjë veprim inkriminues që kishte për të formësuar figurën e veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 i KPRK-së, pasi që nga provat e administruara, organi i akuzës nuk ka arritur të argumentoj formën e keqpërdorimit të pozitës zyrtare nga i mbrojturi i tyre, qoftë përmes ndërhyrjes së drejtpërdrejtë në procedurën e prokurorimit apo ushtrimit të ndikimit gjatë zhvillimit të kësaj procedure, ndërsa që nga mendimi i Komisionit Rregullativë të Prokurimit Publike (tani e tutje KPPRK) nr.183/15 të dt.30.11.2015 të administruar në cilësinë e provës në këtë çështje penale vërtetohet se i mbrojturi i tyre, në veprimet e bëra, nuk ka shkelur ndonjë dispozitë të LPP-së dhe se kjo provë e siguruar me kërkesën e mbrojtjes nuk është kundërshtuar nga organi i akuzës, mirëpo nga i njëjti është pretenduar se është e panevojshme që të administrohet në cilësinë e provës. Më tutje kanë shtuar se edhe nga dëgjimi i dëshmitarit A K në shqyrtim gjyqësor dhe leximi i deklaratës se dëshmitarit N M të dhënë në prokurori, i mbrojturi i tyre nuk përmendet fare në funksion të veprave penale për të cilat akuzohet, ndërsa që i akuzuari Xh K në shqyrtim gjyqësor e ka mohuar se ka pranuar ndonjë urdhër nga i akuzuari M K lidhur me shtrimin e rrugës në gjatësi prej 250m në fshatin B -lagja K, dhe se deklaratimet e tij në procedurën paraprake siç ka theksuar vetë janë rrjedhojë e presionit që i është bërë, e po ashtu të njëjtat nuk mund të referohen në cilësinë e provës meqenëse sipas nenit 123 par.5 të KPPK-së, deklaratat e të akuzuarit mund të shërbejnë në cilësinë e provës vetëm kundër të njëjtit, por jo edhe kundër të bashkakuzuarve tjerë. Andaj, nisur nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, kanë kërkuar që i mbrojturi i tyre të shpallet i pafajshëm ngase nuk është provuar se ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

I akuzuari M K në mbrojtjen e dhënë në procedurën paraprake dhe në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se detyrën e k K së O e ka ushtruar nga fundi i vitit deri më dt. Më tutje ka shtuar se lidhur me projektin "Asfaltimi i rrugës në B Lagja K" punimet i ka kryer OE "D I" organi mbikëqyrës i këtij projekti tani i akuzuari Xh K është propozuar nga D i Planifikimit Urban tani i akuzuari A S dhe është caktuar nga ai, ndërsa që lidhur me rrugën në lagjen K në gjatësi prej 250m ka theksuar se është shtruar nga OE "D I", ditën kur e njëjta është shpallur fitues në projektin "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në B Lagja K dhe asfaltimi i rrugës në fshatin K" dhe këtë e ka bërë nën përgjegjësinë e vetë duke mos qenë i detyruar nga asnjë organi i Komunës, e aq me pak nga k i k dhe se nuk i ka dhënë asnjë urdhër verbalisht mbikëqyrësit tani të akuzuarit Xh K për shtrimin e asfaltit në rrugën në gjatësi prej 250 metra. Po ashtu ka shtuar se ka qenë njëherë në vendin e zhvillimit të këtij projekti dhe se banorëve ju ka premtuar se do bëjë përpjekje për gjetjen e fondeve për realizimin e kërkesës së tyre për shtrimin edhe të 250 m rrugë shtesë, dhe se kanë kaluar 40-50

ditë derisa janë gjetur fonde dhe janë zhvilluar procedurat e tenderimit për këtë gjatësi rruge. Më tutje ka shtuar se organ mbikëqyrës i projektit “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në B Lagja K dhe asfaltimi i rrugës në fshatin K” është caktuar H R nga ai, me propozimin e D të planifikimit urban tani të akuzuarit A S, ndërsa që 250 metra kanë hyrë si pjesë e këtij projekti. Ndërsa që sa i përket aneks-kontratës lidhur për punët shtesë në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale”, ka pohuar se arsyeja e aprovimit të ankesë kontratës për punë shtesë është si rrjedhojë e përgjigjes ndaj kërkesës së organit kompetent, gjegjësisht organit mbikëqyrës të drejtorisë së Urbanizmit dhe se nuk ka qenë detyrë e k të k që të analizoj përmasat dhe parallogaritë qoftë të kontratës apo të aneks kontratës, mirëpo meqenëse nuk ka pasur projekt detaj në kontratën bazë, ka mund të vinë vështirësi të tilla në realizimin e projektit. Ndërkaq në fjalën përfundimtare e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësve të tij, duke shtuar se edhe gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u vërtetua se nuk ka ekzistuar asnjë urdhër verbal që i njëjti të ia ketë dhënë tani të akuzuarit Xh K, e po ashtu edhe sa i përket kontratës për punë shtesë, siç është vërtetuar nga KRPP, ka qenë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të ligjit për Prokurorim Publik.

I akuzuari Xh K në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron pran mbrojtjes së dhënë në shqyrtimin gjyqësor duke kërkuar që gjykata ta liroj si i pafajshëm lidhur me veprat penal për të cilat akuzohet. Ndërsa në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në deklaratat e dhëna në procedurën paraprake ka deklaruar se ka qenë i caktuar bashkë me F O si organ mbikëqyrës i realizimit të projektit për asfaltimin e rrugës në fshatin B lagja K në gjatësi prej 1650 metra, nga D i Urbanizimit dhe Katastrit tani i akuzuari A S edhe pse në vendimin mbi caktimin e të njëjtit figuron emri i ish-k të K së O tani të akuzuarit M K. Më tutje ka shtuar se OE që ka realizuar këtë projekt ka qenë “D i”, edhe pse lidhur me kryerjen e punëve të caktuara ka lidhur kontratë me kompaninë “B C” nga F dhe për këtë ka pasur pëlqimin nga autoriteti kontraktues meqenëse kompania “D I” nuk ka pasur bazë të asfaltit dhe se për Komunën e rëndësishme ka qenë realizimi i punimeve sipas kontratës. Më tutje ka shtuar se shkresën të cilën e ka përpiluar me dt.13.03.2014, në cilësinë e organit mbikëqyrës të këtij projekti, në të cilën është konstatuar se përveç gjatësisë 1650m, janë shtruar edhe 250 metra shtesë, jashtë kontratës së paraparë dhe për këtë i referohej urdhrit verbal të k të K tani i akuzuarit M K, ka theksuar se e njëjta nuk është përpiluar por vetëm është nënshkruar nga ana e tij dhe atë pas presioneve që ka pasur dhe meqenëse ka qenë i sëmur, për të mos ju nënshtruar me tej këtyre presioneve e ka nënshkruar këtë dokument, ndërsa që nuk ka pasur presion dhe nuk i është kërkuar nga ish k i K tani i akuzuari M K për të i shtruar edhe 250 m rrugë shtesë. Po ashtu ka shtuar se ka qenë k i komisionit bashke N G dhe H R për pranimin teknike të projektit “Asfaltimi i rrugëve rurale”, me ç’rast edhe kanë përpiluar raportin përfundimtar pas daljes në vend-punim, matjes se rrugëve në gjatësi dhe gjerësi, ndërsa matjet të trashësisë se asfaltit nuk i kanë bërë, mirëpo janë bazuar në raportet lidhur me atestet të punuara nga laboratorit i licencuar i Kompanisë “P C” të cilat atyre ju janë dorëzuar nga OE “B C”, në të cilin konstatohet se gjithçka është në rregull në bazë të dokumentacionit dhe se punët janë kryer në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë dhe aneks-kontratë.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. R., av. N. Sh. në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është administruar asnjë provë përmes të cilave do vërtetohej dyshimi i bazuar mirë se i mbrojturi i tij është fajtor për veprat penale që i ngarkohen nga Prokuroria. Po ashtu, ka shtuar se me asnjë prove nuk është vërtetuar dëmi që i është shkaktuar Komunës së Obiliqit nga i akuzuari H. R. apo nëse i njëjti ka pasur ndonjë përfitim të kundërligjshëm qoftë për vete apo për ndonjë operator tjetër ekonomik. Më tutje ka shtuar se raportet e përpiluara nga i mbrojturi i tij, kanë qenë në pajtim me rregulloret në fuqi të cilat kërkojnë mbështetjen në dokumentacion, gjë që është respektuar nga i njëjti, dhe se ka qenë në detyrimin e OE-së të ofroj rezultatet laboratorike apo atestet në bazë të mostrave të marrura dhe se i njëjti nuk ka qenë në dijeni për përmbajtjen e pavërtetë të rezultateve laboratorike dhe nuk ka pasur arsye të dyshoj në këto rezultate meqenëse laboratorit ka qenë i licencuar në kryerjen rezultateve të kësaj natyre. Më tutje ka shtuar se edhe sa i përket mos përputhjes së datës së dokumentacionit dhe ekzekutimit të punëve në realizimin projektit “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në B. lagja K.” në gjatësi prej 250 m, puna është kryer në pajtim me standardët dhe kushtet e parapara në kontratë, ndërsa që asfaltimi i së njëjtës para se të kaloj afati i ankesave nga ana e OE “D. I.” mirëpo pasi që e ka kuptuar se është shpallur fitues, është rrjedhojë se fillimi i plotësimit të dokumentacionit është dashur të bëhet pas nënshkrimit të kontratës, mirëpo projekti është realizuar në pajtim me aneks kontratën e nënshkruar, dëshmuar kjo me dokumentet shoqëruese, përfshirë edhe të dhënat nga testet laboratorike dhe se i mbrojturi i tij ka qenë në dijeni për zhvillimin e punimeve dhe në mbikëqyrje të realizimit të tyre. Po ashtu edhe sa i përket mbikëqyrjes së punimeve në pjesën së rrugës në gjatësi prej 560m në fshatin K., i mbrojturi i tij është mbështetur në raportet laboratorike, nga të cilat ka rezultuar se punët janë kryere në pajtim me kushtet e përcaktuar në kontratë. Gjithashtu edhe në cilësinë e anëtarit të komisionit për pranimin teknik të projektit “Asfaltimi Rrugëve rurale”, në përpilimin e raporti janë mbështetur në dokumentacionin e nevojshëm përfshirë edhe rezultatet laboratorike dhe se pas daljes në teren, kanë konstatuar se projekti është realizuar pa vërejtje. Më tutje ka shtuar se bazuar në masat e fshehta të përgjimeve të telefonave, nga përmbajta e SMS të shkëmbyer në mes pronarit, menaxherit dhe punëtorëve rezulton se të njëjtit kanë punuar fshehurazi, me qëllim që të japin të dhëna të pasakta lidhur me sasinë e asfaltit të përdorur. Prandaj, bazuar në të gjitha këto që u than më lart, ka kërkuar nga gjykata që konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPRK-së të nxjerr aktgjykim lirues lidhur me të akuzuarin H. R.

I akuzuari H. R. në mbrojtjen e paraqitur në procedurën paraprake dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se është inxhinier i ndërtimit, dhe ka qenë i emëruar si menaxher-organ mbikëqyrës, nga ish K. i K. tani i akuzuari M. K., pasi që është propozuar nga Zyra e Urbanizmit të Komunës së Obiliqit, lidhur me asfaltimin e rrugës në fshatin B., lagja I dhe asfaltimin e rrugës në fshatin K. dhe se këto kanë qenë pjesë e një projekti mirëpo të ndara në segmente të ndryshme, ku fillimisht është paraparë të asfaltohet segmenti parë në gjatësi prej 1650m, për shkak se nuk ka pasur buxhet që të shtrohet rruga në tërësi dhe se kontratën për realizimin e këtij projekti e ka fituar OE “D. I.”. Më tutje ka shtuar sa i përket rrugës në gjatësi prej 250 metra kanë ofertuar dy OE, tenderin e ka fituar OE “D. I.”, pasi që ka qenë ofertuesi me i lire për rreth 20 mijë euro, ndërsa që vlera e kontratës ka qenë në vlerë prej 44.954.29 euro. Po ashtu ka shtuar se është e vërtetë se rruga është shtruar 10 ditë para se të bëhet nënshkrimi i kontratës, dhe se kjo ka ndodhë pasi që OE e ka kuptuar se e ka fituar kontratën, mirëpo nuk ka pritur edhe tetë ditë deri sa të kaloj afati ankesave. Po ashtu ka

pohuar faktin se ai është caktuar menaxher pasi ka përfunduar asfaltimi i rrugës, dhe lëshimi i raportit mbi ecurinë e punimeve i dt. 16.04.2013, është rrjedhojë e faktit se ai ka i qenë i informuar për ecurinë e punimeve nga mbikëqyrësi tjetër tani i akuzuari Xh. K., por edhe nga fakti se ai ka filluar ta ushtroj detyrën e menaxherit para se të nënshkruhet vendimi për caktimin e të njëjtit në cilësinë e menaxherit. Gjithashtu ka deklaruar se ka qenë anëtar i komisionit për pranimin teknike për projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale”, së bashku me tani të akuzuarit N. G. dhe Xh. K., dhe pasi që kanë marr të gjithë dokumentacioni për këtë projekt nga mbikëqyrësja tani e akuzuara H. D., duke përfshirë kontratën, aneks-kontratën, raportet e punës së mbikëqyrësit të këtij projekti, ditarin e punimeve dhe raportin e atesteve laboratorike të lëshuar nga një institut i licencuar sipas të cilit të gjitha shtresat e rrugëve kanë qenë të ekzekutuara konform kontratës dhe rregullave ndërtimore, dhe daljes në teren dhe matjes së rrugës në gjatësi dhe gjerësi dhe shikimit sipërfaqësor të tyre, kanë hartuar raportin e dt. 20.08.2013, për pranimin teknik të projektit. Sa i përket raportin të atesteve laboratorike, ka theksuar se ka qenë obligim i OE realizimi i të njëjtave lidhur me cilësinë, ngjeshmërinë, fraksionin dhe përbërjen e materialeve të përdorura dhe se i vjen keq që këto raporte nuk kanë reflektuar gjendjen reale në rrugë, mirëpo kjo ka ndodhur pafajën dhe padijeninë e tij. Ndërkaq në fjalën përfundimtare e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit N. G., av. F. P. në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka theksuar sa edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i mbrojturi i tij ka kryer veprat penale për kryerjen e të cilave është ngarkuar nga prokuroria, ndërsa që në mungesë të dashjes, në veprimet e të mbrojturit të tij nuk mund të ketë vepër penale. Më tutje ka shtuar se i mbrojturi i tij ka vepruar në bazë të vendimit të Komunës së Obiliqit, në të cilin janë caktuar edhe përgjegjësit dhe detyrat e tij, dhe se raporti i cili është përpiluar nga komisioni anëtar i të cilit ka qenë edhe i akuzuari N. G., është bazuar në të dhënat laboratorik të një instituti të licencuar, në raportin e menaxherit të kontratës, raportin e punë kryerësit dhe ditarin ndërtimor, dokumentacion ky i mjaftueshme për pranimin teknik të projektit. Andaj bazuar në këtë gjendje faktike, ka kërkuar që i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza lidhur me veprat penal për të cilën akuzohet.

I akuzuari N. G. në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor dhe në procedurën paraprake ka deklaruar se punon në pozitën e k. në Drejtorin e Inspektionit në Komunën e Obiliqit, dhe se ka qenë anëtar i komisionit për pranimin teknik të projektit “asfaltimi i rrugëve rurale” bashkë me tani të akuzuarit H. R. dhe Xh. K., ndërsa që në projektin “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës B., lagja K.” ka qenë anëtar i komisionit për pranim bashkë me tani të akuzuarit R. H. dhe B. P. të caktuar me vendim të administratës- Drejtorisë se Administratës se Komunës se Obiliqit. Më tutje ka shtuar se e ka përpiluar raportet përfundimtare e dt. 20.08.2012 dhe dt.09.10.2013 lidhur me projektet e më sipërme, bashkë me anëtarët tjerë të komisioneve, raporte të cilat janë hartuar pas pranimit të raportit të menaxherit dhe raportit të punë kryerësit, në të cilët është konstatuar se gjerësia dhe gjatësia rrugëve ka qenë sipas projektit, ndërsa që lidhur me trashësinë e asfaltit dhe elementet tjera konstruktive të rrugës, janë mbështetur në rezultatet e shqyrtimeve laboratorike, në të cilat është konstatuar se trashësia e asfaltit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në



kontratë. Ndërkaq në fjalën përfundimtare e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësja e të akuzuarit R H , av. H A në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka deklaruar se nga të gjitha provat e administruara, siç janë provat material që gjenden në shkresat e lëndës, dëgjimit të dëshmitarëve por edhe nga vetë mbrojtja e të mbrojturit të saj, nuk është vërtetuar se i njëjti ka marrur ndonjë veprim inkriminues që kishte për të formësuar figurën e veprës penale për kryerjen e të cilës akuzohet. Më tutje ka shtuar se pretendimet e ngritura në aktin akuzues nuk janë vërtetuar as nga provat e paraqitura nga prokuroria, pasi që ekspertiza e siguruar nga prokuroria nuk është provë që vërteton përgjegjësin penale të të mbrojturit të saj, pasi që raporti i cili është përpiluar nga komision anëtar i të cilit ka qenë edhe i mbrojturi i saj, është hartuar duke u bazuar në shkresat e organit mbikëqyrës dhe në raportin laboratorik të hartuar nga një laborator i licencuar i cili ka qenë pronë e kompanis "B C", ndërsa që ekspertiza nga laboratori I -së nuk është provë që justifikon përgjegjësin penale të mbrojturit të saj, meqenëse i njëjti nuk është ekspert dhe nuk ka qenë në kompetencën e tij që vlerësoj kualitetin e asfaltit të përdorur për shtrimin e rrugëve. Po ashtu edhe dëshmitarët A K dhe N M , në dëshmitë e tyre nuk e përmendin fare të mbrojturin e saj, në funksion të ndonjë veprimi inkriminues sa i përket veprës penale me të cilat ngarkohet nga organi i akuzës. Më tutje ka shtuar që lidhur më të mbrojturin e saj të merren parasysh faktet se me herët nuk ka ra ndesh me ligjin, ka treguar sjellje korrekte në gjykata dhe është familjarë. Prandaj, duke u nisur nga sa u tha më lart ka kërkuar që i mbrojturi i saj të lirohet nga akuza meqenëse nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari R H në mbrojtjen e dhënë në shqyrtimin gjyqësor dhe në procedurën paraprake, ka deklaruar se punon në pozitën e i të ndërtimit në Komunën e Obiliqit, dhe se në kohën kur është caktuar anëtar i komisionit për pranim teknik të projektit me titull "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në B. lagja K dhe asfaltimi i rrugës në fshatin K.", ka kryer detyrën e p në Komunën e Obiliqit. Më tutje ka shtuar si anëtarë i komisionit ka dalur për të bërë pranimin teknik së bashku me anëtarët tjerë të komisionit dhe vlerësimi është bërë në bazë të dokumenteve të ofruara dhe vendimeve të kolegëve të tij. Po ashtu ka shtuar sa i përket segmentit rrugor L=250m nuk ka njohuri nëse punimet janë kryer pa kontratë, ndërsa që lidhur me segmentin L=560 m ka pohuar se në bazë të raporteve të ofruara janë përfillur kriteret e kontratës, ndërkaq lidhur me raportet e I -së, ka deklaruar se nuk ka është në dijeni se kanë ndodhur shkelje të tilla. Në fjalën përfundimtare e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses të tij.

I akuzuari B P në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim e të elaboruar shkurtimisht me gojë ka deklaruar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Po ashtu ka shtuar se ka punuar në bazë të vendimit të Komunës së Obiliqit, dhe se në veprimet e të njëjtit nuk ekziston elementi dashjes, meqenëse raportin bashkë me anëtarët tjerë të komisionit e kanë përpiluar në bazë të raportit laboratorik të një instituti të licencuar, raportit të menaxherit, raportit të punë kryerësit dhe ditarit ndërtimor, dokumente këto të mjaftueshme për pranimin teknik të projektit. Ndërsa gjatë deklarimit në shqyrtim gjyqësor, dhe deklaratave të dhëna në procedurën paraprake ka deklaruar se ka punuar në Komunën e Obiliqit, si për

çështje pronësore, në kuadër të Drejtorisë së Pronës dhe Kadastërit, dhe se është suspenduar që tri (3) vite nga puna. Më tutje ka shtuar se ka qenë anëtar i komisionit për pranim në projektin me titull “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në B...-lagja K... dhe asfaltimi i rrugës në fshatin K...”, sipas vendimit të dt.04.10.2013 bashkë me dy anëtarët tjerë tani të akuzuarit N... G... dhe R... H..., dhe si komision kanë dalur në teren, kanë bërë matjet në gjerësi dhe gjatësi, me ç’rast prezent ka qenë edhe pronari i operatorit ekonomik-realizuesit të punimeve, dhe në përfundim të matjeve kanë përpiluar një raport mbi vlerësimin përfundimtar të realizimit të projektit në të cilin është konstatuar se projekti në fjalë është përfunduar pa vërejtje, duke u bazuar në shkresat që kanë marrur nga menaxheri i projektit në të cilat konstatohet se punët janë kryer sipas përmasës dhe parallogarisë, pastaj raportet e mostrave nga instituti i licencuar. Më tutje ka shtuar se nuk ka njohuri se kur është punuar segmenti i rrugës në K... L=560 dhe në Koskovic L=250 m dhe nëse e njëjta është bërë pa kontratë në mes të kompanisë “D... i...” dhe komunës Obiliqit.

E akuzuara H... D... në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë ka deklaruar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se është fajtorë për veprat penale të cilat i ngarkohet sipas aktakuzës. Më tutje ka shtuar se është caktuar si menaxhere e projektit “Asfaltimi i rrugëve rurale” me vendimin e dt.28.05.2013 dhe se një detyrë të tilla e ka kryer krahas angazhimit si udhëheqëse e Sektorit të Planifikimit, çka e ka bërë që gjithë kohës të mos mund të i përcjell punimet lidhur me projektin e lartpërmendur, mirëpo është siguruar që të gjitha veprimet që ka bërë në pozitën që ka shërbyer, përkatësisht raportet që ka hartuar të janë të mbështetura në dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet sipas rregullorës së punës për projekte të tilla dhe se ka vepruar brenda autorizimeve të përcaktuara me ligj. Më tutje ka shtuar se të gjitha raportet për pranimin e punëve janë përpiluar bazuar në shqyrtimet laboratorik të tamponit dhe atestet e asfaltit të përpiluara nga laboratorit i licencuar “B... C...” dhe se nuk ka pasur arsye të dyshoj në vërtetësin e raporteve të një laboratorit të licencuar, duke u vënë kështu në lajthim qoftë faktik por edhe juridik nga përmbajtja e këtyre raporteve, ndërsa sa i përket ekzekutimit të pozicioneve të paramasës së kontratës, çdo pozicion është realizuar në përputhje me dimenzionet dhe përmasat e përcaktuara me kontratë. Po ashtu, ka shtuar sa i përket kërkesës për aprovimin e mjeteve shtesë për projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” nuk e ka ditur se është në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe se po ashtu nuk ka qenë e detyruar të i dijë, mirëpo ka theksuar se ky projekt nuk ka mundur të realizohet pa punët shtesë që kanë dalur si rrjedhojë të punimeve në autostradë që kanë prekur një pjesë të segmentit të rrugës që ka qenë planifikuar të realizohet me kontratë në fshatin Mazgit, e po ashtu edhe punët shtesë në fshatin Kozaric, por edhe punë tjera të dalura gjatë realizimit të projektit, e të gjithë këto të evidentuara në ditarin ndërtimor. Tutje ka shtuar se edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve, e në veçanti Drejtorit të OE “B... C...” tani të akuzuarit B... K... i cili ka pranuar se ka paraqitur atestet të rrejshme, e po ashtu provat tjera materiale është vërtetuar se në veprimet e saj nuk ka asnjë element inkriminues që do përbënte figurat e veprave penale për të cilat akuzohet, prandaj ka kërkuar që lidhur me të njëjtat të shpallet e pafajshme. E akuzuara H... D... edhe në deklarinë në shqyrtim gjyqësor, e po ashtu edhe në mbrojtjen e paraqitur në procedurën paraprake, ka paraqitur mbrojtje të njëjtë sa i përket veprave penale për kryerjen e të cilave akuzohet.

I akuzuari A... S... në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se në cilësinë e

D [redacted] të Urbanizmit pran Komunës së Obiliqit nuk ka kryer veprën penale të çfardo lloj natyre, pasi që nuk ka qenë në përgjegjësin e tij mbikëqyrja e realizimit të projekteve, ndërsa që aprovimi i punëve shtesë ka qenë nevojë që ka dalur gjatë realizimit të projektit. Më tutje ka shtuar se aneks-kontrata është nënshkruar pas përfundimit të procedurës së prokurorimit dhe se mos nënshkrimi i aneks-kontratës do rrezikonte implementimin e kontratës bazë dhe se aneks-kontrata ka qenë në shumë nën 10% të kontratës bazë, duke qenë kështu në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së. Po ashtu ka shtuar se duke qenë se organi i akuzës nuk ka arritur të vërtetoj veprën penale për të cilën akuzohet, ka kërkuar nga gjykata që të nxjerr aktgjykim lirues lidhur me të njëjtin. Po ashtu edhe në mbrojtjen e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në procedurën paraprake ka deklaruar se derisa ka qenë në pozitën e D [redacted] ka nënshkruar kërkesën për aprovimin e aneks kontratës në projektin me titull “Asfaltimi i rrugëve rurale” të cilën kërkesë e kishte pranuar nga organi mbikëqyrës i projektit menaxherja tani e akuzuara H [redacted] D [redacted] dhe e po ashtu edhe kërkesën e dt.02.07.2013 të paraqitur nga e njëjta me të cilën kërkohej nga zyra e prokurimit që të bëhet sa me shpejtë aprovimi i projektit shtesë për projektin e lartcekur, dhe të njëjtën ja ka drejtuar zyrës së prokurimit dhe kjo aneks kontratë është nënshkruar nga zyrtari i prokurimit në Komunën e Obiliqit tani i akuzuari A [redacted] P [redacted] dhe nga Sh [redacted] K [redacted] menaxher i OE-se “B. [redacted] c [redacted]” e cila kontratë është lidhur para se me fillua rregullimi i rrugëve Mazgit dhe Kozaricë për të cilat është lidhur kjo aneks kontratë. Ndërsa që lidhur me formimin e komisionit për pranimin e punëve lidhur me projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” ka pohuar se pas kërkesës paraprake nga zyra e prokurimit, në konsultim me të, D [redacted] i Departamentit të administratës në Komunën e Obiliqit I [redacted] H [redacted], me vendim ka formuar komisionin në përbërje nga tani të akuzuarit H [redacted] R [redacted], N [redacted] G [redacted] dhe Xh [redacted] K [redacted]. E po ashtu edhe lidhur me projektin rrugorë “Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë”, komisioni për pranim është formuar në të njëjtën procedurë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A [redacted] P [redacted] av.G [redacted] B [redacted] në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka deklaruar se i mbrojturi i tij në asnjë mënyrë nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, pasi që i njëjti ka vepruar konform dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Prokurimit Publik dhe përgjegjësive të punës së tij dhe se nga pozita e menaxherit të prokurimit publik nuk ka pasur autoritetin dhe as autorizimet që të këtë përgjegjësi lidhur me mbikëqyrjen e punëve dhe implementimin e kontratave dhe aneks-kontratës. Më tutje ka shtuar se kontrata si e tille nuk është e kundërligjshme, e po ashtu as aneks-kontrata që është lidhur për punët e paraqitura pas lidhjes së kontratës bazë dhe se e njëjta është lidhur për natyrën e njëjtë të punëve, ndërsa që për implementimin e projektit nuk ka qenë në detyrimin e të mbrojturit të tij për mbikëqyrjen e punëve në teren. Po ashtu ka shtuar se dispozitivi i aktakuzës i cili e ngarkon të mbrojturin e tij, vetëm përshkruan dispozitën e nenit 422 të KPRK-së, paarritur të vërtetoj elementet konkrete të kësaj vepre penale, gjegjësisht tejkalimin e kompetencave apo mos ushtrimin e të njëjtave, shkeljen e ligjit të prokurimit publik, dëmtimin e Komunës së Obiliqit, apo ekzistencën e një marrëveshje paraprake me ndarje rolesh në mes të akuzuarve. Andaj, meqenëse nuk është vërtetuar se i akuzuari A [redacted] P [redacted], ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, i ka propozuar gjykatës që për të njëjtin të nxjerr aktgjykim lirues konform nenit 364 par. 3 të KPPRK-se.

I akuzuari A [redacted] P [redacted] në mbrojtjen e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në procedurën paraprake ka deklaruar se në Komunën e Obiliqit ka punuar prej viti 2008 deri në vitin 2013 në

pozitën e menaxherit të prokurorimit që ka përfshirë përgjegjësit që nga pranimi i kërkesave prej njësisive kërkuese për inicim të procedurave të prokurimit, shpallja e tenderëve, hapja, vlerësimi, njoftimi për dhënie të kontratës dhe në fund nënshkrimi i kontratës dhe se në gjithë këto veprime ka qenë nën mbikëqyrjen e KRPP-së. Më tutje ka shtuar se lidhur me nevojën për ankesë kontratë është informuar nga Organi mbikëqyrës tani e akuzuara H D , përmes k të K tani të akuzuarit M K dhe D të Urbanizmit tani të akuzuarit A S , dhe se para nënshkrimit të aneks-kontratës e njëjta është analizuar në kuptimin e pozicioneve dhe përmasave të përfshira, pastaj implikimeve buxhetore, e po ashtu faktin që nuk duhet të tejkaloj 10% të vlerës së kontratës bazë dhe se për të njëjtën i kanë raportuar KPRK-së dhe nga e njëjta nuk ka pasur vërejtje, gjë që është konfirmuar edhe nga përgjigjja KRPP-zyra për interpretim ligjor, e cila ka sqaruar se mund të shfrytëzohet një aneks-kontratë për ato materiale të cilat kanë qenë të kontraktuar në kontratën bazë, mirëpo vetëm deri në 10% të saj. Po ashtu ka shtuar se aneks-kontrata është nënshkruar nga ana e tij dhe se nuk ka pasur ankesa nga OE tjerë, e po ashtu se OE “B c ” është përzgjedhur si ofertues i përgjegjshëm dhe faktin se ka ofruar çmimin më të ultë, kriter ky përcaktues për dhënien e një kontrate. Ndërkaq në fjalën përfundimtare e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit E S av. E K në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka deklaruar se element bazë për të vërtetuar ekzistimin e veprës penal është dashja e të akuzuarit, dashje kjo e cila mund të jete direkt ose eventuale dhe se në rastin konkret lidhur me të mbrojturin e tij, mungojnë të dy këto forma të dashjes. Më tutje ka shtuar se i mbrojturi i tij si pronarë i OE “D -i ” shpk, ka marrur detyrimin për kryerjen e punëve në realizimin e projektit “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fsh. Breznicë-lagja Kosokovik dhe asfaltimit të rrugës në fsh. Kozaricë”, mirëpo i njëjti ekzekutimin e punimeve për shkak se e ka pasur bashkëshorten e smur, përmes një marrëveshje gojore ja ka besuar një Operatori tjetër ekonomik “B C ” më të cilën ka menaxhuar tani i akuzuari B K , fakt ky që është pohuar edhe nga të akuzuarit tjerë gjegjësisht të akuzuarit Sh K dhe B K . Po ashtu ka shtuar se plotësimi i dokumentacioni nga ana e të mbrojturit të tij është bërë mbi bazën e raporteve të mbikëqyrësit të Kompanis se tij dhe mbi bazën e raporteve të mbikëqyrësit të autoritetit kontraktues Komunës së Obiliqit, dhe se nuk ka qenë fare prezent kur janë marrur mostrat e kualitetit dhe trashësisë së asfaltit, prandaj i ka propozuar gjykatës që i mbrojturi i tij të shpallet i pafajshëm lidhur me veprën penale që i vihen në barrë.

I akuzuari E S në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pas zhvillimit të procedurave të tenderimit në muajin nëntor të viti 2012 i njëjti ka fituar tenderin për realizimin e projekteve që kanë përfshirë rrugën në lagjen Kosokovik në gjatësi 250m si loto 1 për të cilën trashësia e asfaltit është paraparë 7cm dhe në lagjen K në gjatësi 650m për të cilën trashësia e asfaltit është paraparë me qenë 7-4 cm, të dy këto në Komunën e Obiliqit. Më tutje ka shtuar se më heret e ka pasur një projekt në gjatësi të rrugës prej 1650m në përfundim të cilit ka pasur pengesa nga fshatarët të cilët ja kanë ndërpret punimet e cilat ka zgjatur dy javë ditë. Po ashtu ka shtuar se meqenëse e ka pasur gruan e sëmur, përveç fillimit të punimeve-shtresës së parë, të gjitha punët tjera i’a ka besuar kompanisë “B C ” pronar i të cilës nuk e ka ditur kush ka qenë, mirëpo ai është marrur vesh me drejtorin e kompanisë “B C ” tani të akuzuarin B K , që ta shtroi edhe pjesën e rrugës gjegjësisht ta shtroj një shtresë të asfaltit dhe atë shtresën prej 10 cm zhavorr dhe shtresën e asfaltit në tërësi sipas projektit të

fituar nga kompania e tij. Më tutje pas ballafaqimit me listën e stafit të Kompanisë “D I ” të dorëzuar me rastin e aplikimit për tender dhe vendimin e të njëjtës kompani të dt.22.10.2012 përmes të cilit tani i akuzuari S K është emëruar drejtues dhe menaxher i projektit, është përgjigjur se të njëjtat janë të kompanisë “D I ”. Po ashtu pas ballafaqimit me deklaratën e dhënë në procedurën paraprake ku kishte deklaruar se ka qenë mbikëqyrës i projektit, i njëjti ka refuzuar të përgjigjet. Më tutje ka deklaruar se nuk ka qenë prezent me rastin e nxjerrjes së mostrave të asfaltit por e dinë që nxjerrjen e tyre e ka bërë laboratorit i kompanisë “B C ” kompani e cila e ka bërë edhe shtruarjen e asfaltit. Meqë i akuzuari ka deklaruar se mbetet në tërësi pran deklaratave të dhëna në procedurën paraprake, i njëjti përveç fakti së është pronar i Sh.p.k “D I ” me seli në P , dhe se kjo kompani ka realizuar projektin me titull “ Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë –lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaric” me nr. identifikues , në lidhje më disa rrethana ka dhënë një mbrojtje tjetër, e cila konsiston në atë se lidhur me ndërprerjen e punimeve gjatë realizimit të projektit “Asfaltimi i rrugës Breznic-Koskovik” që ka qenë në gjatësi L=1650 m, në deklaratën në polici dt.31.03.2014 ka deklaruar se në koordinim me zyrtarët e Komunës janë marrë vesh që rruga të vazhdohet edhe për 250 shtesë, ndërkohë që procedurat e tenderimit janë vazhduar më pas nga zyra e Komunës së Obiliqit, në përfundim të cilave edhe është nënshkruar kontratë të re me Komunën e Obiliqit, me të cilën kontratë është mbuluar rruga pjesa prej 250 m. Ndërsa që në deklaratën e dhënë në prokurori dt.23.09.2014 ka deklaruar se pas ndërprerjes së punimeve, të njëjtat kanë vazhduar pas i njëjti ka fituar tenderin për asfaltimin e rrugës në gjatësi prej 250m, mirëpo nuk e ka pritur përfundimin e periudhës së ankesave nga OE tjera ofertuese. Më tutje, ndryshe nga deklarimi në shqyrtimin gjyqësor, në mbrojtjen e dhënë në prokurori dt. 23.09.2014 ka pohuar se për pjesën e punës që është pajtuar ta kryej tani i akuzuari B K , ai nuk ka qëndruar gjithë kohën, mirëpo ka qëndruar djali tij P S , dhe se në momentin e pranimit teknik, prezent kanë qenë komisioni për pranim prej tre anëtarësh, vetë i akuzuari, i akuzuari Sh K si përfaqësues i “B c ” dhe tani i akuzuari H R . Po ashtu që në të gjitha deklaratat e dhëna në procedurën paraprake nuk ka përmendur faktin se gruaja e tij ka qenë e sëmur, për çka edhe nuk ka mundur me qenë prezent gjatë realizimit të projektit. Ndërkaq në fjalën përfundimtare e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

I akuzuari S K në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pran asaj që ka thënë në shqyrtimin gjyqësor, se ndihet i pafajshëm dhe ka kërkuar nga gjykata që ta liroj nga akuza pasi që nuk ka asnjë provë që provon fajësinë për veprën për të cilën akuzohet. Ndërsa në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtimin gjyqësor dhe në procedurën paraprake ka deklaruar se ka përfunduar Fakultetin e Ndërtimtarisë-drejtimi konstruktiv dhe se gjatë viti 2013 ka punuar në Kompaninë Ndërtimore “D I ” dhe vazhdon të punoj në të njëjtën, e cila për aktivitet të saj i ka punët ndërtimore. Më tutje ka shtuar se në projektin “vazhdimi i asfaltimit të rrugës Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozarice”, formalisht ka qenë mbikëqyrës i projektit meqenëse me rastin e aplikimit për tender ka qenë e detyrueshme që personi që është dashur me i mbikëqyrë punimet, të këtë edhe përgatitje të lart profesionale. Po ashtu ka shtuar se përgjegjës në realizimin e projektit ka qenë pronari i kompanisë E S , ndërsa që vetë ai nuk e ka ditur dhe as që ka pasur vendim për me të cilin është caktuar në cilësinë e mbikëqyrësit të projektit. Më tutje ka shtuar se gjatë zhvillimit të punimeve asnjëherë nuk ka qenë për të parë zhvillimin e tyre, përveç dy rasteve dhe atë njëherë kur është bërë pastrimi i terrenit dhe herën e dytë kur ka filluar të shtrohet zhavorri në rrugë dhe se natyra e këtyre vizitave ka qenë kalimthi

duke shkuar në vende tjera dhe në shoqërim me pronarin e kompanisë E S . Gjithashtu ka shtuar se një herë është takuar dhe ka kontaktuar me një zyrtar të Komunës së Obiliqit i cili kishte rolin e mbikëqyrësit mirëpo ka theksuar se nuk ka biseduar për projektin në fjalë, pasi që me të kishte biseduar pronari i kompanisë E S . Më tutje ka shtuar se ai nuk ka qenë i angazhuar në këto punime vërtetohet edhe nga fakti se ai nuk ka nënshkruar asnjë dokument ose raport të punës apo ditar të zhvillimit të këtyre punimeve, e po ashtu nuk ka marr pjesë në pranimin teknik të të njëjtave.

I akuzuari B A në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka deklaruar se edhe pse akuzohet, si person përgjegjës përkatësisht pronar i operatorit ekonomik “B C ”, askund nuk përshkruhen veprimet konkrete, kryerja e të cilave do përbënte vepër penale dhe se është e vërtetë se ka lidhur nënkontratë me kompaninë “B C ” për kryerjen e punëve, mirëpo nuk i ka interesuar se çka ka bërë kjo kompani me tej në realizimin e kontratës, prandaj duke nisur që vetëm ka lidhur nënkontratë dhe se nuk ka biseduar kurrë me dikë lidhur me zbatimin e projekteve, ka kërkuar nga gjykata ta liroj nga akuza duke e shpallur të pafajshëm. Ndërsa në fazën e procedurës paraprake dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i njëjti ka dhënë përgjigje të ndryshe lidhur me rrethanat e njëjta, duke i qëndruar besnik vetëm pohimit se duke qenë pronar i kompanisë N “B C ” me seli në Gj , ka fituar projektin e tenderit me titull “Asfaltimi i rrugëve rurale” në komunën e Obiliqit dhe se në atë projekt punët janë kryer ashtu siç kanë qenë të precizuara në kontratë, ku shtresa e zhavorrit është dashtë të jetë 30-40 cm ndërsa asfalti është dashtë të jetë 7 cm dhe se asnjëherë nuk ka qenë në teren për të përcjellur zhvillimin e punimeve në realizimin e këtij projekti. Kështu në deklaratën e dhënë në prokurori me dt. 19.09.2014 ka deklaruar se punimet në teren i ka mbikëqyruar organi mbikëqyrës i kompanisë së tij tani i akuzuari Sh K , i cili i ka raportuar atij, për ecurinë e zhvillimit të punimeve, ndërsa që në deklarin gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pohuar se “të gjitha punët i’a ka besuar tani të akuzuarit B K , andaj edhe nuk kam qenë në dijeni për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me kompaninë “B C ”. Po ashtu në deklaratën e dhënë në prokurori më datë si me sipër, sa i përket angazhimit të laboratorit “B C ” më saktë ekspertizës për raportin e atesteve të dhënë nga ky laborator, ka pretenduar se nuk ka pasur dijeni se kush e ka caktuar këtë laborator, dhe për këtë njohuri mund të ketë tani i akuzuari Sh K , ndërsa që nga i njëjti është njoftuar se firma e tij ka përfunduar punimet sipas projektit të lartcekur dhe se raportet e atesteve të laboratorit të “B C ” kanë rezultuar të jenë konform kushteve të kontratës, ndërkaq që në deklarin në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se “përgjegjës komplet ka qenë B K , dhe se për këtë kam qenë jashtë krejte (aut)”. Gjithashtu, një rrethanë tjetër e rëndësishme që shpreh dallimet në deklarin nga ana e të akuzuarit më procedurën paraprake me atë në shqyrtim gjyqësor është lidhur me njohurit e tij për mbikëqyrësin e caktuar nga autoritetit kontraktues, pasi që derisa në procedurën paraprake gjegjësisht në deklaratën e dhënë në prokurori me datë si më sipër, tani të akuzuarës H D i është referuar disa here siç është rasti “...vendet për marrje të mostrave janë caktuar nga organi mbikëqyrës i komunës e që është H D ”, ndërsa që në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e dinë kush ka qenë organ mbikëqyrës nga ana e autoritetit kontraktues-Komuna e Obiliqit. Po ashtu në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se më vonë e ka kuptuar se cilësia e asfaltit që e ka shtruar firma e tij ka dal shumë më ndryshe se ajo që është caktuar me kontratë, mirëpo ka deklaruar se është i gatshëm që sërish ta shtroj asfaltin dhe sipas tij kompani e tij ka filluar me sanimin e këtyre rrugëve.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. K., av. S. M. në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe se prokuroria nuk ka vepruar në pajtim me nenin 7 par.1 i KPRK-së i cili e obligon që të vërtetoj edhe faktet që janë në favor të pandehurit. Më tutje ka shtuar se nga SMS e marrur është vërtetuar se i mbrojturi i tij është urdhëruar nga pronari i kompanisë “B. C.” tani i akuzuari B. K. që shtresa e asfaltit të shtrohet në trashësinë prej 4.5cm e jo sipas kriterëve të përcaktuar në kontratë, ndërsa që mbrojturi i tij edhe pse ka qenë i caktuar në detyrën e menaxherit të kontratës, menaxhimi i kontratës është bërë direkt nga pronari kompanisë “B. C.” tani i akuzuari B. K., ndërsa angazhimi i të mbrojturit të tij ka qenë vetëm formal dhe i detyruar të i zbatoj urdhëratë nga pronari tani i akuzuari B. K., ndërsa që refuzimi i te njëjtëve do rezultonte me largim nga vendi i punës dhe se në të njëjtën kohë meqenëse nuk i ka pasur të qarta kriteret e përcaktuar me kontratë, nuk ka paraqitur asnjë fakt të rrem apo nuk ka fshehur asnjë fakt më qëllim përfitimi. Po ashtu ka shtuar se i mbrojturi i tij ka qenë punëtor i kompanisë “B. C.” dhe siç rezulton nga kontrata mbi marrëdhënien e punës ndërmjet kësaj Kompanie dhe të akuzuarit Sh., i njëjti është angazhuar në cilësinë e teknikut të ndërtimitarisë, dhe se nuk ka qenë në marrëdhënie pune me kompaninë “B. C.” dhe se nuk e ka ditur se ky OE ka tjetër pronar, duke qenë kështu i lajthitur lidhur me këtë fakt, ndërsa që paraqitja e tij si përfaqësues i autorizuar i kompanisë “B. C.” është rrjedhojë se ka jetuar afër Komunës së Obiliqit dhe se nuk ka qenë i përfshirë në hartimin e kushteve të kontratës. Po ashtu ka shtuar se plani për menaxhimin e kontratës i dt.19.08.2013 nuk është hartuar nga ana e të mbrojturit të tij, edhe pse i njëjti është nënshkruar nga i akuzuari Sh., ndërsa që gjykata duhet të marr parasysh edhe faktin që i akuzuari B. K. e ka pranuar fajësinë dhe ka marr përsipër sanimin e të gjitha dëmeve. Prandaj nisur nga pretendimet e paraqitura me lart, ka kërkuar që i mbrojturi i tij të shpallet i pafajshëm, pasi që nuk ka prova të mjaftueshme përmes të cilave do vërtetohej se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari Sh. K. në mbrojtjen e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në procedurën paraprake, ka deklaruar se ka përfunduar dy vite në inxhinieri të ndërtimitarisë dhe infrastrukturës dhe gjatë vitit 2013 ka punuar në kompaninë “B. C.”, në cilësinë e teknikut në punishte për përcjelljen e realizimit të punëve në ndërtimin e rrugëve, ndërsa që në kompaninë “B. C.” nuk ka pasur kontratë punë mirëpo në të njëjtën ka qenë i angazhuar për realizimin e punimeve për ndërtimin e rrugëve në Komunën e Obiliqit, ku kompania “B. C.” ka qenë nënkontraktor i OE “B. C.” dhe se ai ka qenë i përfshirë në rolin e përcjellësit të punimeve për këtë kontratë nga pronari i kompanisë “B. C.” tani i akuzuari B. K., të cilit i ka raportuar në baza ditore për punën e kryer. Më tutje ka shtuar se nga i njëjti ka marrur urdhra qoftë përmes telefonit kryesisht mesazhe telefonike, apo drejtpërdrejtë gojarisht për formën e realizimit të punimeve. Më tutje ka shtuar se në fillim të punimeve, ai ka pasur një rast vdekje në familje i cili ja ka pamundësuar që në periudhën kohore prej dhjetë ditëve me qenë në mbikëqyrje të vazhdueshme të rrugëve duke arritur që të jetë i pranishme vetëm gjysmë ore apo një orë brenda ditës dhe se gjatë mungesës së tij menaxherja e projektit tani e akuzuara H. D. ju ka dhënë vërejtje përmes telefonit se duhet të bëhen disa përmirësime tek shtresat e zhavorri dhe se e njëjta ka ardhur çdo ditë dhe i ka mbikëqyrrur punimet e realizuara nga OE “B. C.”. Po ashtu ka vazhduar duke pohuar se edhe pse i është kërkuar nga tani i akuzuari B. K. që trashësia e asfaltit të mbetet 4.5 cm, ai ka vazhduar

me ju përmbajtën parametrave të parapara më kontratë dhe se kur tani i akuzuari B K e ka kuptuar se nuk është duke vepruar sipas udhëzimeve të tij, atëherë ka ardhur vetë dhe ka vepruar ashtu si ka kërkuar nga ai. Më tutje ka shtuar se laboratorit për kryerjen e atestave është angazhuar direkt nga i akuzuari B K , të cilët kanë marr mostrat e nevojshme dhe pas analizave i kanë sjellë rezultatet për mostrat e asfaltit. Po ashtu ka shtuar se ai në cilësinë e përfaqësuesit të OE "B C " ka nënshkruar aneks kontratën me autoritetin kontraktues komunën e Obiliqit, dhe se të njëjtën e ka nënshkruar më urdhrin e tani të akuzuarit B K dhe se arsyeja e dhënies se këtij autorizimi ka qenë se është nga Komuna e Obiliqit-Fshati Sibovc, e mundet me lehtë ta kryej këtë punë. Sa i përket realizimit të projektit "asfaltimi i rrugëve rurale" ka shtuar, se i njëjti është realizuar në të gjitha përmasat dhe përlogarit sipas kontratës, ndërsa që lidhur me trashësinë e asfaltit dhe zhavorrit, ka deklaruar se ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk mund të jap një përgjigje të saktë.

Mbrojtësi i të akuzuarit B K , av.I J në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar dhe se një pranim i tillë është pranuar nga gjykata duke u mbështetur në provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka kërkuar që me rastin e caktimit llojit dhe lartësisë së dënimit për të njëjtin të marr si rrethanë posaqarisht lehtësues pranimin e fajësisë nga i njëjti, po ashtu gjendjen shëndetësore, faktin që i mbrojturi i tij është hera e parë që bie ndesh me ligjin, pendimin e thellë dhe kërkim faljen për veprimet e bëra, si dhe premtimin se do rregulloj të gjitha lëshimet e bëra gjatë zbatimit të kontratës të lidhur me autoritetin kontraktues-Komuna e Obiliqit.

I akuzuari B K ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke kërkuar nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh faktin se ai ka qenë i gatshëm të bëjë rregullimet e nevojshme në rrugët ku ka pasur lëshime dhe se këtë gatishmëri e ka shprehur pran organeve komunale në Komunën e Obiliqit, dhe po ashtu gjendjen e tij shëndetësore, pasi që është në pritje të transplantimit të mëlçisë, dhe kështu të i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata në funksion të vërtetimit të gjendjes faktike në këtë çështje penale ka administruar provat e propozuara nga palët në procedur dhe atë: dëshmitë e dëshmitarëve A K dhe N M , si dhe provat materiale: shkresa nga organi mbikëqyrës, lënda: "Asfaltimi i rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik" në gjatësi L=1650m " e datës 13.03.2014, vendimi mbi emërimin e menaxherit të projektit, i datës 05.12.2012, vendimi mbi emërimin e menaxherit të projektit i datës 27.08.2012, shkresa nga menaxheri i projektit, lënda "Raporti i punëve të kryera" e datës 14.12.2012, kërkesa e aprovuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA), për përshpejtimin e procedurës së projektit "Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik L=250 m dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë L=580 m", shkresa nga menaxheri i projektit, lënda: "Raporti i punëve të kryera" e datës 16.04.2013, për shumën 18,683.54 €, situacioni i parë për vazhdimin e asfaltimit të rrugës në Breznicë lagja Koskovik me nr. të prokurimit , L=250 m, i datës 16.04.2013, fatura e "D -i " e datës 16.04.2013 për shumën 18,683.54 €, raporti i pranimit, i datës 19.04.2013 nga zyrtari pranues H R i datë 19.04.2013, urdhër blerje e datë 19.04.2013 për shumën 18,683.54, urdhër Për Pagesë i datës 23.04.2013 për shumën 18,683.54 €, raporti i vlerësimit të tenderëve me nr. të prokurimit , kontrata e lidhur në mes të Komuna e Obiliqit dhe OE "D -I " shpk, me titull "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë" me nr.



identifikues: [redacted] e datës 03.12.2012, me çmim në shumën prej 44,954.53 €, raportet mbi modulit të ngjeshmërisë, lëshuar nga Laboratori IMK “B [redacted]” Prishtinë 2013, për projektet: Kozaricë dhe Asfaltimi i rrugës në Kozaricë, shkresa nga menaxheri i projektit, lënda: “Raporti përfundimtar i ekzekutimit të punimeve” e datës 27.09.2013, plani për menaxhimin e kontratës e datës 14.12.2012, raporti nga menaxheri i projektit, lënda: “Raport mbi menaxhimin e kontratës” e datës 11.04.2013. situacioni përfundimtar për asfaltimin e rrugës në fshatin Kozaric, L=560 m, përpiluar me datë 27.09.2013, fatura e “D [redacted] -i ” e datës 09.10.2013 për shumën 26,270.75 €, raporti i Pranimit, i datës 14.10.2013, urdhër Blerje e datës 14.10.2013, për shumën 26,270.75 €, urdhër Për Pagesë i datës 18.10.2013, për shumën 26,270.75 €, vendim, mbi caktimin e komisionit për pranim teknik i datës 04.10.2013, për projektin, “Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë” me numër të prokurimit [redacted], raporti përfundimtar i komisionit i datës 09.10.2013, për projektin, “Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë” me numër të prokurimit [redacted], lista e stafit të kualifikuar që do të angazhohet për realizimin e këtij projekti, dorëzuar nga OE “D [redacted] -i ”, vendimi nga OE “D [redacted] -i ” i datës 22.10.2012, ditari mbi punën e kryer nga OE “D [redacted] -I ” në fshatin Breznicë, lagja “Kosokovik” L=250 nga data 03 deri 14.12.2012, dhe për rrugë në fshatin Kozaricë L=560 m nga data 15.04 deri 10.08.2013, raporti i vlerësimit të tenderëve me nr. te prokurimit [redacted], kontrata e lidhur në mes të Komuna e Obiliqit dhe OE N. [redacted]. “P [redacted] C [redacted]”, me titull “Asfaltimi i rrugëve rurale”, me numër të Prokurimit [redacted], e datës 24.05.2013 me çmim në shumën prej 150,232.53 €, vendim, mbi emërimin e menaxherit të projektit, i datës 28.05.201, aneks Kontrata e lidhur në mes të Komuna e Obiliqit dhe OE N. [redacted]. “B [redacted] C [redacted]”, me titull “Asfaltimi i rrugëve rurale”, me numër të Prokurimit [redacted] e dt. 15.08.2013, me çmim në shumë prej 7,710 €, plani për menaxhimin e kontratës e datës 19.08.2013, raporti i punëve të kryera në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” i datës 05.08.2013, raporti i punëve të kryera në aneksin e projektit “Asfaltimi i rrugëve rurale” i datës 19.08.2013, me nr. protokollit [redacted], raport përfundimtar i punëve të kryera në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” i datës 19.08.2013, me nr. protokollit [redacted], raportet testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B [redacted] B [redacted] C [redacted]” të datës 13.08.2013, 16.08.013, 08.03.2013, 12.08.2013, 10.08.2013, fatura e “B [redacted] C [redacted]” e datës 07.10.2013 për shumën 15,794.25 €, raporti i pranimit, i datës 09.10.2013 nga zyrtari pranues H [redacted] D [redacted], urdhër Blerje e datës 09.10.2013, për shumën 15,794.25 €, urdhër Për Pagesë i datës 10.10.2013, për shumën 15,794.25 €, fatura e “B [redacted] C [redacted]” e datës 20.08.2013 për shumën 14,542.53 €, raporti i pranimit, i datës 05.09.2013 nga zyrtari pranues H [redacted] D [redacted], urdhër Blerje e datës 22.08.2013, për shumën 14,542.53 €, urdhër Për Pagesë i datës 09.09.2013, për shumën 14,542.53 €, fatura e “B [redacted] C [redacted]” e datës 20.08.2013 për shumën 36,486.39 €, raporti i pranimit, i datës 05.09.2013 nga zyrtari pranues H [redacted] D [redacted], urdhër Blerje e datës 05.09.2013, për shumën 36,486.39 €, urdhër Për Pagesë i datës 09.09.2013, për shumën 36,486.39 €, fatura e “B [redacted] C [redacted]” e datës 20.08.2013 për shumën 9,605.75 €, raporti i pranimit, i datës 05.09.2013 nga zyrtari pranues H [redacted] D [redacted], urdhër Blerje e datës 05.09.2013, për shumën 9,605.75 €, urdhër Për Pagesë i datës 09.09.2013, për shumën 9,605.75 €, kërkesa nga “B [redacted] C [redacted]” e datës 02.08.2013, situacioni “asfaltimi i rrugëve rurale” me numër të Prokurimit [redacted], përpiluar me datë 02.08.2013, fatura e “B [redacted] C [redacted]” e datës 02.08.2013 për shumën 73,803.61 €, raporti i pranimit, i datës 12.08.2013 nga zyrtari pranues H [redacted] D [redacted], urdhër Blerje e datës 12.08.2013, për shumën 73,803.61 €, urdhër Për Pagesë, për shumën 73,803.61 €, kërkesë me titull: “Raport nga menaxherja e projektit”, për projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” me numër të Prokurimit 614

13 014 521, e datës 02.07.2013, e protokolluar me datë 02.08.2013, kërkesë, me titull: Kërkojmë nga zyra e prokurimit që të bëhet sa më shpejtë aprovimi i projektit shtesë për projektin "Asfaltimi i rrugëve rurale", paramsa dhe paralogaria e punëve shtesë për projektin: "Asfaltimi i rrugëve Rurale", korrik 2013, situacioni me titull "Situata Parë dhe Përfundimtare e Punëve Shtesë në Projektin Asfaltimi i Rrugëve Rurale" me numër të Prokurimit [redacted] përpiluar me datë 19.08.2013, fatura e "P [redacted] C [redacted]" e datës 19.08.2013 për shumën 7,710.00 €, raporti i pranimit, i datës 05.09.2013 nga zyrtari pranues H [redacted] D [redacted], urdhër Blerje e datës 05.09.2013, për shumën 7,710.00 €, urdhër Për Pagesë i datës 05.09.2013, për shumën 7,710.00 €, vendim, mbi caktimin e komisionit për pranim teknik i datës 20.08.2013, për projektin "Asfaltimi i rrugëve rurale" me numër të prokurimit [redacted], raporti i komisionit për pranim teknik të projektit "Asfaltimi i Rrugëve Rurale" i datës 20.08.2013 me numër të Prokurimit [redacted] raportet e: Institutit të materialeve ndërtimore dhe konstruksioneve, N.SH. "I [redacted]" në P. [redacted], datë 11.03.2014, raporti i N.SH. "I [redacted]" Rruga fsh. Breznicë, lagja "Koskovik" L=250 m, raporti i N.SH. "I [redacted]" Rruga fsh. Kozaricë L=560 m, raporti i N.SH. "I [redacted]" Rruga fsh. Kozaricë L=340 m, raportii N.SH. "I [redacted]" Rruga fsh. Kozaricë, lagja "D [redacted]" L=400+100 m, raporti i N.SH. "I [redacted]" Rruga fsh. Kozaricë, lagja e "F [redacted]" L=845 m, raporti i N.SH. "I [redacted]" Rruga fsh. Kozaricë, lagja e "M. [redacted]" L=600 m, raporti i N.SH. "I [redacted]" Rruga fsh. Kozaricë, fsh. "Llazarevë" L=347 m, raporti i N.SH. "I [redacted]" Rruga fsh. Kozaricë, lagja e "Kurteshëve" L=290 m, raporti mbi plotësimin e ekspertizës nga: Instituti i materialeve ndërtimore dhe konstruksioneve, N.SH. "I [redacted]" në Prishtinë, datë 12.01.2015, fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes, mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar, Ekspertiza Financiare nga Eksperti Financiar Gjyqësor M [redacted] P [redacted] e datës 15.10.2014, raportet e policisë për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe atë: Raporti i datës 26.12.2014, raport për hyrje-daljet e thirrjeve telefonike dhe SMS-të për numrat 044/ [redacted] dhe 045/ [redacted], CD-ja e bashkangjitura raporteve të lartcekura, komunikim zyrtarë në mes të A [redacted] P [redacted] dhe me zyren e Rregullatorit të prokurimit publik, përmes email-it zyrtar ob [redacted] p [redacted] @hotmail.com dhe përgjegjies së kthyer nga KRPP përmes ekspertit të prokurorimit A [redacted] L [redacted], Përgjigjia nr. [redacted] e dt.30.11.2015 e Komisionit Rregullative të Prokurorimit Publike.

Gjykata pas administrimit të provave në seancat e mbajtura gjatë këtij shqyrtimit gjyqësor, të njëjtat i vlerësoi me vëmendje një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën në kuptim të nenit 361 të KPPRK-së, dhe si rezultat i vlerësimit të tyre, konstatoj se sa i përket të akuzuarve M [redacted] K [redacted], Xh [redacted] K [redacted], H [redacted] R [redacted], N [redacted] G [redacted], R [redacted] H [redacted], B [redacted] P [redacted], H [redacted] D [redacted], A [redacted] S [redacted], dhe A [redacted] P [redacted], nuk është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, se të njëjtat kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Nga leximi i deklaratës së dëshmitarit N [redacted] M [redacted] të dhënë në polici për leximin e të cilës janë pajtuar paraprakisht palët në procedurë, rezulton se i njëjti punon në Komunën e Obiliqit në pozitën e D [redacted] të Administratës Publike dhe atë prej 08.01.2014 e tutje dhe në të njëjtën kohë ushtron funksionin e p [redacted] të autorizuar të komunës së Obiliqit, ndërkaq lidhur me këtë çështje penal në cilësinë e dëshmitarit ka deklaruar se punët nuk janë kryer në pajtim me kontratat nga OE "B [redacted] C [redacted]" dhe "D [redacted] I [redacted]" duke shtuar se Komuna është dëmtuar si në aspektin material ashtu edhe atë kohor për shkak të neglizhencës dhe papërgjegjësisë së të njëjtave. Më tutje ka shtuar se paraqet kërkesë pasurore juridike. Gjykata e vlerësoj dëshminë e këtij dëshmitari, mirëpo nga kjo dëshmi nuk mund të vërtetohet asnjë fakt relevant që ka të bëjë

me fajësinë e të gjithë të akuzuarve në këtë çështje penale, ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike, me asnjë provë konkret materiale, nuk e ka precizuar qoftë plotësisht apo pjesërisht një kërkesë të tillë.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar përmes dëshmitarëve dhe provave materiale, dhe atë:

Nga kontrata nr. [redacted] të datës 22.08.2012, vërtetohet se autoriteti kontraktues Komuna e Obiliqit dhe OE "D [redacted] I [redacted] shpk, kanë lidhur kontratë për realizimin e projektit me titull "Asfaltimi i rrugës Breznic-lagjia Koskovik" me gjatësi L=1650 m, me nr. të prokurorimit [redacted]. Ndërsa që i akuzuari M [redacted] K [redacted], atëherë në cilësinë e k [redacted] te K [redacted] se C [redacted], me vendimin e dt. 27.08.2012 të akuzuarin Xh [redacted] K [redacted] dhe zotin F [redacted] P [redacted], i ka emëruar menaxher të projektit të lartëcekur, që të bëjnë përcjelljen punimeve, ndërsa që për punën e tyre duhet të i përgjigjen Drejtorisë së PUKP, ZKF dhe menaxherit të prokurorimit.

Nga Kërkesa nr.379 e dt.09.10.2012 lëshuar nga DSHPE-I [redacted] B [redacted], dhe aprovuar nga ZKA-k [redacted] komunës së O [redacted] tani i akuzuari M [redacted] K [redacted], vërtetohet se nga zyra e prokurorimit është kërkuar përsheptimi i procedurës për shpalljen e ofertave për projektin "Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik L=250 m dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë L=580 m". Ndërsa që nga raporti i vlerësimit të tenderëve me nr. te prokurimit [redacted] i dt.22.11.2012 me titull: "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë", vërtetohet se pas zhvillimit të të gjitha procedurave të tenderimit, komisioni i vlerësimit ka propozuar që OE "D [redacted] i [redacted]" të shpallet fitues si OE i cili është i përgjegjshëm dhe me çmim më të ultë, në vlerë prej 44,954.29 euro. Gjykata vlerëson se nga të njëjtat vërtetohet bindshëm fakti se lidhur me projektin e lartcekur janë respektuar të gjitha procedurat e përcaktuara me Ligjin për Prokurorim Publik, i cili në nenin 60, lidhur me kriteret për dhënien e kontratës parasheh që autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që është i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, kriteret këto të plotësuara në rastin konkret nga OE "D [redacted] I [redacted]".

Nga Kontrata nr. [redacted] e dt.03.12.2013 me nr.prokurorimit [redacted], e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktues Komuna e Obiliqit përfaqësuar nga menaxheri i prokurimit tani i akuzuari A [redacted] P [redacted], dhe OE "D [redacted] -I [redacted]" shpk përfaqësuar nga drejtori i të njëjtës tani i akuzuari E [redacted] S [redacted], vërtetohet se e njëjta është lidhur për realizimin e projektit me titull "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë" për çmimin në shumën prej 44,954.53 €. Më tutje në të njëjtën janë përcaktuar obligimet e marrura nga OE "D [redacted] I [redacted]" lidhur me lagjen Koskovik L=250m ishte paraparë që: furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorrit me fraksion 0(0-60mm), t-15cm me dim250x5.50x0,15 me ngjeshje adekuate >35MPa; furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorrit me fraksion 0(0-31mm), t-10cm me ngjeshje adekuate >35Mpa; asfaltimi me asfaltbeton 0-16 t-60mm me dim S=250x4,50; asfaltimi me asfaltbeton 0-11 t-40mm me dim S=250x4,50. Ndërsa që rrugën në fshatin Kozaric L=560 ishte paraparë: furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorrit me fraksion 0(0-60mm), t-15cm me dim.580x5,50x0,15 me ngjeshje adekuate >35MPa; furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorrit me fraksion 0(0-31mm), t-10cm me ngjeshje adekuate >35Mpa; asfaltimi me asfaltbeton 0-16 t-70mm me dim S=560x4,0m. Ndërsa sipas nenit 9 të kontratës së përmendur është paraparë që koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të i siguroj kontraktues, që sipas neni 1 par.3 të kontratës është operatori ekonomik i cilë është palë në

kontratë, pra OE "D... I...". Ndërkaq që nga Vendimi, mbi emërimin e menaxherit të projektit, i datës 05.12.2012, vërtetohet se tani i akuzuari H... R... është emëruar menaxher projektit nga tani i akuzuari M... K... atëherë në cilësinë e k... të K..., për projektin "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë" dhe sipas këtij vendimi rezulton se punimet do të fillojnë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe duhet të përfundojnë sipas planit dinamik të cekur me kontratë për 35 ditë. Gjykata vlerëson nga këto prova vërtetohet bindshëm fakti se nuk ka qenë në obligimin e autoritetit kontraktues kryerja e testeve lidhur me cilësinë e materialit të përdorur për realizimin e projektit të lartcekur, prandaj tani të akuzuarit H... R... në cilësinë e menaxherit të projektit, dhe të akuzuarit N... C..., R... H... dhe B... P... në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për pranim teknik të projektit të lartcekur, kishin vepruar pikërisht duke u bazuar në obligimin e OE-së kontraktues që të i sjell rezultatet e testimit, dhe fakti që të njëjtat ishin realizuar nga një institut i licencuar siç ishte Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore BC "B... C..." tek të njëjtit ka krijuar gjithë arsyeshmërin e nevojshme, se të njëjtat paraqesin gjendjen reale të rrugëve të punuar dhe se materialet e përdorura ishin në pajtim me kriteret e përcaktuar në kontratë.

Nga Plani për menaxhimin e kontratës..., dt.14.12.2012 i përgatitur nga H... R... dhe i nënshkruar nga i njëjti e po ashtu i nënshkruar edhe nga kontraktuesi "D...-i..." sh.p.k përfaqësuar nga drejtori E... S..., vërtetohet fakti që i akuzuari H... R... duke vepruar në përputhje me detyrat e përcaktuara në aktin e emërimit ka përgatitur planin e lartcekur duke konstatohet se deri me datë 14.12.2012 është bërë implementimi i tërësishëm i seksionit të paraparë në kontratë të kësaj rruge.

Nga Ditari mbi punën e kryer nga OE "D...-I..." në fshatin Breznicë, lagja "Koskovik" L=250 nga data 03 deri 14.12.2012, dhe për rrugë në fshatin Kozaricë L=560 m nga data 15.04 deri 10.08.2013, vërtetohet bindshëm fakti se i akuzuari H... R... në përputhje me përgjegjësit e tij ka vepruar në përmbushje të të njëjtave duke mbikëqyrur në vazhdimësi zhvillimin e punimeve në realizimin e këtyre projekteve.

Nga (2) dy raportet me titull: Raporti mbi modulit të ngjeshmërisë, lëshuara nga Laboratori IMK "B... P..." Prishtinë 2013, për projektet: Kozaricë dhe Asfaltimi i rrugës në Kozaricë, vërtetohet se të njëjtat janë bërë vetëm lidhur me modulën e ngjeshmërisë, ndërsa që matjet janë bërë më kërkesën e organit mbikëqyrës.

Nga "Raporti i punëve të kryera" e datës 14.12.2012, lidhur me projektin "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë" të përpiluar nga menaxheri i projektit tani i akuzuari H... R... për zyrën e prokurimit, rezulton se i njëjti ka konstatuar se gjatë përcjelljes së punimeve për këtë projekt kompania e kontraktuar ka filluar me ekzekutimin e punëve në fshatin Breznicë lagjja Koskovik si dhe ka bërë kryerjen e pozicioneve të theksuar në këtë raport, është bërë përcjellja e vazhdueshme e punimeve, janë marrë fotografi gjatë të ekzekutimit të punëve dhe se të gjitha pozicionet janë kryer sipas kontratës, planit dinamik si dhe normave teknike ndërtimore. Gjykata vlerëson se edhe nga ky raport i administruar në cilësinë e provës në këtë çështje penale, vërtetohet bindshëm fakti se tani i akuzuari H... R... në cilësinë e menaxherit të projektit ka vepruar në pajtim me përgjegjësit e caktuara me vendimin mbi emërimin në këtë cilësi. Pra formalisht, i akuzuari H... R..., më të

drejtë ka konstatuar se punët kanë përfunduar, ndërsa që të dhënat lidhur me cilësinë dhe sasinë e asfaltit dhe zhavorrit, i njëjti është mbështetur në raportet më të dhëna të ofruara nga OE kontraktuese i cili kishte angazhuar një institut të licencuar siç ishte Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B C".

Nga "Raport mbi menaxhimin e kontratës" nr. , datë 11.04.2013 për projektin "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë", përpiluar nga menaxheri i projektit tani i akuzuari H R për zyrën e prokurimit, vërtetohet se i njëjti pasi që konstaton se është zgjedhur problemi lidhur me financimin e projektit të lartcekur, i njëjti përshkruan vështirësitë e paraqitura gjatë implementimit të këtij projekti. Gjykata vlerëson se dhe nga ky raport i administruar në cilësinë e provës, vërtetohet fakti se i akuzuari H R ka vepruar me gjithë angazhimin e nevojshme në përputhje me detyrat që i kishte në cilësinë e menaxherit të projektit, duke qenë vazhdimisht në teren gjatë realizimit të projektit të referuar më lart.

Nga Raportet e punëve të kryera" nr.V-255, dt.16.04.2013, të përpiluar nga menaxheri i projektit, tani i akuzuari H R vërtetohet se i njëjti ka konstatuar se OE "D I " ka përfunduar pozicionet e parapara me këtë pjesë të kontratës, duke përfshirë të gjitha punimet e parapara për rrugën "Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik". Po ashtu në këtë raport konstatohet se gjatë punimit të pozicioneve të lartcekura është bërë përcjellja e vazhdueshme, janë marrë fotografi gjatë ekzekutimit të punëve dhe se të gjitha pozicionet janë kryer sipas kontratës, planit dinamik si dhe normave teknike ndërtimore dhe se i njëjti vlerëson se OE "D I " mund ti bëhet pagesa e situacionit të parë për shumën 18,683.54 €. Gjykata vlerëson se edhe përmes këtij raport vërtetohet fakti se i akuzuari Haki Raqi ka vepruar në përmbushje të detyrave të përshkruara me vendimin mbi emërimin në cilëson e organit mbikëqyrës. Gjykata në këtë rast e gjetur të bazuar mbrojtjen e të akuzuarit H R , i cili e ka pohuar faktin se rruga në gjatësi prej 250 sa është përfshirë në këtë segment, është shtruar nga OE fituese pas shpalljes së të njëjtës fituese të projektit të lartcekur, mirëpo para së të kalojë periudha e mundësisë për ankesa, çka e ka bërë që ky raport sa i përket datës të përpilimit të tij të mos përputhet me realizimin e punimeve në teren, mirëpo ai nuk ka ditur ndonjë mënyrë tjetër raportimi, ndërsa që sa i përket realizimit të kushteve të përcaktuara në kontratë, të njëjtat janë realizuar në tërësi, dhe kjo edhe për faktin se ai thajse gjithë kohën ka qenë i pranishëm gjatë realizimit të kësaj gjatësie rruge. Gjykata vlerëson se kjo mbrojtje është në përputhje edhe me deklaratimet e të akuzuarve tjerë, siç është rasti më të akuzuarin E S i cili në deklaratën e dhënë në prokurori dt.23.09.2014 e ka pohuar faktin se i akuzuari H R gjatë realizimit të segmentit të rrugës prej 250 m ka ardhur shpesh për të i përcjellur zhvillimin e punimeve. Po ashtu, gjykata vlerëson se në këtë situatë në të cilën është gjendur i akuzuari H R nuk ka pasur mundësi tjetër veprimi, përveç nëse e njëjta do rishtohet përsëri gjë që nuk duket as mundshme dhe as e logjikshme, derisa që shtrimi i së njëjtës nga OE "D I " para përfundimit të periudhës së ankesave ishte nën përgjegjësinë e së njëjtës, dhe se kjo në asnjë mënyrë nuk ka ndikuar që ky OE të fitoj kontratën për realizimin e këtij projekti, gjë që vërtetohet nga raporti i vlerësimit të tenderëve dt.22.10.2012, i administruar në cilësinë e provës në këtë çështje penale. Po ashtu gjykata vlerëson faktin se në përmbajtje e vetë ky raport paraqet pasqyrim real të punëve të realizuara, përveç cilësisë dhe trashësisë së asfaltit dhe zhavorrit, që ka qenë nën përgjegjësinë e OE-së kontraktuese kryerja e testimit për të njëjtat.

Nga Raportet e pranimit, të datës 19.04.2013 dhe dt.14.10.2013 nga zyrtari pranues H. R., për te zyrtari autorizues A. S., vërtetohet se zyrtari pranues tani i akuzuari H. R. në këtë raport konstaton se kompania e kontraktuar për implementimin e projektit “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë Lagja Koskovik” që ka pas si qëllim asfaltimin e rrugës 250 m është kryer sipas normave teknike dhe planit dinamik të paraparë në kontratë, gjegjësisht se të gjitha punimet e ekzekutuara janë kryer konform rregullave teknike ndërtimore, sipas përmasës dhe parallogaris së kontraktuar”. Gjykata vlerëson se përmes këtyre raporteve të administruara në cilësinë e provave materiale vërtetohet fakti se i akuzuari H. R. ka vepruar në plotëni në përputhje me vendimin për emërimin menaxher i projektit dhe kontratën e dt.03.12.2012, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme, ka dalur në teren dhe në bazë të dinamikës së punës dhe dokumenteve të nevojshme, ka përpiluar raportet e lartcekura, në të cilin ka referuar edhe vlerën e punëve të kryera deri në momentin e përpilimit të raportit, e që në këto raporte i njëjti është mbështetur në të dhënat nga Raportet testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore BC ”B. C”, në të cilat është konstatuar se trashësia dhe përbërja e zhavorrit dhe asfaltit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në kontratë.

Nga “Raporti përfundimtar i ekzekutimit të punimeve” nr. V-659, dt. 27.09.2013 lidhur me projektin “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë”, vërtetohet se në të njëjtin janë konstatuar aktivitetet të cilat janë konsideruar se përmbushur 100%, dhe se një vlerësim i tillë është mbështetur në rezultatet e ofruar nga laboratorët për verifikimin e materialeve, trashësisë dhe përbërësve tjerë, B. P. dhe B. C. -Gj., dhe po ashtu në vizitat e njëpasnjëshme në teren. Prandaj, ka konstatuar se OE-se mund të i bëhet pagesa pozicioneve të ekzekutuara sipas situacionit të dytë dhe përfundimtarë. Po ashtu, ka rekomanduar që nga drejtoria kompetente të iniciohen procedurat për pranimin teknik të projektit. Gjykata vlerëson se po ashtu edhe nga ky raport vërtetohet bindshëm fakti së i akuzuari H. R., duke u mbështetur në dokumentet e nevojshme, në veçanti në rezultatet e ofruara nga laboratorët e lartcekura, që sipas rezultateve të pasqyruara në të njëjtat, rezultojnë se projekti është përmbushur në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë, ka vlerësuar se punët janë përmbushur në tërësinë e tyre. Gjykata vlerëson se në kushtet e posedimit të këtyre raporteve, të dalura nga laboratorët të certifikuar për këtë lloj veprimtarie, i akuzuari H. R., nuk e ka ditur dhe as që ka mundur të dijë, se të njëjtat nuk pasqyrojnë gjendjen reale të realizueshmërisë së këtij projekti.

Nga raportet testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B. ”B. C”, gjegjësisht: raporti testues-tampon-0-63mm i dt.08.03.2013 në të cilin konstatohet se materiali i plotëson normat; Raporti testues-tampon 03-31.5mm i dt. 06.07.2013 në të cilin konstatohet se materiali i plotëson normat; raporti testues-mostrat e nxjerra nga rruga pas asfaltimit-asfaltimi i rrugëve rurale në obiliq:Dardhisht, Fanakt, Masgit, Kurtisht, Mavriqt, Lazarev dhe Kozaricë i dt.16.08.2013, në të cilin konstatohet se mestaria e trashësisë së asfaltit është 8.0cm; raporti testues Analiza e përzirjes bituminoze-asfaltimi i rrugëve rurale në K. Obiliq: Lagja Mavriqët, rruga në fshatin Mazgit dhe Lagja Kurteshve i dt. 12.08.2013; raporti testues Analiza përzirjes bituminoze-asfaltimi i rrugëve rurale në K. Obiliq: rruga Lazarev dhe rruga në fshatin Kozaricë dt.13.08.2013; raporti mbi shqyrtimin gjeomekanik-asfaltimi i rrugëve rurale në Obiliq dt.10.08.2013; raportet testues-tampon 0-63mm dhe tampon 0-31.5mm të dt.08.03.2013 në të cilin konstatohet se materiali i plotëson normat; raporti testues mostrat e

nxjerrura nga rruga pas asfaltimit-asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaric dt.16.08.2013 në të cilin konstatohet se trashësia mesatare e asfaltit është 7.03cm, zbrastësirat 6.7% dhe kompaktimi 96,9%; raporti testues analiza përzirjes bituminoze-asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaric dt.13.08.2013 në të cilin konstatohet se trashësia mesatare e asfaltit është 7.03cm. Gjykata vlerëson se përmes këtyre raporteve të administruar në cilësinë e provës vërtetohet fakti se tani të akuzuarit Xh. K., H. R., N. G., R. H., B. P., H. D., qoftë në cilësinë e organit mbikëqyrës apo anëtarëve të komisioneve të pranim teknik të projekteve “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë” dhe “Asfaltimi i rrugëve rurale”, ishin vënë në lajthim nga përmbajtja e këtyre raporteve në të cilat konstatoheshin të dhëna lidhur me trashësinë dhe përbërjen e zhavorrit dhe asfaltit që ishin në përputhje me kriteret e përcaktuar në kontratë dhe se të njëjtit pikërisht duke u bazuar në të dhënat që përmbanin këto raporte kanë përpiluar raportet respektive në të cilat konstatohet se projektet janë duke u realizuar apo janë realizuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë.

Nga Vendimi mbi caktimin e komisionit për pranim teknik nr.III-452, dt. 04.10.2013, për projektin, “Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë”, vërtetohet se anëtarë të komisionit të lartcekur janë caktuar tani të akuzuarit N. G. R. H. dhe B. P., ndërkaq që në të njëjtin konstatohet se sipas raportit të organit mbikëqyrës punët nga OE “D. i ” janë kryer sipas paramasës dhe parallogarisë dhe se komisioni të del menjëherë në teren për vlerësimin përfundimtar të projektit të lartcekur. Ndërsa që nga Raporti përfundimtar i komisionit, nr.V-678, dt. 09.10.2013, për projektin, “Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë” vërtetohet se me datën 08.10.2013 komisioni ka konstatuar se bazuar në dokumentacionin e pranuar nga menaxheri i projektit është vërtetuar se punimet janë të përfunduara në afatin kohor sipas planit dinamik të paraqitur nga OE, janë respektuar normat teknike të parapara për rrugët e kësaj kategorie dhe se vlerësimi përfundimtar i komisionit është se projektet në fjale janë të përfunduara pa vërejtje. Gjykata vlerëson se përmes këtyre raporteve vërtetohet bindshëm fakti se komisioni i lartcekur duke vepruar në përputhje me vendimin mbi emërim, ka ndërmarrur të gjitha veprimet e nevojshme, ka dalur në teren, dhe pas kontrollimi të nevojshme bazuar në kontratën ekzistuese dhe përmasave dhe parallogaris të paraparë në kontratë, raporteve të organit mbikëqyrës, ditarit ndërtimor dhe raporteve të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B. C., lidhur me trashësinë dhe përbërjen e zhavorrit dhe asfaltit, ka përpiluar raportin në përmbajtjen e lart referuar dhe në aspektin formal kanë qenë të përmbushur të gjitha parametrat në bazë të kontratës.

Nga raporti i vlerësimit të tenderëve 11-04-2013, vërtetohet se lidhur me projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale”, në përputhje me ligjin për Prokurorim Publik, është zhvilluar procedurat e tenderimit, në të cilin kanë ofertuar njëmbëdhjetë (11) OE, dhe se komisioni vlerësues në përputhje me nenin 60 të LPP-së i cili parasheh përgjegjshmërinë dhe çmimin më të lirë si kritere përcaktuese me rastin e vlerësimit të tenderve nga autoriteti kontraktues, ka përzgjedhur OE “B. C.” si fitues të këtij tenderi. Ndërsa që nga kontrata e dt.24.05.2013 me numër të Prokurimit, vërtetohet se ndërmjet autoritetit kontraktues Komuna e Obiliqit të përfaqësuar nga menaxheri i prokurorit A. P. dhe OE N. “B. C.” të përfaqësuar nga menaxheri R. G. është lidhur kontrata për realizimin e projektit me

titull "Asfaltimi i rrugëve rurale", për çmimin në shumën prej 150,232.53 €, në të cilën janë përfshirë rrugët: Kozaricë L=340m, Dardhishtë L=400m+100m, Lagja e Fanakëve L=845m, Lagja e Mavriqëve L=600m, Llazarevë L=347m, dhe Lagja Kurtshëve L=290m dhe janë specifikuar parmentrat e veçant lidhur me paramasat dhe afati i përfundimit të projektit. Po ashtu nga vendimi dt.28.05.2013 vërtetohet se menaxhere e projektit është emëruar tani e akuzuara H. D., e cila kishte për detyrë që të plotësoj planin për menaxhimin e kontratës ku do të specifikoheshin të gjitha përgjegjësit e saj. Gjykata ka vlerësuar edhe këto prova, nga të cilat vërtetohet bindshëm fakti se kontratës se lartcekur i ka paraprirë procedura e rregullt tenderimi e cila është zhvilluar në përputhje të plotë me ligjin e Prokurimit Publik, janë përcaktuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë edhe obligimin e paraparë në nenin 9 të kontratës sipas të cilit koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të i siguroj kontraktues, që sipas neni 1 par.3 të kontratës është operatori ekonomik i cili është palë në kontratë. Gjykata vlerëson se edhe duke e pasur parasysh këtë fakt, tani të akuzuarit H. R., N. G. dhe Xh. K. dhe H. D., në përpilimin e raporteve respektive janë mbështetur në këto teste, që duke qenë se OE "B. C." kishte angazhuar një institut të licencuar siç ishte Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B. "B. C.", tek të njëjtit ka krijuar pritjen e arsyeshme që të dhënat e dalura nga raportet e hartuar nga ky institut paraqesin të dhëna reale reale që reflektojnë cilësinë dhe sasin e materialeve të përdorura gjatë realizimit të projektit tv lartcekur.

Nga Kërkesa e protokolluar me dt.02.08.2013 me titull: "Raport nga menaxherja e projektit", për projektin "Asfaltimi i rrugëve rurale" vërtetohet se tani e akuzuara H. D. në cilësinë e menaxheres se projekti i është drejtuar menaxherit të zyrës së prokurimit A. P., ndërkohe kërkesë është e aprovuar nga ZKA, K. i Komunës së O. M. K., e përmes të cilës ka kërkuar që aprovimin e mjeteve shtesë nga zyra e prokurimit, meqenëse pas matjes, rimatjes dhe rikalkulimit të paramasave dhe sasive të materialeve të planifikuara, është paraqitur nevoja rritjes së sasive të materialeve për realizimin e rrugëve dhe formimin e kontinuitetit strukturor te traseve të reja me ato ekzistuese, sipas paramases dhe parallogarisë e cila i janë bashkëngjitur raportit. Ndërsa që nga "Paramsa dhe parallogaria e punëve shtesë për projektin "Asfaltimi i rrugëve Rurale" e muajit Korrik 2013, vërtetohet se i njëjti është punuar nga menaxheria e projektit të lartcekur tani e akuzuara H. D. dhe është miratuar nga A. S. D. në P.N.K.Z, e në të cilin përshkruhen natyra e punëve shtesë që kryesisht konsistojnë në furnizimin, transportin dhe vendosjen e zhavorrit, pastaj germimi i shtresës së përzier zhavorr/humus deri në nivelin e kërkuar, pastrimi i shkurreve në pjesët anësore të rrugës. Gjykata ka vlerësuar edhe këto materiale të administruar në cilësinë e provës, e nga të cilat ka vërtetuar bindshëm faktin se duke vepruar në përputhje me vendimin e emërimit në cilësinë e menaxheres së projektit dhe në realizim të autorizimeve të saj, tani e akuzuara H. D., e cila duke u përballur me nevojën për material shtesë, e në funksion të realizimit të projekti të lartcekur ka kërkuar aprovimin e punëve shtesë, të cilat konsistojnë në materiale të përfshira në kontratën bazë, por që gjatë zhvillimit të projektit është kuptuar se të njëjtat nuk janë planifikuar në sasin e nevojshme për të u realizuar projekti i lartcekur në gjithë kushtet e përcaktuara me kontratë. Më tutje për tu kuptuar natyra e punëve shtesë, gjykata gjenë të rëndësishme të thekësor faktin se natyrën e këtyre punëve apo shërbimeve përcaktohet nga dy faktor periudha dy vjeqare dhe kufizueshmeria deri në 10% të kontratës bazë, e kushtëzuar nga procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratën me Operatorin Ekonomik që është apo ka realizuar kontratën bazë. Kufizueshmeri deri në 10% të shumës se kontratës bazë, përlligjet me



faktin se për autoritetet kontraktuesë është i vështir një planifikim në tanësi i nevojave për materiale në funksion të realizimit të projekteve infrastrukturore por jo vetëm, ndërsa që do ishte e paarsyeshme zhvillimi i procedurës së tenderimit, duke pasur parasysh natyrën e punëve, që pikerisht ka të bëjë me punë që janë në përputhje me projektin bazë. Po ashtu përcaktimi i periudhës deri në dy vite pas përfundimit të kontratës fillestare, përligjet me natyrë e punëve ose shërbimeve që duhet të jenë të ngjajshme dhe në përputhje me kontratën fillestare, pasi që kalimi nëpër procedurat e tenderimit për punë të kësaj natyre dhe me këtë vlerë, do ishte një koste që nuk do të arsyetohej me parimin se kontratat publike duhet të jenë të hapura ndaj një konkurrencë të lirë dhe të ndershme në mes të OE potencialë, edhe pse gjykata thekson faktin se konkurrenca e lirë dhe e ndershme është mënyra e vetme për të pasur përdorimin sa më ekonomik të fondeve publike, mirëpo gjithëmon duke pasur parasysh rastet përjashtimore zbatimi i të cilave është përcaktuar qartësisht me kritere strikte në nenin 35 të ligjit për Prokurorikm Publik.

Nga Aneks Kontrata dt. 15.08.2013 me numër të Prokurimit [redacted], vërtetohet se njëjta është e lidhur në mes të autoritetit kontraktues Komuna e Obiliqit përfaqësuar nga menaxheri i prokurimit A [redacted] P [redacted] dhe kontraktuesit OE N. [redacted]. “B [redacted] C [redacted]”, përmes përfaqësuesit të saj menaxherit S[redacted] K [redacted] për çmimin në shumën prej 7,710.00 €, në të cilën përfshihen rrugët Kozaric (L=340m)/B=4,0m; Dardhishtë-(L=400m+100m)/B=4,0; lagja e Franakëve-(L=845m)/B=4,0m;laxha e Mavriqëve(L=600m)/4,0m; Llazarevë(L=347m)/B=4,0m; Laxha e Kurtshëve(L=290m)/B=4,0m. Ndërsa që sa i përket kushteve të përgjithshme të anekse kontratës, mbesin të njëjta me ato të përcaktuar me kontratën bazë, që ishte lidhur për realizimin e projektit “Asfaltimi i rrugëve Rurale”. Gjykata vlerëson se aneks kontrata është lidhur në përputhje të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i cili në nenin 35.2.4 (i) dhe (ii), ka përcaktuar se kur në rrethana të paparashikuar janë bërë të nevojshme shërbime apo punë shtesë që nuk janë përfshirë në konceptin fillestar të një projekti të punëve të dhëna me parë ose punët apo shërbimet e reja, një kontratë e shërbimeve apo punëve mund të shfrytëzohet nëse i ipet operatorit ekonomik që është duke i ekzekutuar shërbimet ose punët fillestare, që në rastin konkret është OE “B [redacted] C [redacted]”; që shërbimet ose punët e tilla shtesë, teknikisht ose ekonomikisht nuk mund të ndahen nga kontrata kryesore pa i shkaktuar dëm autoritetit kontraktues dhe që të njëjtat janë rreptësisht të domosdoshme për atë kompletim e që mos përmbushja e të njëjtave do ta dëmtonte në thelb projektin të paraparë të realizohet me kontratën kryesore, e që po ashtu është përmbushur në rastin konkret pasi që nisur nga natyra e punëve që reflekton edhe në lartësinë e shumës të aneks kontratës së lidhur, vërtetohet se të njëjtat nuk kanë mundur të ndahen nga kontrata kryesore gjë që vërtetohet nga shkresa “Paramsa dhe parallogaria e punëve shtesë për projektin: Asfaltimi i rrugëve Rurale” e muajit Korrik 2013 e cila është administruar në cilësinë e provës në këtë çështje penale; e që kjo mundësi mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime ose punë shtesë që vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës fillestare, e që po ashtu është përmbushur në rastin konkret pasi që vlera e kontratës bazë është në shumën prej 150,232.53 euro, ndërsa që kontrata për punët shtesë përfshin vlerën prej 7,710.00 euro, që kthyer në përqindje i bie rreth 5% të vlerës së përgjithshme të kontratës bazë dhe se kjo procedure është shfrytëzuar brenda periudhës kohore prej dy viteve pas përfundimit të kontratës fillestare, që në rastin konkret nevoja për punë shtesë ka dalur gjatë zhvillimit të projektit. Në këto kushte, kur aneks kontrata është lidhur në përputhje të plotë me ligjin për Prokurorim Publik, gjykata vlerëson se i akuzuari M [redacted] K [redacted] në të gjithë veprimet e ndërmarra në cilësinë e k [redacted] të komunës së O [redacted] nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 të Ligjit

për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048 dhe nenin 3 dhe 4 par.1 të Rregulla Financiare e Thesarit 01/10.

Nga Raporti i punëve të kryera në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” nr.524, dt. 05.08.2013, dhe nga raporti i punëve të kryera në aneksin e projektit “Asfaltimi i rrugëve rurale” nr.557, që mban datën 19.08.2013 të përpiluar nga menaxherja e projektit tani e akuzuara H. D. drejtuar organeve kompetente në komunën e Obiliqit, rezulton se e njëjta ka konstatuar se në këtë projekt është punuar në mënyrë profesionale dhe në harmoni me rregullat teknike të ndërtimit, ka referuar natyrën e punëve të kryera dhe ka vlerësuar se OE-së kontraktuese të punëve, mundë ti bëhet pagesa e pjesës së parë sipas situacionit të punëve të kryera në vlerë prej 73.803,61 €, gjegjësisht në vlerë 11.310,00 €. Ndërsa që nga Raporti Përfundimtar i punëve të kryera në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” nr.V-558 dt. 19.08.2013, i përpiluar po ashtu nga menaxherja e projektit tani e akuzuara H. D. drejtuar organeve kompetente në komunë e Obiliqit, vërtetohet se e njëjta duke vepruar në përputhje me përgjegjësitë e saj si menaxhere e projektit ka konstatuar se në këtë projekt janë punuar të gjitha punimet e parapara me kontratën bazë si dhe punët shtese sipas aneks kontratës me po të njëjtin numër të prokurimit dhe se kompanisë kontraktuese të punëve, mundë ti bëhet pagesa e komplet projektit sipas kontratës bazë dhe aneks kontratës. Po ashtu, ka kërkuar nga zyra e prokurimit që të formojë komision për pranimit teknik. Gjykata vlerëson se tani e akuzuara H. D. edhe përmes këtyre raporteve që gjithashtu janë administruar në cilësinë e provës në këtë çështje penale, ka vepruar në përmbushje të detyrave të përcaktuara në cilësinë e menaxherës së projektit, duke i përpiluar të njëjtat mbështetur në raportet e më hershme, në të cilat me të drejtë ka konstatuar se punët janë realizuar në pajtim me kushtet e përcaktuara në kontratë, si dhe pas pranimit të të dhënave laboratorike në të cilat rezultonte se këto të dhëna janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë, ka vlerësuar se OE-së kontraktues duhet të ju bëhet pagesa kundrejt punëve të kryera.

Nga Raportet e pranimit, të datë 09.10.2013, 05.09.2013, 12.08.2013 të përpiluara nga menaxherja e projektit tani e akuzuara H. D. për të zyrari autorizues S. S., vërtetohet se njëjta po ashtu duke vepruar në përputhje me detyrat e saj të caktuara në vendimin mbi emërim në cilësinë e menaxheres së projektit, ka përcjellur në vazhdimësi dinamikën e punimeve dhe bazuar në dokumentet e nevojshme ka përpiluar raportet e pranimit në të cilat ka konstatuar se OE “B. C.” i ka kryer punimet në kohë, sipas planit dinamik dhe brenda rregullave teknike të ndërtimit. Gjykata vlerëson se edhe nga këto raporte vërtetohet fakti se të njëjtat janë përpiluar bazuar në gjendjen në teren, në të cilin e akuzuara H. D. ka dalur vazhdimisht, dhe në raportet e laboratorit për kontrollin e materialeve ndërtimore B. C. C., për përmbajtjen e rrem të të cilave e akuzuara H. D. nuk e ka ditur dhe nuk ka pasur arsyen e mjaftueshme për të dyshuar në përmbajtjen e të njëjtave, duke marrur parasysh obligimin e OE –ve për sjelljen e këtyre të dhënave dhe faktin se serioziteti i këtij laboratorit vërtetohet me licencën që të njëjtit i është lëshuar për zhvillimin e kësaj veprimtarie. Se vërtetë e akuzuara H. D. ka vepruar në përputhje me përgjegjësitë si menaxhere e projektit duke qenë vazhdimisht në përcjellje të realizimit të projektit vërtetohet dhe nga deklarata e të akuzuarve tjerë, siç është rasti e pohimit të të akuzuarit Sh. K. i cili në deklaratën e dhënë në polici dt.31.03.2014 dhe prokurori dt.22.09.2014 e ka pohuar faktin se mbikëqyrësja e projektit tani e akuzuara H. D. ka qenë çdo ditë për të i mbikëqyrur punimet të cilat ka zhvilluar OE “B. C.”.

Nga "Situata Parë dhe Përfundimtare e Punëve Shtesë në Projektin "Asfaltimi i Rrugëve Rurale" datë 19.08.2013, e përpiluar nga OE "B C" për të cilën është nënshkruar tani i akuzuari B A dhe autoritet Kontraktues Komuna e Obiliqit për të cilën është nënshkruar menaxheria e projektit tani e akuzuara H D, vërtetohet se akuzuara H D gjithnjë duke vepruar në përputhje me përgjegjësit caktuar në vendimin mbi emërimin pas daljes në teren dhe bazuar në dokumentet e nevojshme, përfshirë edhe në raportet nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore BC "B C" ka konstatuar natyrën e punimeve të kryera dhe çmimin e tyre, sa i përket punëve shtesë për kryerjen e të cilave është lidhur aneks kontrata e dt.15.08.2013.

Nga Vendim, mbi caktimin e komisionit për pranim teknik, nr.III-371, dt.20.08.2013, për projektin, "asfaltimi i rrugëve rurale, me numër të prokurimit", vërtetohet se anëtar të komisionit të lartcekur janë caktuar: H R, N G dhe Xh K dhe se të njëjtit do të pregatisin raport me shkrim lidhur me realizueshmerin e këtij projekti. Ndërsa që nga Raporti i këtij komisioni për pranim teknik të projektit "Asfaltimi i Rrugëve Rurale" nr. 614, të dt.20.08.2013 konstatohet se Komisioni për pranimin teknik të projektit "Asfaltimi i rrugëve rurale" pasi ka bërë inspektimin, matjen dhe verifikimin e punëve të kryera në trase, ka shqyrtuar dhe verifikuar ditarin e punimeve ndërtimore dhe krahasimin me paramasën dhe përshkrimin e projektit baze sipas kontratës dhe aneks kontratës, konstaton se: Projekti "Asfaltimi rruge rurale" gjegjësisht implementimi i projektit të kontraktuar me kontratën e lartcekur si dhe implementimi i aneks kontratës është punuar në mënyrë profesionale dhe në harmoni me rregulla teknike të ndërtimit si dhe duke respektuar planin dinamik të paraparë në kontratë. Gjykata vlerëson se edhe përmes këtij raporti vërtetohet se komisioni për pranimin teknik të projektit duke vepruar në përmbushje të detyrave të tyre të përcaktuara me vendimin mbi emërimin, kanë dalur në teren, dhe pasi që kanë bërë matjet e nevojshme dhe duke u mbështetur në dokumentet e paraqitura, përfshirë edhe rezultatet e Laboratorit për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B C", mbi cilësinë dhe trashësinë e asfaltit dhe zhavorrit, kanë arritur në përfundimin se punët janë kryer sipas projektit "Asfaltimi i Rrugëve Rurale" dhe po ashtu në përputhje me përgjegjësit e tyre të njëjtin i'a kanë dorëzuar zyrës së prokurorit, DPIUKP dhe drejtorit të AP-së.

Nga Raportet e Institutit të materialeve ndërtimore dhe konstruksioneve, N.SH. "I" në Prishtinë, datë 11.03.2014, gjegjësisht:

- Nga raporti lidhur me rrugën e fsh. Breznicë, lagja "Koskovik" L=250 m, konstatohet se trashësia mesatare e mostrave të nxjerra është 4.72 cm(8.0cm), kompaktësia mestare e mostrave të nxjerra është 95.93% (min.97%), përqindaj mesatare e bitumenit është 4.95 %, ndërsa që mesatarja e rrjedhshmërisë është 2.44 mm( mestaria:2.0-4.0)mm.

- Nga raporti lidhur me rrugën fsh. Kozaricë L=340m konstatohet se trashësia mesatare e mostrave të nxjerra është 4.55 cm(8.0cm), kompaktësia mestare e mostrave të nxjerra është 90.15% (min.97%), përqindja mesatare e bitumenit është 5.09 %, ndërsa që mesatarja e rrjedhshmërisë është 2.44 mm ( mestaria:2.0-4.0)mm.

- Nga raporti lidhur me rrugën fsh. Kozaricë L=560m konstatohet se trashësia mesatare e mostrave të nxjerra është 4.72 cm(8.0cm), kompaktësia mestare e mostrave të nxjerra është 95.93% (min.97%), përqindaj mesatare e bitumenit është 4.95 %, ndërsa që mesatarja e rrjedhshmërisë është 2.44 mm ( mestaria:2.0-4.0)mm.

- Nga raporti lidhur me rrugen fsh. Kozaricë, lagjia "Dardhishtë" L=400-100m konstatohet se trashësia mesatare e mostrave të nxjerra është 5.07cm (8.0cm), kompaktësia mestare e mostrave të nxjerra është 94.06% (min.97%), përqindja mesatare e bitumenit është 4.75 %, ndërsa që mesatraja e rrjedhshmërisë është 1.52mm ( mestaria:2.0-4.0)mm.

- Nga raporti lidhur me rrugen fsh. Kozaricë, lagja e "Fanakëve" L=845 m konstatohet se trashësia mesatare e mostrave të nxjerra është 4.71cm (8.0cm), kompaktësia mestare e mostrave të nxjerra është 93.02% (min.97%), përqindja mesatare e bitumenit është 4.82 %, ndërsa që mesatraja e rrjedhshmërisë është 2.00mm ( mestaria:2.0-4.0)mm.

- Nga raporti lidhur me rrugën fsh. Kozaricë, lagja e "Mavriq" L=600 m konstatohet se trashësia mesatare e mostrave të nxjerra është 4.54cm (8.0cm), kompaktësia mestare e mostrave të nxjerra është 90.77% (min.97%), përqindja mesatare e bitumenit është 4.96 %, ndërsa që mesatraja e rrjedhshmërisë është 1.87mm ( mestaria:2.0-4.0)mm.

- Nga raporti lidhur me rrugën fsh. Kozaricë, fsh."Llazarevë" L=347 m m konstatohet se trashësia mesatare e mostrave të nxjerra është 5.19cm (8.0cm), kompaktësia mestare e mostrave të nxjerra është 95.27% (min.97%), përqindja mesatare e bitumenit është 4.39 %, ndërsa që mesatarja e rrjedhshmërisë është 2.13mm ( mestaria:2.0-4.0)mm.

- Nga raporti lidhur me rrugën fsh. Kozaricë, lagja e "Kurtshëve" L=290m konstatohet se trashësia mesatare e mostrave të nxjerra është 5.59cm (8.0cm), kompaktësia mestare e mostrave të nxjerra është 90.41% (min.97%), përqindja mesatare e bitumenit është 5.19 %, ndërsa që mesatraja e rrjedhshmërisë është 2.77mm ( mestaria:2.0-4.0)mm.

Ndërsa që nga raport plotësimi i ekspertizës dt.12.01.2015 i institutit N.SH "I " lidhur më demin konstatohet se bazuar në kushtet e përcaktuar në kontrata dhe aneks kontratë të lidhur në mes K.K. Obiliq dhe Operatorve ekonomik "D i " dhe "B c ", rrjedh se në rastin konkret ç'do rrugë e shtruar nga këta Operator Ekonomik mund të konsiderohet si dem, pasi që asnjë rrugë nuk është shtruar në përputhje me kushtet e përcaktuar me kontratë dhe aneks kontratë. Gjykata vlerëson se përmes këtyre raporteve të administruara në cilësinë e provave materiale, vërtetohet bindshëm fakti se realizimi i projekteve rrugore nuk është bërë në përmbushje të kriterëve përcaktuara në kontratat që janë lidhur për realizimin e tyre dhe se të gjitha këto mospërputhje konsistojnë në tamponë, trashësinë dhe përbërjen e asfaltit të shtruar. Ndërsa që lëshime të tilla nuk janë vërtetuar sa i përket gjerësisë dhe gjatësisë së rrugëve dhe elementeve shoqëruese për identifikimin e të cilave nuk është e nevojshme realizimi testeve të tilla laboratorike, gjegjësisht se të njëjta do mund të identifikoheshin edhe nga vetë menaxherit i projektit dhe komisioni për pranim teknik të projektit të caktuar nga Autoriteti Kontraktues, gjatw mbikëqyrjes se punimeve, gjegjësisht kontrollit për pranimin teknik të të njëjtit.

Nga Fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes shihet gjendja faktike e rrugëve të shtruara nga OE të lartë cekur, në perimetrat kryesor siç janë trashësia e asfaltit, pastaj gjerësia e rrugëve por edhe vete gjendja e rrugëve të shtruara, të cilat në pamjen e jashtme ishin në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuar në kontratë, duke mos pasur mundësi që identifikimi i mangësive të vërehej në mënyrë tjera përveç përmes testeve laboratorike, e që të njëjtat rezultojnë se janë në përputhje me kriteret e përcaktuar në kontratë, pra që formalisht gjendje rrugëve në pamjen e jashtme dhe rezultate laboratorike përputheshin në tërësi, duke mos lenë mundësi dyshim tek tani të akuzuarit H R dhe H D në cilësinë e Menaxherve të projekteve dhe të akuzuarve H R , Xh K , N G R H , B P në cilësinë e anëtarëve të komisioneve për pranim teknik, se vërtetë cilësia e asfaltit dhe përbërja e tij nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuar në kontratat, gjegjësisht në aneksë kontratën respektive.

Nga Raportet e policisë për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe atë: Raporti i datës 26.12.2014, raport për hyrje-daljet e thirrjeve telefonike dhe SMS-të për numrat 044/ [redacted] dhe 045/ [redacted], për periudhën kohore prej 10.08.2013 deri 15.08.2013, me përmbajtje të përshkruar si në pjesën gjyquese të këtij aktgjykimi, vërtetohet se nga përmbajtja e SMS të shkëmbyer në mes tani të akuzuarve S[redacted] K[redacted] dhe B[redacted] K[redacted] lidhur me projektin “asfaltimi i rrugëve rurale” tani e akuzuara H[redacted] D[redacted] atëherë në cilësinë e menaxheres së projektit, dhe të akuzuarit H[redacted] R[redacted], N[redacted] G[redacted] dhe Xh[redacted] K[redacted] në cilësinë e anëtarëve të komisionit për pranim teknik të projektit, nuk janë referuar në çfarëdo mënyrë gjatë bisedes në drejtim të ndonjë veprimi inkriminues, e nga e cila do rezultonte se të njëjtit janë në dijeni apo bashkëpjesëmarrës në veprimet inkriminuese të tani të akuzuarave B[redacted] K[redacted] dhe Sh[redacted] K[redacted]. Po ashtu, duke ju referuar përmbajtjes se SMS të shkëmbyer siç është SMS e dt.10.08.2013, ora 23:26, ku B[redacted] K[redacted] i shkruan të akuzuarit Sh[redacted] K[redacted] “Per Obiliq 5.5 cm trash dhe naj kun ku ska shpija ngat 4 cm tej 4.5 cm. Duhet ekip mbrapa mejher pas asfaltit mja ngre matrialin me kacia mja afru asfaltit. Qe mos muvra sa kem qit asfalt...” bindshëm vërtetohet faktise tani e akuzuara H[redacted] D[redacted] atëherë në cilësinë e menaxheres së projektit, ka mbikëqyrur vazhdimisht punimet, për cka edhe i akuzuari B[redacted] K[redacted] e udhëzonte të akuzuarin Sh[redacted] K[redacted] që menjëhere pas vendosjes së asfaltit, të i vendoset material anash që të mos vërehet trashësia e ti dhe se e njëjta jo vetëm nuk ka vepruar në bashkëpunim me tani të akuzuarit e lartcekur, por as që ka qenë në dijeni për veprimet inkriminuese të të njëjtëve, ndryshe në një situat tjetër do ishte i pakuptueshme e jologjik udhëzimi i të akuzuarit B[redacted] K[redacted] për të akuzuarin Sh[redacted] K[redacted] që të veprohet “mejher” me vendosjen e materialit anash asfaltit që mos me kuptu sa është trashësia e asfaltit të shtruar, duke pas parasysht faktin se e akuzuara H[redacted] D[redacted] ishte e vetmja zyrtare e caktuar nga autoriteti kontraktues për mbikëqyrjen e punimeve dhe njëherit ishte në dijenin për kushtet e përcaktuara në kontratë për realizimin e projektit “asfaltimi i rrugëve rurale”. Po ashtu, nga këto transkripte vërtetohet fakti se e akuzuara H[redacted] D[redacted] dhe të akuzuarit H[redacted] R[redacted], N[redacted] G[redacted] dhe Xh[redacted] K[redacted] në cilësinë e anëtarëve të komisionit për pranim teknik të projektit, edhe përkundër kryerjes se detyrave konform aktit të emërimit në cilësitë e lart referuara, duke qenë se janë përballur me angazhim e tillë të vendosur nga ana e të akuzuarave B[redacted] A[redacted], Sh[redacted] K[redacted] dhe B[redacted] K[redacted] në arritje e përfitimit të kundërligjshëm përmes paraqitjes fakteve të rreme, ka qenë e pamundur për të njëjtit që të kuptojnë se vërtetë projekti nuk është duke u realizuar, përkatësisht nuk është realizuar në përputhje me kushtet e caktuar në kontratën e lidhur për realizimin e të njëjtit.

Nga përgjigjja nr.183/2015 e dt.30.11.2015 e Komisionit Rregullativ të Prokurorimit Publik, vërtetohet se i njëjti ka sqaruar se procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë mund të përdoret për dhënien e kontratës për punë ose shërbime shtesë që nuk janë përfshirë në kontratën fillestare me kushte që operatori ekonomik i njëjtë i ekzekuton shërbimet ose punë shtesë që nuk mund të ndahen në mënyrë teknike ose ekonomike, megjithëse si të ndara janë tejet të nevojshme për kompletim, si dhe vlera nuk është më shumë se 10% e vlerës së kontratës fillestare. Po ashtu edhe sa i përket kontratës për punë ose shërbime të reja që përbëhen nga përsëritje e punëve ose shërbimeve të ngjashme që janë besuar Operatorit Ekonomikë që ka ekzekutuar kontratën fillestare me kushtet që punët janë në përputhje me projektin bazë, kjo procedurë mund të përdoret vetëm brenda dy viteve pas përfundimit të kontratës fillestare si dhe vlera nuk duhet me qenë më shumë se 10% e vlerës së kontratës fillestare. Gjykata vlerëson se

edhe përmes kësaj përgjigje të dhënë nga një organ, që në kuadër të përgjegjësive, ka të përfshirë edhe monitorimin, mbikëqyrjen dhe kontrollimin e zbatimit të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovë, vërtetohet bindshëm fakti se tani të akuzuarit H. D., A. S., M. K. dhe A. P., në të gjitha veprimet e tyre kanë vepruar në përputhje të plotë me ligjin e prokurimit publike i cili ka përcaktuar qartë kriteret e nevojshme për zhvillimin e procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, dhe se të lartë referuarit kanë zhvilluar procedurën dhe kanë lidhur aneks kontratën në përmbushje të plotë të këtyre kushteve.

Nga Mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar, Ekspertiza Financiare nga Eksperti Financiar Gjqësor M. P. e datës 15.10.2014 rezulton se i njëjti ka konstatuar se hartimi i dosjes së tenderit dhe procesi i vlerësimit të ofertave është bërë në pajtim me nenin 27, 59 dhe nenin 60 të LPP-së nr.04/L-042, po ashtu, ka konstatuar se në aneksë kontratë lidhur me projektin “vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fsh.Breznicë-lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fsh. Kozaric” janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së si dhe të dispozitave të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik gjegjësisht nenit 35 par.2 në par.2.4 të LPP-së pasi që autoritet publike kanë filluar implementimin e kontratës së re pa kaluar dy vite pas përfundimit të kontratës fillestare. Me tutje ka konstatuar se punimet në segmentin “Koskovik” në gjatësi prej 250m, janë realizuar pa lidhur fare kontratë dhe pa i zbatuar procedurat e tenderimit të parapara me ligj. Ndërsa që në vlerësimin përfundimtar konstatohet se sipas dokumentacionit në shkresat e lëndës dhe provave të ofruara, eksperti financiar ka konstatuar që të dyja projektet e lartë cekura “asfaltimi i rrugëve rurale” për të cilin punimet i ka kryer OE “B. C.” nga Gj. dhe projektin “vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fshatin Breznice – lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë” për të cilin punimet i ka kryer OE “D. I.” nga P., nuk janë implementuar në përputhje me kriteret të përcaktuara në Kontrata dhe se këtë në masë të madhe e kanë mundur komisionet teknike të cilat nuk kanë vepruar në mënyrë të drejtë dhe kanë lejuar kompanitë në fjalë të kryejnë punimet jashtë kriterëve të përcaktuara me kontratë”. Gjykata e ka vlerësuar këtë prove materiale dhe të njëjtës nuk ja fali besimin meqenëse përpiluesi i saj eksperti financiar M. P. nuk ka sjellur arsye të mjaftueshme lidhur me përfundimet e arritura, ndërsa që përfundimet e arritura janë rrjedhojë e mbështetjes mbi premisa të gabuara, si është rasti kur i është referuar kontratës së lidhur për realizimin e projektit “vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fsh.Breznicë-lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fsh. Kozaricë” si aneks kontratë, edhe pse vërtet është realizuar me kontratë të veçantë dhe se neni 35 i LPP-së nuk gjen zbatim në këtë rast, po as që ka qenë kontestuese kjo rrethanë në këtë çështje penale, ndërsa që aneksë kontrata është lidhur për projektin “asfaltimi i rrugëve rurale”. Mirëpo përtej këtyre kontradiktave që vë në dyshim seriozitetin e kësaj ekspertize, edhe në kushtet e ekzistimit të një aneks kontrate lidhur me atë projekt, përsëri një interpretim i tillë është gabuar pasi që kriter është periudha brenda dy vitesh dhe jo pas kalimit të kësaj periudhe kohore, gjë që vërtetohet edhe nga përgjigja e KPRK-së nr.183/2015 e dt.30.11.2015 e administruar në cilësinë e provës në këtë çështje penale. Po ashtu, konstatimi se punimet e realizuara në projektet e lartëcekura nuk janë realizuar sipas kriterëve të përcaktuar në kontratë nuk është kontestues, pasi që kjo është vërtetuar nga raportet e institutit N.SH. “I”, mirëpo konstatim se komisionet teknike nuk kanë vepruar në mënyrë të drejtë kur kanë lejuar kryerjen e punimeve jashtë kriterëve të caktuar me kontratë, jo vetëm nuk është shoqëruar me asnjë provë, mirëpo edhe në vetë vete është i gabuar pasi që nuk janë komisionet për pranim teknik ato që lejojnë kryerjen e punimeve, mirëpo që në përfundim të tyre, vlerësoj nëse të njëjtat janë realizuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë, e që në këtë çështje penale nuk është vërtetuar se të njëjtat nuk kanë

vepruar në përmbushje të kushteve të përcaktuar në aktin e emërimit. Gjykata vlerëson se me këtë rast është e rëndësishme të nënvizoj faktin se interpretimi i ligjit është kompetence ekskluzive e gjykatës, prandaj konstatimi i ekspertit financiar përveç që është i gabuar në përmbajtje është edhe tejkalim i kompetencave dhe fushës për të cilën e mban thirrjen “Eksperti Financiar Gjyqësor”. Gjykata rikujton faktin se eksperti financiar angazhohet dhe nevoja për angazhimin e të njëjtit për ligjet me mungesën e njohurive të gjykatës për shkenca natyrore, teknike apo financiare dhe në funksion të ndriçimit dhe të vërtetimit të fakteve relevante të një çështje penale. Për rrjedhojë të kësaj që u tha më lart, edhe pse konstatimin e ekspertit se hartimi i dosjes se tenderimit është bërë në përputhje me nenin 27 të LPP-së, e vlerëson si të saktë, të njëjtin e gjen jo relevant meqenëse vlerësimet të kësaj natyre, si u tha më lart, janë përtej kompetencës së tij dhe fushës që ai mbulon nga titulli që mban.

Nga shkresa nr.V-2017 dt. 13.03.2014 përpiluar nga menaxheri i kontratës tani i akuzuari Xh K konstatohet se me fillimin e punimeve në rrugën “Asfaltimi i rrugës Breznicë-Koskovik” në gjatësi prej 1650m, banoret kanë qenë të revoltuar pasi që sipas tyre gjatësia e rrugës së shtruare duhet të ishte 1900 m dhe kanë kërkuar takim me k dhe ndërkohë në vend punishte ka ardhur k i atëhershëm i k tani i akuzuari M K dhe e ka urdhëruar verbalisht tani të akuzuarin Xh K që të vazhdojë punimet në këtë rrugë për 250 m edhe pse e njëjta nuk ka qenë e paraparë në kontratën fillestare. Po ashtu, aty konstatohet se i akuzuari Xh K ka qenë mbikëqyrës i rrugës në gjatësi L-1900 m, punimet e së cilës kanë përfunduar me dt.14.11.2012. Gjykata e ka vlerësuar këtë provë sa i përket besueshmërisë, rëndësisë dhe vlerës provuese, mirëpo të njëjtës nuk ja fali besimin duke qenë se e njëjta nuk është në lidhje me asnjë provë tjetër, por përkundrazi është në kundërshtim me prova tjera nga të cilat vërtetohet se procedurat e tenderimit lidhur me pjesë e rrugës në gjatësi prej 250m janë zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe se e njëjta është përfshirë në kuadër të projektit “vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fsh.Breznicë-lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fsh. Kozaric”, edhe pse edhe nga të akuzuarit tjerë është pohuar fakti se kjo gjatësi rruge është shtruar nga OE fituese pasi që e njëjta është shpallur fitues dhe para se të kalojë afati i ankesave, mirëpo kjo në asnjë formë nuk mund të provoj faktin se ky veprim është bërë si pasojë e urdhërit të tani të akuzuarit M K për të akuzuarin Xh K. Më tutje, gjykata e gjen të rëndësishme të referoj faktin se një nga parimet të cilat qëndron në themel të procedurës penale është parimi *in dubio pro reo* i parashikuar nga nenin 3 i KPRK-së, sipas të cili “çdo dyshim për faktin çmohet në favor të të pandehurit”, dhe nevojës që gjykata të bindet plotësisht në ekzistimin e gjendjes faktike në të cilin e mbështet vendimin, ndërsa që në rastin konkret gjykata vlerëson se jemi në kushtet e zbatimit të këtij parimi pasi që shkresa e lartcekur propozuar të administrohet në cilësinë e provës përmes të cilës organi i akuzës ka pretenduar ta provoj një fakt të tillë, nga gjykata është vlerësuar si i pamjaftueshëm për të argumentuar dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka qenë i urdhëruar nga tani i akuzuari M K, dhe së në ato kushte ka vepruar siç u përsëritur më lart. Gjykata vlerëson se një shkresë e tillë, nga përmbajtja dhe mënyra e marrjes së saj, ka mundur të shërbejë vetëm si një njoftim për të krijuar një dyshim të arsyeshëm se në veprimet e këtyre dy të akuzuarve ka elemente inkriminuese, mirëpo një provë e tillë nuk mund të qëndroj as si provë e vetëm dhe as si provë vendimtare, për të provuar ekzistencën e veprimeve inkriminuese nga tani të akuzuarit M K dhe Xh K, ndërkohë që organi i akuzës nuk ka propozuar administrimin e ndonjë prove tjetër për të vërtetuar ekzistencën e elementeve inkriminues në veprimet e këtyre të akuzuarve.

Nën dritën e gjendjes faktike të vërtetuar më mësipër mbi provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk vërtetohet konsumimi i të gjithë elementëve të veprave penale për kryerjen e të cilave janë akuzuar M K , Xh K , H R , N G , R H , B P , H D , A S , dhe A P . Sipas Kodit Penal të Kosovës që të ndodhemi përpara figurës së veprës penale për efekte të përgjegjësisë penale kërkohet verifikimi i bashkekzistencës së katër elementeve të veprës penale, që janë: se pari, objekti, pra të ekzistojë nga pikëpamja materiale vepra penale, të jetë cenuar një marrëdhënie shoqërore e mbrojtur nga ligji penal, duke ardhur objektivisht një pasojë kriminale nga veprimi ose mosveprimi shoqërisht i rrezikshëm, që në rastin konkret, është prezantimi i rremë i raportit të llogarive sa i përket veprës penale, Mashtrimi në detyrë nga neni 426 i KPRK-se dhe thyerja e rregullave të vendosura nga aktet ligjore ose nënligjore, që normojnë detyrat e nëpunësit shtetëror apo publik, sa i përket veprës penale, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 i KPRK-së; se dyti, subjekti që në këtë çështje penale, janë tani të akuzuarit që në cilësinë e personave zyrtar, të cilët janë akuzuar se kanë thyere rregullat, gjegjësisht kanë bërë prezantim të rremë të raportit të llogarive; së treti, e rëndësishme për përcaktimin e figurës së veprës penale është mënyra se si ajo është kryer, mekanizmi i ndodhjes së ngjarjes, provueshmëria e veprimeve apo mosveprimeve me pasoja penale të subjektit apo subjekteve që e kanë kryer atë, që në rastin konkret është pretenduar që është bërë prezantimi i rremë të raportit të llogarive, përmes paraqitjes së raporteve; keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar me përpilimin e të njëjtëve; lidhja e aneks kontratën në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi apo duke urdhëruar kryerjen e punëve jashtë kontratës, dhe së katërti, shkaku/shkaqet apo motivet që kanë çuar në kryerjen e veprave penale nga tani të akuzuarit, gjegjësisht dashja e të akuzuarve që duke tejkalluar detyrën zyrtare, gjegjësisht duke bërë prezantimin e rremë të raportit të llogarive të siguroj përfitimi të dobisë pasurore për OE “D I ” dhe “B c ”.

Nga kjo pikëpamje, Gjykata vlerëson se në rastin konkret mungojnë pikërisht elemente të rëndësishëm të figurës së veprës penale, më të dalluarit, ana objektive dhe ana subjektive. Në këtë çështje nuk rezulton e provuar se të akuzuarit të cilët akuzohen për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 par.1 lidhur me neni 31 të KPRK-se, kanë tejkalluar kompetencat e tyre ose nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare të tyre, e po ashtu të akuzuarit të cilët janë akuzuar për veprën penale “mashttrimi në detyrë” nga neni 426 par. 3 lidhur me par.1 përkatësisht par. 5, lidhur me par. 3 dhe par. 1, si dhe lidhur me neni 31 të KPRK-së pasi që të njëjtit nuk kanë bërë prezantimin e rremë të raportit të llogarive apo në ndonjë mënyrë tjetër ta kenë vënë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme. Sa i përket të akuzuarve M K dhe Xh K gjykata nuk ka administruar asnjë provë që bindshëm do e vërtetonte faktin se ka ekzistuar një urdhër verbal nga tani i akuzuari M K dhe se duke vepruar sipas këtij urdhrit verbal i akuzuari Xh K , ka kërkuar që të kryhen punimet shtesë nga Operatori Ekonomik “D I ” edhe për 250 metra tjera, jashtë kontratës së lartcekur. Nuk ka qenë kontestues fakti se 250m rruge janë shtruar nga ana e OE fituese, ende papërfunduar procedurat e tenderimit, gjegjësisht duke mos e pritur përfundimin e periudhës së ankesave, mirëpo kjo nuk vërteton faktin se e njëjta është urdhëruar nga tani i akuzuari M K për një veprim të tillë, duke marrur parasysh edhe faktin që procedura e tenderimit, në hartimin e dosjes së tenderit dhe procesi i vlerësimit të ofertave është bërë në pajtim me LPP-në, me ç’rast OE fituese ka pasur çmimin me të lirë, kriter ky vendimtar në përcaktimin e fituesit në një procedurë tenderimi. Po ashtu, edhe sa i përket të akuzuarit H R , gjykata ka vërtetuar bindshëm faktin se rruga në gjatësi prej 250 m është



përfshirë në kuadër të projektit “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë” prandaj pretendimi së është shtruar jashtë kontratës “Asfaltimi i rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik” është i saktë, dhe në këtë pikë gjykata ka vlerësuar se nuk ka asgjë kontestuese, ndërsa që edhe nga vetë i akuzuari H. R. është pohuar fakti se ekziston një mospërputhje në kohë në mes veprimeve të ndërmarra nga OE fituese dhe raportimeve nga i njëjti, dhe krejt kjo për shkak se OE fituese ka shtruar asfaltin para përfundimit të procedurave të tenderimit, gjegjësisht duke mos e prititur përfundimin e afatit të ankesave, me përfundimin e te cilit do fillonte zbatimi i projektit, duke qenë i akuzuari H. R. në cilësinë e menaxherit të projektit. Gjykata e ka aprovuar mbrojtjen e të akuzuarit H. R. pasi që përtej këtyre mos përputhjeve në kohë, nuk është vërtetuar se i njëjti përmes veprimeve të tilla në kushtet e dashjes i ka siguruar ndonjë përfitim ekonomik OE fituese dhe se nga raportet e përpiluara nga i njëjti, vërtetohet se të njëjtat janë mbështetur në gjithë dokumentacionin e nevojshme, dhe në veçanti në raportet testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B. C., në të cilat konstatohej se trashësia, cilësia, ngjeshmëria, fraksioni dhe përbërja e materialeve të përdorura është në pajtim me parametrat e përcaktuara në kontratë. Po ashtu edhe sa i përket të akuzuarve H. D., A. S., M. K. dhe A. F. lidhur me veprën Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, gjykata nga provat e administruara nuk ka vërtetuar se këta të akuzuar me ndonjë veprim ose mosveprim duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i kanë tejkaluar kompetencat e tyre ose nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare të tyre me rastin e lidhjes se aneks kontratës për punë shtesë lidhur me projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale”. Ndërsa që gjykata thekson se për të u gjendur në kushtet e konsumimit të veprës penale Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 i KPRK-së përveç dashjes përfundimtare (dolus eventualis) si dhe asaj të drejtpërdrejtë (dolus directus), kërkohet dashjen e posaçme (dolus specialis), “dashje të nxjerrjes së përfitimit të kundërligjshëm për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër. Nga tërësia e provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor, po ashtu nuk është vërtetuar se i akuzuari M. K. në cilësinë e k. të k., i akuzuari A. S. në cilësinë e d. të P.N.K.Z dhe i akuzuari A. P. në cilësinë e M. të Prokurorit në Komunën e O me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për OE “B. C.” e kanë shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar duke tejkaluar kompetencat e tyre ose duke mos i përmbushur detyrat zyrtare të tyre. Gjithashtu edhe sa i përket të akuzuarve Xh. K., H. R., N. G., R. H., B. P., H. D., është vërtetuar se të njëjtit në cilësinë e menaxherit të projektit apo të anëtarëve të komisioneve për pranim teknik të projekteve tani më të referuar shume herë në këtë aktgjykim, kanë vepruar në plotëni në përputhje me autorizimet ligjore gjegjësisht detyrimet e caktuar në vendimin mbi emërimin e tyre në këto cilësi, së të njëjtit raportet respektive i kanë përpiluar pas daljes në terren dhe bazuar në dokumentet e kërkuar si kontrata, aneks kontrata, raportet e punës se mbikëqyrësit të këtij projekti, ditarit të punimeve, përfshire edhe raportet me të dhënat laboratorike, në përmbajtjen e të cilave konstatohet se të gjitha punimet janë kryer në bazë dhe në përputhje me kontratën, gjegjësisht aneksë kontratën. Po ashtu, nga provat e administruara nuk është vërtetuar se përpilimi i raporteve është ndërmarrë me qëllim që të ju sigurohet përfitimi i dobisë pasurore për OE “D. I.” dhe “B. c.” (dashja direktë), apo se të njëjtit kanë qenë të vetëdijshëm se për shkak të veprimit apo mosveprimit të tyre mund të shkaktohet pasoja e përfitimit material për OE e lartcekura dhe se janë dakorduar që kjo pasojë të shkaktohet (dashja eventuale). Gjykata vlerëson se ana subjektive, pra qëllimi-dashja e të akuzuarve, duhet të vlerësohet e

lidhur ngushtë me anën objektive të veprës dhe konkretisht me veprimet konkrete të akuzuarve Xh. K., H. R., N. G., R. H., B. P. dhe H. D. nëse të njëjtit kanë pasur si qëllim që përmes raporteve të paraqitura të i sjellin përfitim të kundërligjshëm OE "D. I." dhe "B. C." përmes përpilimit të raporteve se kinse të njëjtit i kanë përmbushur detyrimet sipas kontratave të lidhura. Nga analiza e këtyre rrethanave objektive, të vërtetuara nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, siç janë se pari, mos përmbushja e kushteve të përcaktuara në kontrata lartcekura lidhur me projektet "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë-Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë" dhe "Asfaltimi i rrugëve rurale", konsiston pikërisht sa i përket cilësisë së materialeve të përdorura, përqindjes së zhavorrit, ngjeshmërisë së tamponit dhe asfaltit për qenien e të cilave në përputhje me kontratën ishte obligim i OE-ve kontraktuese që të kryenin testet e nevojshme laboratorike; se dyti, se të njëjtat janë kryer nga një instituti i licencuar laboratorik siç ishte Laboratori për Kontrollimin e materialeve ndërtimore B "B. C."; se treti, fakti se projektet e lartpërmendura në gjitha pjesët tjera të cilat janë të përshtatshme dhe si të tilla lëshimet eventuale mund të konstatohen edhe nga vetëm dalja në teren, pa qenë e nevojshme angazhimi laboratorëve të specializuar, janë përmbushur në përputhje me kushtet e përcaktuar në kontratë, siç janë gjerësia e gjatësia e rrugëve, pastaj pjesët anësore, gypave të betonit të vendosur në vendet e caktuar, gjerësisë dhe gjatësisë së kanaleve që përfshihen në kuadër të projekti rrugor; dhe se katërti, fakti se të gjitha këto raporte janë në përputhje me datat e raporteve të lëshuara nga Laboratori për Kontrollimin e materialeve ndërtimore B "B. C." e në të cilat siç u tha rezultatet e konstatuara ishin në përputhje me perimetrat e përcaktuara në kontrata respektive. Prandaj nisur nga këto fakte të provuara bindshëm me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata vlerëson se nuk mund të qëndroj element i dashjes, pra se të njëjtit nuk e kanë ditur dhe nuk kanë mundur ta dinë se raporti me të dhëna nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B. C." nuk reflekton gjendjen reale të cilësisë së rrugëve të shtruara nga OE kontraktuese. Po ashtu vlerëson se nuk mund të qëndroj elementi i prezantimit të rrem të raportit të llogarive, përderisa këto raporte e përpiluara nga tani të akuzuarit, janë përpiluar në bazë të raporteve të lëshuara nga laborator i licencuar siq ishte Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B. C." për kryerjen e analizave të tilla dhe se të dhënat në këto raporte, ishin në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontrata lidhur për realizimin e projekteve të lartcekura. Po ashtu, nuk mund të qëndroj qëllimi i përvetësimit të përfitimit pasurortë kundërligjshëm për vete a për tjetrin, meqenëse nuk ekziston dijenia mbi natyrën e rreme apo të pasaktë të raportit të llogarive, që siq është vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor të akuzuarit Xh. K., H. R., N. G., R. H., B. P. dhe H. D. nuk kanë qenë në dijeni se vërtete pasqyruara në raportet e Laboratorit për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B. C." nuk pasqyrojnë gjendjen reale të rrugëve të shtruara nga O "D. I." dhe "B. C."

Gjykata, gjithashtu ka vlerësuar faktin se mbrojtja e të gjithë të akuzuarve për të cilët është marrë aktgjykim lirues, në të gjitha fazat e procedurës është e njëjtë, mbrojtje e cila ka qenë logjike dhe në përputhje të plotë me provat materiale të administruara në këtë çështje penale. Veçanërisht sa i përket të akuzuarave H. R., N. G., R. H., B. P., H. D., që të gjithë e kanë theksuar faktin se në raportet e përpiluara qoftë në cilësinë e menaxherit të kontratës apo pjesë e komisionit për pranim teknik të projekteve, janë bazuar në raportet nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B. C.", të dhënat në lidhje me

nënshtresat e rrugëve, shtresat e asfaltit, cilësinë e materialeve të përdorura, përqindjen e zhavorit, ngjeshmërinë e tamponit dhe asfaltit, të cilat kanë qenë në përputhje me kriteret e përcaktuar në kontratë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e prokurorit të prokurorisë speciale lidhur me të akuzuarit Xh. K., M. K., H. R., N. G., R. H., B. P., H. D., A. S., dhe A. P., për të cilët kjo gjykata ka vendosur lirimin e të njëjtëve, mirëpo këto pretendime i ka gjetur të pabazuar meqenëse gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk janë administruar prova që do vërtetonin se të njëjtit janë kryerës të veprave penale për të cilat akuzohen, dhe për të cilën një arsyetim më i hollësishëm është dhënë më sipër në të këtë aktgjykim.

## II

Sa i përket pjesës gjyqësore të këtij aktgjykimi, Gjykata pas administrimit të provave në seancat e mbajtura gjatë këtij shqyrtimit gjyqësor, dhe vlerësimit të tyre, lidhur me të akuzuarit B. A., Sh. K., B. K., E. S. dhe S. K., është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetojë se në veprimet e këtyre të akuzuarve manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale, Mashtrimi nga neni 335 par. 5, par. 3 dhe par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të akuzuarit E. S. dhe S. K., gjegjësisht veprës penale, Mashtrimi nga neni 335 par. 3 dhe par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, për të akuzuarit B. A., Sh. K., B. K.,.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga dëshmitarët dhe provat materiale dhe atë:

Nga dëshmia e dëshmitarit A. K. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor vërtetohet se i njëjti ka punuar në laboratorin e kompanis "B. C." nga viti deri në muajin dhjetor të viti 2015, në cilësinë e udhëheqësit të këtij laboratorit. Më tutje dëshmitari ka sqaruar mënyrën e marrjes së mostrave për zhvillimin e atesteve, ku ka theksuar se marrja e mostrave bëhet me kërkesën e pronarit të kompanis, ndërsa që është ekipi i laboratorit i ashtuquajtur "ekipi i asfaltit" ose puntorët e kompanise të cilët dinë të punojnë me makinen që pren asfaltin, dhe se janë të njëjtit që bëjnë marrjen fizike të mostrave për testim. Lidhur me këtë pohim dëshmitari pasi është ballafaquar me deklaratën e dhënë në Polici dt.08.04.2014, në të cilën kishte deklaruar se fillimisht kërkesën e bënë punëkryerësi apo ndonjë institucion i interesuar për testimin e materialeve që kërkon, pastaj me lejen e tyre dalin në vendin e ngjarjes, bëjnë matjen gjemoetrike, modulën e ngjeshjes, nëse kërkohet edhe testimin e materialeve para asfaltimit dhe punohet sipas metodave SKEN", dëshmitari është përgjigjur se kur ka thënë dalin në vendin e ngjarjes e ka pasur fjalën për kompanin në përgjithësi, ndërsa që për matjen gjeomekanike-moduli i ngjeshjes e ka bërë vetë dëshmitari dhe se i njëjti është shënuar ashtu siç ka dalur në aparat, dhe se të gjitha vlerat janë shënuar në raport, ndërsa që nuk është në kompetencën e laboratorit të interpretoj të dhënat apo të sygjeroj se a duhet të shtypet asfalti apo zhavori. Më

tutje dëshmitari ka pohuar sa laboratori ku ai ka punuar ka kryer analizat në projektin më titull “asfaltimi i rrugëve rurale” në Komunën e Obiliqit, dhe se fillimisht nuk i është kujtuar se nga kush ka qenë i kontraktuar për kryerjen e analizave laboratorike, mirëpo pas ballafaqimit me deklaratën e dhënë në Polici dt.08.04.2014, ku kishte deklaruar se kryerja e analizave laboratorike ishte kontraktuar prej kompanis “B C”, është përgjigjur se mund të jetë konstatuar gabim sepse ka qenë kompania “B C” që ka kontraktuar këto analiza, ndërsa që cila kompani e ka nënshkruar kontratën në cilësin e punëkryerësit nuk e ka njohuri. Po ashtu ka shtuar se nuk ka njohuri për mënyrën e caktimi të distancës për marrjen e mostrave pasi që nuk ka dalur në vendin e ngjarjes, ndërsa që kur është ballafaqur me deklaratën e dhënë në Polici dt.08.04.2014 në të cilën kishte deklaruar se “çdo moster që e kanë marrur sa i përket distancës dhe vendit të marrjes është marrur me lejen e organit mbikqyrës...” ka deklaruar se laboratori nuk e cakton vendin e marrjes së mostrave, dhe se nuk ka qenë prezent me rastin e marrjes së mostrave mirëpo ka theksuar se sa i përket modulit të matjes personalisht i ka bërë matjen dhe se rezultate kanë qenë të sakta sipas aparatit të ngjeshjesë. Gjykata e ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, dëshmi të cilës pjesërisht i’a fal besimin, meqenëse e njëjta në disa drejtime është në kundërshtim me deklaratat që i njëjti ka dhënë në procedurën paraprake, prandaj rreth pikave kundërtëne, gjykata vlerëson se deklarata e dëshmitarit e dhënë në procedurën paraprake është dëshmi objektive dhe e sinqert, dëshmi e cila është në përputhje edhe me provat materiale, dhe se po ashtu duke qenë se koha e dhënies së saj është me e shkurtër nga koha e ngjarjes, dëshmitari ka përshkruar me saktë dhe i ka qëndruar më besnik gjithë veprimeve të bëra në momentin e pikërisht. Prandaj nga ky dëshmitar vërtetohet bindshëm fakti se Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B “B C” është kontraktuar nga OE “B C” me pronar tani të akuzuarin B A për kryerje të atesteve lidhur me trashësinë e shtresës së zhavorit dhe përbërjes dhe trashësisë së asfaltit.

Nga Kontrata nr.XIII-141 e dt.03.12.2013 me nr.prokurorimit , më përmbajtje të përshkruar si në pjesën liruese të këtij aktgjykimi, vërtetohet se në të njëjtën janë përcaktuar të gjitha parametra e realizimit të projektit “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë–Lagja Koskovik dhe asfaltimit të rrugës në fshatin Kozaricë”, të fituar nga nga OE “D -I” me pronar tani të akuzuarin E S dhe se në bazë të nenit 9 të kësaj kontrate është paraparë që koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të i siguroj kontraktuesi, që sipas neni 1 par.3 të kontratës ishte OE kontraktues, në rastin konkret OE “D -I”. Gjykata vlerëson se përmes kësaj kontrate, vërtetohet fakti se OE “D I” me pronar të akuzuarin E S dhe organin mbikëqyrës të projektit tani të akuzuarin S K, ka marrur detyrimin që përkundërtë shumë së caktuar të parave të realizoj projektin e lartpërmendur, në të cilën kanë qenë të specifikuar qartë parametrat në bazë të cilëve do duhej të realizohet projekti dhe se në bazë të kontratës ka qenë në detyrimin e së njëjtit sigurimi koston dhe çdo gjë rreth testimit të materialeve, për të cilat testimi është forma e vetme e sigurimit se të njëjtat janë përdorur në sasi dhe cilësi në përputhje me kushtet e përcaktuar në kontratë.

Nga Plani për menaxhimin e kontratës e datës 14.12.2012, i përshkruar si në pjesën lirues të këtij aktgjykimi i nënshkruar edhe nga tani i akuzuari S, në cilësin e pronarit të OE “D c” gjykata vlerëson se vërtetohet se i njëjti ka qenë prezent dhe në dijeni për të gjitha ecurin e punëve lidhur me projektin e lartpërmendur dhe se i njëjti në këtë cilësi i ka nënshkruar edhe këtë dokument lidhur me realizimin e projektit të lartreferuar.

Nga Raporti përfundimtar i komisionit për pranim teknik të projektit Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë” i dt. 09.10.2013, me përmbajtje të përshkruar si në pjesën liruese të këtij aktgjykimi, vërtetohet po ashtu se i njëjti është përpiluar bazuar në të dhënat e ofruar nga tani të akuzuarit E S dhe S K , përmes raporteve të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B ”B C ”, të cilit ishin në dijeni se të njëjta nuk janë në përputhje me gjendjen reale të rrugëve të shtruara, duke i vënë kështu në lajthim me anë të paraqitjes së rreme të fakteve e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten, anëtarët e komisionin për pranim teknik të cilët duke u bazuar në këto të dhëna, kanë konstatuar se projekti është realizuar në tëresi dhe në përputhje me kushtet e parapara në kontrat, dhe OE “D -I ” mund të i bëhet pagesa për punët që formalisht ishin të realizuara.

Nga Kontrata e dt.24.05.2013 dhe Aneks Kontrata dt. 15.08.2013 me numër të Prokurimit , po ashtu me përmbajtje të përshkruar si në pjesën liruese të këtij katgjykimi vërtetohet se në të njëjtat janë përcaktuar të gjitha parametra e realizimi të projektit “Asfaltimi i rrugëve rurale”, të fituar nga nga OE “B C ” me pronar tani të akuzuarin B A dhe se në bazë të nenit 9 të kontratës së lartreferuar, neni ky i zbatuar edhe për aneks-kontratë është paraparë që koston e testimi si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të i siguroj kontraktues, që sipas neni 1 par.3 të kontratës është OE kontraktues palë në kontratë, në rastin konkret OE “D -I ” me pronar tani të akuzuarin B A .

Nga Ditari mbi punën e kryer nga OE “D -I ” në fshatin Breznicë, lagja “Koskovik” L=250 nga data 03 deri 14.12.2012, dhe për rrugë në fshatin Kozaricë L=560 m nga data 15.04 deri 10.08.2013, vërtetohet bindshëm fakti se i akuzuari E S ka qenë gjithëkohës i pranishëm gjatë zhvillimit të punimeve, siç rezulton nga nënshkrimet e të njëjtit në rubrikën Realizuesit-Udhëheqës punësh, i cili është nënshkruar në secilën faqe të së njëjtit.

Nga Fatura e “D -i ” e datës 09.10.2013 vërtetohet se përshkrimi është bërë për Pagesën e realizimit të projektit: Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë –lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë, për shumën 26,270.75 €. Ndërsa që nga Urdhër Blerje e datë 14.10.2013 dhe Urdhëri për Pagesë i datës 18.10.2013 vërtetohet se kompanisë “D -i ” për rrugën e shtruar në fshatin Kozaricë L=560, i është paguar shuma e mjeteve 26,270.75 €. Po ashtu nga Faturën e “D -i ” e datës 16.04.2013 vërtetohet se përshkrimi është bërë për Pagesën e realizimit të projektit: Situacioni i parë për vazhdimin e asfaltimit të rrugës në Breznicë L=250 m, për shumën 18,683.54 €, ndërsa që nga Urdhër Blerje e datë 19.04.2013 dhe Urdhër për Pagesë i datës 23.04.2013 vërtetohet se kompanisë “D -i ” për rrugën e shtruar në fshatin Breznicë, lagja Koskovik L=250 i është paguar shuma e mjeteve 18,683.54 €, se kinse e njëjta është e shtruar në projektin pasues. Gjykata vlerëson se nga këto fatura të administruara në cilësinë e provës vërtetohet fakti se tani të akuzuarit E S dhe S K , edhe pse në dijeni se këto fatura nuk reflektojnë gjendje reale të punëve të realizuara në projektin “Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë”, të njëjtit pas paraqitje se fakteve të rreme përmes raporteve testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B ”B C ”, më qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, kërkojnë nga autoriti kontraktues komuna e Obiliqit, pagimin e shumave të parave për punë të cilat nuk i kanë kryer duke vendosur kështu në lajthim të njëjten që të

ndërmarr veprimet në dëm të pasurisë së saj. Ndërsa që nga urdhër blerjet dhe urdhër pagesat vërtetohet se të njëjtteve ju janë paguar shumat si në faturat e lartcekura.

Nga Raportet testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B C", të përshkruar si pjesën lirues të këtij aktgjykimi, vërtetohet se Autoriteti Kontraktues Komuna e Obiliqit është vënë në lajthim nga të akuzuarit E S, S K lidhur me projektinprojektit "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë", dhe të akuzuarit B A, Sh K, B K lidhur me projektin "Asfaltimi i rrugëve rurale", ashtu që të faktet e rrem të cilat mbanin këto raporte, më qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ja kanë paraqitur autoritetit kontraktues Komunës së Obiliqit, duke shtyrë të njëjtën të bëjë veprim të dëmshëm kundër pasurisë së saj, përmes pagesave në shumat e caktuara në kontrata e lidhura për realizimin e këtyre projekteve.

Nga "Situata Parë dhe Përfundimtare e Punëve Shtesë në Projektin "Asfaltimi i Rrugëve Rurale" datë 19.08.2013, vërtetohet se e njëta është përpiluar nga OE "B C" e cila është nënshkruar nga tani i akuzuari B A dhe autoritet Kontraktues Komuna e Obiliqit e cila është nënshkruar nga menaxheria e projektit tani e akuzuara H D, e në cilën situacion janë evidentuar punimet e kryera sipas ankes kontratës dhe shuma e çmimit për to. Gjykata vlerëson se edhe përmes kësaj provë vërtetohet bindshëm fakti se i akuzari B A ka qenë gjithë kohën i pranishëm gjatë realizimit të punimeve, dhe në dijeni të plotë se projekti nuk është realizuar në pajtim me kushtet e përcaktuara në kontrat, ndërsa që të dhënat nga Raportet testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B C" nuk pasyqrojnë gjendjen reale të cilësisë së materialit të përdorur sa i përket sasis dhe cilësisë së zhorit dhe asfaltit, mirëpo të njëjtat më qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ja paraqet tani të akuzuarës H D, duke e vënë në lajthim të njëhten, me ç'rast edhe evidenton si punë të kryera, punë që në të vëretet nuk ishin realizuar në përmbushje me kushtet e përcaktuara në kontratë.

Nga Kërkesa e OE "B C" e paraqitur nga përfaqësuesi i saj tani i akuzuari B A e datës 02.08.2013, me të cilën i është drejtuar Komunës së Obiliqit, me besimin se autoriteti kontraktues është i kënaqur nga realizimin i punës në projektin: "Asfaltimi i rrugëve rurale-Obiliq", dhe ka kërkuar që pagesa të iu bëhet në llogarinë bankare të cekur si në faturën bashkangjitur, bashkë me situatën e parë të punimeve. Gjykata vlerëson se edhe nga kjo kërkesë e administruar në cilësinë e provës materiale, vërtetohet bindshëm fakti, se i akuzuari B A, duke paraqitur fakte të rrejshme, në situatën të cilën ja ka shoqëruar kërkesës se lartcekur, me qëllim të fitimit të kundërligjshëm të dobis pasurore, **kerkonë** nga autoritet kontraktues pagimin e shumave për punë të cilat nuk i kishte kryer fare në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë.

Nga Lista e stafit të kualifikuar që do të angazhohet për realizimin e projekti "Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë", dorëzuar nga O "D -i", në Komunën e Obiliqit, vërtetohet se tani i akuzuari S K me kualifikim inxhinier i ndërtimtarisë konstruktive, ishte caktuar nga ky operator si menaxher i projektit kryesor. Ndërsa që nga Vendimi i OE "D -i" i datës 22.10.2012 vërtetohet se Drejtori i Ndërmarrjes Ndërtimore "D -i" tani i akuzuari E S ka emëruar S K me kualifikim si më lartë, si drejtues dhe përgjegjës për ekzekutimin e projektit

“Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë”. Gjykatat vlerëson se edhe përmes kësaj prove vërtetohet bindshëm fakti se S. K. ka qenë i angazhuar në cilësinë e menaxherit të projektit të lartcekur, dhe në kushtet e dashjes nuk ka vepruar në pajtim me kushtet e përcaktuara në kontratë, dhe se vazhdimisht autoritetit kontraktues gjegjësisht organit mbikëqyrës tani të akuzuarit H. R. i ka paraqitur raporte të rreme mbi ecurinë e punës, përfshirë këtu edhe të dhënat nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B. B. C., duke i shtyrë të njëjtin që të përpilojë raporte bazuar në këto të dhëna dhe se bazuar në këto raporte i njëjti në bashkëpunim me të akuzuarin E. S., i janë drejtuar autoritetit Kontraktues-komunës së obiliqit me kërkesë për pagimin e shumave, me çka kanë arritur ta vënë në lajthim për pagimin e shumave të kërkuara.

Nga Raporti i punëve të kryera në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” që mban datën 05.08.2013, Raporti i punëve të kryera në aneksin e projektit “Asfaltimi i rrugëve rurale” që mban datën 19.08.2013 dhe Raporti Përfundimtar i punëve të kryera në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” që mban datën 19.08.2013, me përmbajtje si në pjesën liruese të këtij aktgjykimi vërtetohet se duke u bazuar në të dhënat e rreme të paraqitura nga tani të akuzuarit B. A., Sh. K. dhe B. K., organi mbikëqyrës tani e akuzuara H. D. ka konstatuar se në implementimin e projektit “Asfaltimi i rrugëve rurale” është punuar në mënyrë profesionale dhe në harmoni me rregulla teknike të ndërtimit, me ç’rast nga e njëjta është rekomanduar pagimi i shumave 73.803.61 euro gjegjësisht 11.310,00 euro, dhe formimi i komisionit për pranim teknik, e që të akuzuarit e lartcekur, pas vënies në lajthim të organi mbikëqyrës tani e akuzuara H. D., duke u bazuar në raportet e lartcekura, i janë drejtuar autoritetit Kontraktues Komunës së Obiliqit, përmes faturave të administruar në cilësinë e provës në këtë çështje penale, për pagimin e shumave të lartcekura, me çka edhe kanë arritur që duke e vënë të njëjtën në lajthim, të veprojnë në dëm të pasurisë së saj, duke ua paguar shumën në vlerën që është pretenduar.

Raportet e pranimit, të datë 12.08.2013, 05.09.2013 dhe 09.10.2013, nga zyrtari pranues tani e akuzuara H. D. me përmbajtje të përsëritur si në pjesën liruese, vërtetohet se duke u bazuar në të dhënat e rreme të paraqitura nga tani të akuzuarit E. A., Sh. K. dhe B. K., përmes raporteve të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B. B. C., nga e njëjta është konstatuar se kompania ndërtimore “B. C.” në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” punimet i ka përfunduar në tërësi.

Nga “Situata Parë dhe Përfundimtare e Punëve Shtesë në Projektin “Asfaltimi i Rrugëve Rurale” datë 19.08.2013, më përmbajtje si në përshkrimin në pjesën liruese të këtij aktgjykimi, i nënshkruar edhe nga tani i akuzuari B. A. në cilësinë e pronarit të O.E. “B. C.” vërtetohet bindshëm fakti se i akuzuari B. A. ka qenë gjithë kohën i pranishëm gjatë realizimit të punimeve, dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, e në bashkëpunim me të akuzuarin Sh. K. në cilësinë e mbikëqyrësit të projektit, nuk e ka realizuar kontratën në pajtim me kushte të përcaktuara në të njëjtën, ndërsa që autoritetit kontraktues i ka paraqitur fakte të rreme, siç janë Raportet testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B. B. C. të cilat nuk pasqyrojnë gjendjen reale të cilësisë së materialit të përdorur sa i përket sasisë dhe cilësisë së zhavorit dhe asfaltit.

Nga Raporti komisionit për pranim teknik të projektit “Asfaltimi i Rrugëve Rurale” dt.20.08.2013 me përmbajtje të përshkruar si në pjesën liruësë të këtij aktgjykimi, vërtetohet se duke u bazuar në të dhënat e rreme të paraqitura nga tani të akuzuarit B A , Sh K dhe B K , përmes Raporteve testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B ”B C ”, komisioni ka konstatuar se implementimi i projektit të kontraktuar me kontratën e lartcekur si dhe implementimi i aneks kontratës është punuar në mënyrë profesionale dhe në harmoni me rregulla teknike të ndërtimit. Gjykata vlerëson se të njëjtit duke paraqitur faktete e rreme, kanë arritur që komisionin për pranimin teknik të projektit “Asfaltimi i rrugëve rurale” të vënë në lajthim dhe atë me qëllim të përfitimit të kundërligjshme, në at mënyrë që bazuar në këtë raport të njëjtit kanë kërkuar nga autoriteti kontraktues pagimin e shumës së caktuar si në kontratë dhe aneks kontratë, siq vërtetohet dhe nga faturat e paraqitura, më të cilat i janë drejtuar autoritetit kontraktues për pagimin e të njëjtave.

Nga Kërkesa e OE “B C ” e paraqitur nga përfaqësuesi i saj B A e datës 02.08.2013, për Komunën e Obiliqit, vërtetohet që akuzuari B A edhe pse në dijeni që punët nuk janë kryer në pajtim me kushtet e përcaktuar në kontrat lidhur me projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale”, kërkon që pagesa të bëhet në llogarinë bankare të cekur si në faturë, duke i bashkangjitur situatën e parë të punimeve si dhe faturën për situatën e parë, të dy këto që në përmbajtje kishin të dhenat të rreme, pasi që punët e kryera nuk ishin në përputhje me konstatimet gjegjësisht shumat të cilat ky i akuzuar i pretendonte, e edhe për kundra kësaj kërkon kryerjen e pagesës nga autoriteti kontraktues duke e vënë në lajthim të njëjtën.

Nga Fatura e “B C ” e datës 07.10.2013 shohim se përshkrimi është bërë për, Asfaltimi i rrugëve rurale-Obiliq”, për shumën 15,794.25 €, ndërsa nga Urdhër Blerje e datë 09.10.2013 dhe urdhëri për pagesë i datës 10.10.2013 konstatohet kompanisë “B C ” për rrugët e shtruara në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” i është paguar shuma e mjeteve 15,794.25 €. se kinse të njëjtat janë shtruar në përputhje me kontratën. Po ashtu nga Fatura e “B C ” e datës 20.08.2013 shohim se përshkrimi është bërë për, Asfaltimi i rrugëve rurale-Obiliq”, për shumën 14,542.53 €, ndërkohë që nga Urdhër Blerje e datë 22.08.2013 dhe Urdhër Për Pagesë i datës 09.09.2013 shihet se kompanisë “B C ” për rrugët e shtruara në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” i është paguar shuma e mjeteve 14,542.53 €. Gjithashtu nga Fatura e “B C ” e datës 20.08.2013 shohim se përshkrimi është bërë për, Asfaltimi i rrugëve rurale-Obiliq”, për shumën 36,486.39 € ndërsa që nga Urdhër Blerje e datë 05.09.2013 dhe Urdhëri Për Pagesë i datës 09.09.2013 shihet se kompanisë “B C ” për rrugët e shtruara në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” i është paguar shuma e mjeteve 36,486.39 €. Nga Fatura e “B C ” e datës 20.08.2013 shohim se përshkrimi është bërë për, Asfaltimi i rrugëve rurale-Obiliq”, për shumën 9,605.75 €, ndërsa që nga Urdhër Blerje e datë 05.09.2013 dhe Urdhër Për Pagesë i datës 09.09.2013 shihet se kompanisë “B C ” për rrugët e shtruara në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” i është paguar shuma e mjeteve 9,605.75 €; Nga Fatura e “B C ” e datës 02.08.2013 shohim se përshkrimi është bërë për, Asfaltimi i rrugëve rurale-Obiliq”, për shumën 73,803.61 €, e po ashtu nga Urdhër Blerje e datë 12.08.2013 dhe Urdhër Për Pagesë i datës (12.08.2013) shihet se kompanisë “B C ” për rrugët e shtruara në projektin “Asfaltimi i rrugëve rurale” e në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratë i është paguar shuma e mjeteve 73,803.61 €. Nga të gjitha këto fatura, të administruara në cilësinë e provës, gjykata vlerëson se vërtetohet bindshëm fakti që tani të akuzuarit B A , Sh K dhe B K , duke vepruar me dashje direkte, e në bashkëkryerje në kundërshtim me kushtet



e përcaktuara në kontratën, me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për organizatën e biznesit OE "B C" në këto fatura kanë pretenduar se kinse kanë realizuar punët, që në të vërtet nuk i kanë bërë, ndërsa që pasi që kanë bërë paraqitjen e rrejshme të fakteve përmes raporteve testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B C", i janë drejtuar autoritetit kontraktues komunën e Obiliqit me qëllim që e njejta të ndërmarr veprimin në dëm të pasurisë së saj duke u paguar shumat e pretenduar në faturat e lartcekura. Ndërsa që nga Urdhër Blerjet dhe urdhërat për pagesë, vërtetohet fakti se e gjendur në kushtet e lajthimit, Komuna e Obiliqit ua ka bërë pagesen sipas shumave të preteuduara në fatuar respektive.

Nga Raportet e Institutit të materialeve ndërtimore dhe konstruksioneve, N.SH. "I" në Prishtinë, datë 11.03.2014, më përmbajtje si në pjesën liruese të këtij aktgjykimi vërtetohet bindshëm fakti se realizimi i projektet rrugore "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë" nga OE "D I" dhe "Asfaltimi i rrugëve rurale" nga OE "B C" nuk është bërë në përmbushje të kriterëve përcaktuara në kontrata ashtu që të akuzuarit B A, Sh K dhe B K duke vepruar me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm lidhur me realizimin e projektit të lartcekur "Asfaltimi i rrugëve rurale", shtresën e asfaltit që ishte paraparë sipas kontratës dhe aneks kontratës të jetë 8cm, e kanë shtruar në vetëm 4.94 cm, ndërsa që sipas kontratës dhe aneks kontratës trashësia e zhavorit duhej të ishte së paku 20-30 cm, e kanë shtruar në vetëm 6.40 cm, dhe po ashtu sipas kontratës dhe aneks kontratës kompaktësia mesatare e këtyre rrugëve duhej të ishte jo nën minimumin 97%, dërsa që nga analiza e instituti të lartcekur ka rezultuar të jetë 92.28%. Gjithashtu edhe të akuzuarit E S dhe S K duke vepruar së bashku, dhe me qëllim të sigurimit të përfitimit të kundërligjshëm lidhur me projektin "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë" kanë vepëruar në at mënyrë që trashësin e Zhavorrit e kanë shtruar në 7.18 cm, kurse në bazë të kontratës është dashur të jetë së paku 25 cm, trashësin e asfaltit e kanë shtruar në mesatare vetëm 4.17cm. dhe po ashtu derisa kompaktësia mesatare e këtyre rrugëve nuk duhej të ishte sipas nën minimumin e lejuar 97%, ka rezultuar të jetë 95.93%. ndërsa qëpërmes raporteve të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B C", kanë pretenduar së projektete e lartcekuar i kanë realizuar në tërësi sipas kushteve të përcaktuara në kontratat respektive.

Nga Fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes vërtetohet gjendja faktike e rrugëve të shtruara nga OE të lartë cekur në perimetrat kryesor siç janë trashësi e asfaltit në rrugët e shtruara që nga matja fizike e te trashësisë së të cilit rezulton të jetë 4cm, si dhe plasaritjet në këto rrugë. Gjykata edhe përmes kësaj prove, vërteton se realizimi i projekteve nuk ka qenë konform kushteve të përcaktuar në kontratat respektive.

Nga Raportet e policisë për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe atë: Raporti i datës 26.12.2014, raport për hyrje-daljet e thirrjeve telefonike dhe SMS-të për numrat 044/ dhe 045/ per periudhen kohore prej 10.08.2013 deri 15.08.2013, vërtetohet se i akuzuari B K nga numri i tij i telefonit 044/ ka zhvilluar komunikime me të akuzuarin Sh K me numër të telefoni 045/, siq është SMS e dt.10.08.2013, ora 23:26, ku i akuzuari B K i shkruan të akuzuarit Sh K "Per obiliq 5.5 cm trash dhe naj kun ku ska shpija ngat 4 cm tej 4.5 cm. Duhet ekipa mbrapa mejher pas asfaltit mja

ngre materialin me kacia mja afu asfaltit. Qe mos muvire sa kem qit asfalt...". po ashtu SMS e dt.11.08.2013, ora 12:53, në të cilën i akuzuari i B K i shkruan të akuzuarit Sh K "Sa ka pranuar pun shtes A Dhe a kem punu ne realitet pun ajo ta di sakt muhabetin", ndërsa që i akuzuari Sh përgjigjet "11310 euro janë pranuar, 10 perqin te tyre janë punuar", ndërsa që i akuzuari B K i shkruan përseri të akuzuarit Sh K "10% i kontratës esh 15 mij eu. Ejo 11 mij eu" ndërkohë që ky i fundit i përgjigjet se "Jo 10 perqin të kont. Por janë realizuar 10 perqin të punve shtes." Gjykata vlerëson se nga përmbajtja e transkripteve të dalura nga masat e fshehta, vërtetohet se i akuzuari Sh K duke vepruar në bashkpunim me të akuzuarin B K ka qenë vazhdimisht i udhëzuar nga i njëjti i cili ka marrë pjesë aktive në punimet e zhvilluara nga Operatori Ekonomik "B C" – si fitues formal i tenderit, dhe se i akuzuari Sh K ka vepruar plotësisht në bazë të këtyre udhëzimeve në lidhje trashësin dhe sasin e Zhavorit dhe Asfaltit që duhet shtruar në ato rrugë, e cila konstatohet të jetëshumë në nivelin e përcaktuar me kontratë, e gjitha më qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, fillimisht përmes veprimeve në teren duke e vënë në lajthim menaxheren e projektit tani të akuzuarin H D dhe anëtarët e komisionit pranues tani të akuzuarit H R, N G dhe Xh K siq vërtetohet nga fjalija "Duhet ekipa mbrapa mejher pas asfaltit mja ngre materialin me kacia mja afu asfaltit. Qe mos muvire sa kem qit asfalt...", e duke vazhduar me paraqitjen e raporteve testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B C", me cka arrin që duke vënë në lajthim autoritetin kontraktues-Komunën e Obiliqit, ta nxitë qëllimisht të kryej pagesat e pretenduara në dëm të pasurisë së saj.

Lidhur me të akuzuarit E S, S K dhe Sh K, gjendjen faktike gjykata pjesërisht e ka vërtetuar edhe nga vetë deklaratat e të njëjtëve, pasi që i akuzuari E S në deklaratën e dhënë në polici dt.30.03.2014, kur është pyetur se a ka qenë mbikqyrës i punimeve në projektin "Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë" është përgjigjur, po kam qenë, ndërkohë që në ansjëmoment nuk ka përmendur faktin e pretenduar më vonë se punët në realizimin e projektit ja ka besuar një kompanie tjetër. Ndërsa që i akuzuari S K në deklaratën e dhënë në prokurori dt.01.04.2014 ka deklaruar se ka qenë si projekt menaxher ndërsa nuk ka qenë mbikëqyrës i këtyre punimeve, ani pse po në të njëjten deklarat ka pohuar se as që e ka ditur se është caktuar projekt menaxher, ndërsa që përtej ndryshimeve sematike, të dy këto thirrje kanë domethenie të njëjtë dhe i referohen personit që është përgjegjës për mbikqyrjen e kryerjes së punëve dhe i cili për të gjitha hollësit duhet të i raportoj Autoritetit Kontraktues. Po ashtu edhe u akuzuari Sh K, ka pranuar së ka qenë në cilësin e organi mbikëqyrës, lidhur me realizimin e projektit "Asfaltimi i rrugëve rurale" dhe ka qenë në dijeni se projekti nuk është realizuar në pajtim me kushtet e përcaktuar në kontratë sai përket trashësisë së zhavorit dhe asfaltit, mirëpo ka pretenduar se veprimet e tilla i ka kryer tani i akuzuari B K.

Gjykata vlerëson se për tu gjendur përballë veprës penale të mashtrimit në kushtet e cilësuar nga neni 335 të KPRK-së, ligjëvenësi ka paraparë vërtetimin e ekzistences e paraqitjes së rreme të fakteve apo fshehjen e fakteve, që në rastin konkret të akuzuarit E S, S K, B A dhe Sh K, duke mos i kryer punimet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, që siç është vërtetuar nga raportet e ekspertizës laboratorike nga laboratorit I të administruar në cilësin provës në këtë çështje penale, trashësia e Zhavorrit, trashësia e asfaltit dhe kompaktësia mesatare e këtyre rrugëve ka rezultuar jo në përputhje me kushtet e përcaktuar

në kontrata e lartreferuara, përmes raporteve testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B C", të njëjtit kanë vënë në lajthim autoritetin kontraktues duke pretenduar se trashësia, cilësia, ngjeshmëria, fraksioni dhe përbërja e materialeve të përdorura është në pajtim me parametrat e përcaktuara në kontrat. Pra nga provat e administruar është vërtetuar bindshëm fakti se të njëjtit me veprimet e tyre kanë konsumuar elementin e paraqitje se rrem të fakteve. Po ashtu që të jemi në kushtet e kryerjes së kësaj vepre penale duhet të ekzistoj qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm i dobisë pasurore për veten ose tjetrin, gjykata vlerëson se pikërisht duke mos i realizuar projektet në përputhje me kushtet e përcaktuar në kontratë në një ndryshim aq të madhë në mes kushteve të kontraktuara dhe atyre të realizuara dhe pretendimi se projektet janë kryer në përmbushje të plotë të kushteve të përcaktuara në kontrata duke ofruar të dhëna për të cilat të njëjtit e kanë ditur se janë të rrejshme siç janë raportet testuese, të lëshuara nga Laboratori për kontrollin e materialeve ndërtimore B "B C" dhe përmes fatuarave duke kërkuar pagimin e shumave në emer të realizimit të projekteve siq janë faturat e administruara në cilësin e provave materiale në këtë çështje penale, me çka kanë konsumuar edhe këtë elemnet të figurës se vepres penale të mashtrimit nga neni 335 i KPRK-së. Gjithashtu e nevojshme për të konstituuar figurar e vepres penale të mashtrimit është që për shkak të fshehjes së fakteve, është vënë në lajthim subjekti i cili është objekt mashtrimi gjegjësisht të ketë shkaktuar dëmi material ndaj vetës me veprimin e ndërmarrë në kushtet e të qenit I lajthitur. Në këtë rast si pasoj e fakteve të rreme të paraqitura nga të akuzuarit, organi mbikëqyrës dhe komisioniet pranuese të gjendura në kushtete e lajthimit, kanë përpiluar raporte në të cilat kanë konstatuar së OE "D I" dhe "B C" kanë realizuar projektet "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimit i rrugës në fshatin Kozaricë" dhe "Asfaltimi i rrugëve rurale" në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë dhe se pikërisht mbeshetur në këto raporte, OE të lartreferuara ju janë paguar në tanësi shumat e parapara në kontratat e lidhur për realizimin e këtyre projekteve siq vërtetohet nga urdhër pagesat e administruara në cilësin e provave materiale në këtë çështje penale. Njëashtu meqenëse jemi përpara vepres penale të mashtrimit në kushte cilësuese sa i përket dy elementeve, është e rëndësishmë, të ju referohemi të njëjtave, kështu par 3 i neni 335 të KPRK-së parasheh që për të qenë në kushtet cilësuese të kësaj vepre penale duhet të vërtetohet se qëllimi i mashtrimit është përfitimi i dobisë së kundërligjshme nga fondet Publike...", ndërsa që par.5 i të njëjtit nenë parashe që rrethan cilësuese është nëse vepra penale e mashtrimit "...rezulton në dobi pasurore të kundërligjshme ose shkaktton dëm që tejkalon pesëdhjetëmijë (50.000) Euro...". Sa i përket fondeve publike, sipas neni 2 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, të njëjtat përfshinë "paratë ose pasurinë financiare të cilat pranohen, janë nën perkujdesjen, mbahen në mirëbesim ose janë nën kontrollin e një (i) organizatë buxhetore, autoriteti publik ose ndërmarrje të kontrolluar publike...", ndërsa që po në të njëjtin ligj, në neni 1 të tij, autoriteti publike përshkruhet si "një organ, autoritet apo agjenci publike e cila në bazë të një ligji ose Rregulloreje të UNMIK-ut ushtron kompetenca ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative-publike apo gjyqësore, dhe përfshin (ii) departamentet apo pjesët ose nën njësitë e këtij organi apo autoriteti publik", elemente këto të gjitha që i përmbush tani më e dëmtuara Komuna e Obiliqit. Po ashtu, sa i përket formës cilësuese kur shuma tejkalon pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, e që në rastin konkret tani të akuzuarit B A dhe Sh K, me veprimet e tyre inkriminues në drejtim të realizimit të qëllimit kriminal, dëmin që kanë shkaktuar apo përfitimi material që kanë siguruar përmes veprimet kriminal, kalon shumën e lartë referuar. Po ashtu, nga gjendja e vërtetuar faktike është vërtetuar se të njëjtit kanë vepruar në kushtet e bashkëkryerjes, duke qenë se të gjitha veprimet e ndërmarra nga të njëjtit gjegjësisht E S dhe S

Kadriu sa i përket veprës penale, Mashtrimi nga neni 335 par. 3 dhe par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, dhe B A dhe Sh K lidhur me veprën penale Mashtrimi nga neni 335 par. 5, par. 3 dhe par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jenë të lidhura midis tyre dhe të drejtuara që të arrihet rezultati i njëjtë, që të shkaktohet pasoja e caktuar dhe se ndërmjet tyre ka ekzistuar vetëdije dhe me dëshirë kanë kryer veprimet drejte arritje së qëllimit kriminal, që duke paraqitur fakte të rreme, në mënyrë të kundërligjshme të përfitojn dobi pasurore.

Ndërkaq sa i përket të akuzuarit B K , meqë i akuzuari në prezencë dhe pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, sipas autorizimit, av. B J , e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtin edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike. Prokurori nuk ka pas vërejtje në deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë.

Ashtu që bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetojë se në veprimet e të akuzuarit B K manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par. 5, lidhur me par. 3 dhe par. 1, si dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe i shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit F S , të paraqitur në shqyrtim gjyqësor dhe në procedurën paraprake, dhe atë të paraqitur përmes mbrojtësit të tij av. E K të cilën e ka gjetur të pabazuar dhe me qëllim të ikjes së përgjegjësisë penale lidhur me veprën për kryerjen e të cilës është akuzuar. Kështu pretendimi se meqenëse e ka pasur gruan e sëmure, kryerjen e punëve ja ka besuar kompanisë “B C ” pronar i të ciles nuk e ka ditur kush ka qenë, mirëpo ai është marrur vesh me drejtorin e kompanisë “B C ” tani të akuzuarin B K , është i pabazuar pasi që i njëjti rrethanen lidhur me sëmurjen e gruas, nuk e ka përmendur në deklaratat që ka dhënë në procedurën paraprake, e që do duhej nisur së pari, nga fakti se koha kur i ka dhënë këto deklarata ka qenë më afër ngjarjes e për rrjedhojë kujtesa e tij ka qenë më e fresket dhe së dyti, duke pasur paarsyesh ndjeshmërinë e faktit të pretenduar siç është sëmurja e gruas, fakt ky aq i rëndësishëm sa që siq pretendon i akuzuari E S , e ka shtyre që realizimin e projektit të ja besoj një kompanie tjetër siq ishte “B C ”. Po ashtu gjykata e gjenë të pabazuar pretendimin që i akuzuari është marrur vesh më një kompani siq ishte “B C ” pronar i të cilës nuk e ka ditur se kush ishte?! edhe për faktin se i njëjti në deklaratën e dhënë në polici dt. 23.09.2014 e ka pohuar faktin se ka qenë në cilësinë mbikqyres i punimeve dhe se po ashtu gjatë gjithë kësaj deklarate i njëjti asnjëherë nuk e ka pretenduar faktin se është marrur vesh më kompaninë “B C ” që të i realizoj punimet lidhur me projektin të cilin OE “D I ” pronar i të cilës ishte, e kishte fituar. Po ashtu pretendimi i mbrojtësit të të akuzuarit se në veprimet e të mbrojturit të tij mungon dashja, gjykata e vlerëson të pabazuar, pasi që ana subjektive, pra dashja e të akuzuarit duhet të vlerësohet e lidhur ngushtë me anën objektive të veprës dhe konkretisht veprimet konkrete të akuzuarit E S , që siç është vërtetuar bindshëm gjatë shqyrtimit gjyqësor me provat e administruara, i njëjti ka qenë i

pranishme gjatë gjithë realizimit të projektit duke e bërë kështu të pakontestueshme faktin se i njëjti ka qenë në dijeni dhe i vetëdijshëm se të dhënat në raportin laboratorik nuk janë në përputhje me gjendjen reale të rrugëve të shtruara, e po ashtu duke ditur këto fakte të rreme, i njëjti këto të dhëna ja ka ofruar autoritetit kontraktues duke e vendosur në lajthim në funksion të kryerjes se pagesave, e me qëllim të realizimit të përfitimit të kundërligjshëm. Po ashtu, se i akuzuari ka qenë në dijeni dhe ka vepruar me dashje, vërtetohet dhe nga fakti se i njëjti evidentohet si nënshkrues në të gjitha dokumentet e komunikimit ndërmjet OE-se "D I" dhe Autoritetit Kontraktues-Komunës së Obiliqit.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit B A mirëpo të njëjten e ka gjetur të pabazuar dhe në funksion të ikjes nga përgjegjësia penale. Gjykata fillimisht gjenë të rëndësishme të thekësor faktin se e ka vlerësuar pohimin e të njëjtit të thënë në shqyrtim gjyqësor se nuk qëndron pranë deklaratave të dhëna në procedurën paraprake, pasi që i akuzuari B K e ka pranuar fajësinë, mirëpo një pohim të tillë e gjenë të paarsyeshëm, meqenëse deklaratat e të njëjtit në procedurën paraprake janë marrur në përmbushje të plotë të kushteve ligjore të përcaktuar në Kodin e Procedure Penale, ndërsa fakti se është pranuar fajësia nga i akuzuari B K , nuk do të thotë se e shkarkon nga përgjegjësia penale të njëjtin, pasi që neni 36 i KPRK-së ka përcaktuar se bashkëkryesi është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së vet. Më tutje pretendimi se ai vetëm ka nënkontraktuar kompaninë "B C" dhe se çka ka bërë e njëjta është çështje krejt tjetër, është i pabazuar, pasi që fillimisht i akuzuari B A si pronar i OE "B C" ka qenë fitues i tenderit për realizimin e projektit "Asfaltimi i rrugëve rurale", dhe ka qenë në përgjegjësin e tij realizimi i së njëjtit në pajtim me kushtet e përcaktuara në kontratë, që siq përcaktohet në nenin 4 të kontratës së dt. 24.05.2013 të lidhur për realizimin e këtij projekti, nënkontraktimi i ndonjë pjese të kontratës, nuk e liron kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës, prandaj i akuzuari B A jo vetëm i ka përkur, por edhe ka qenë i obliguar ta di dhe të ketë gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me zhvillimin e projektit të lartcekur, ndërsa që nga shkresat e administruara në cilësinë e provave, vërtetohet se i gjithëkomunikim i OE "B C" me autoritetin kontraktues-Komuna e Obiliqit është bërë nga i njëjti, siç është rasti me kërkesën e dt. 02.08.2013 përmes të cilës i njëjti i drejtohet autoritetit kontraktues, me kërkesën për kryerjen e pageses për "situatën e parë të punimeve" duke konstatuar fillimisht besimin e tij se pala tjetër është kënaqur me shërbimet në realizimin e projektit "asfaltimi i rrugëve rurale". Po ashtu, pretendimi se gjitha punët ja ka besuar të akuzuarit B K , andaj, edhe nuk ka qenë në dijeni për punën në realizimin e projektit të lartcekur, është e pabazuar edhe për faktin që i njëjti në deklaratatë dhëna në procedurën paraprake dhe atë deklaratën e dhënë në polici dt.02.04.2014 dhe deklaratën e dhënë në prokurori dt. 19.09.2014 në mënyrë të përsëritur e ka pohuar faktin se të njëjtit, tani i akuzuar Sh K i ka raportuar gjithëkohës lidhur me ecurin punëve në realizimin e projektit "Asfaltimi i rrugëve rurale" dhe po ashtu i njëjti në të dy këto deklarata asnjëherë nuk e ka përmendur faktin e pretenduar se tërë punimet ja ka besuar tani të akuzuarit B K , e as që i është referuar në çfardo konteksti këtij të fundit. Gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, vërtetohet edhe nga fakti se i njëjti një rrethanë të tillë ka filluar ta pretendoj vetëm pasi që i akuzuari B K e ka pranuar fajësinë, gjë që rezulton edhe nga vetë pohimi i të akuzuarit B A se pasi që i akuzuari B K e ka pranuar fajësinë, nuk qëndron pranë deklaratave të dhëna në procedurën paraprake ku asnjëherë nuk i është referuar rrethanës se realizimin e projektit ia ka besuar B K . Gjykata vlerëson se si rrjedhojë e pohimeve të ndryshme lidhur me rrethana

të njëjta nga ana e të akuzuarit B A , i cili thajse për të gjitha rrethanat ka dhënë përgjigje të ndryshme, jo vetëm ndërmjet deklaratave të dhëna në procedurën paraprake dhe mbrojtjes së paraqitur në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo edhe brenda deklaratës së njëjtë konstatohen përgjigje të ndryshme lidhur me të njëjtën rrethanë, dhe duke mos dhënë një arsytim të bindshëm për dallimet e tilla, e bën mbrojtjen e të njëjtit terësisht të pabazuar dhe vetëm në funksion të ikjes nga përgjegjësia penale për veprën penale për kryerjen e të cilës është akuzuar.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar edhe mbrojtjen e paraqitur nga vetë i akuzuari Sh K , dhe atë të paraqitur përmes av.S M , mbrojtje kjo të cilën e ka vlerësuar terësisht të pabazuar dhe me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet. Pretendimi i mbrojtjes se ai ka qenë i urdhëruar nga i akuzuari B K , edhe se pavarësisht faktit se i akuzuari Sh K ka qenë i angazhuar në cilësinë e menaxherit të projektit, menaxhimi i kontratës është bërë direkt nga i akuzuari B K është i pabazuar, pasi që nga nga transkriptet telefonike të administruara në cilësinë të provës në këtë çështje penale, nuk rezulton raport thjesht urdhër-dhënës dhe urdhër-marrës, mirëpo një bashkpunim i ndërsjellt i cili karakterizohet nga një angazhim reciprok në arritjen e një qëllimi të caktuar siç është në rastin konkret arritja e përfitimit të kundërligjshëm përmes paraqitjes së të dhënave të rreme, gjë që vërtetohet edhe nga përmbajtja konkrete e SMS-ve të shkëmbyer ndërmjet të akuzuarëve Sh K dhe B K , siq është rasti i SMS së dërguar nga i akuzuari B K “Sa ka pranuar pun shtes A . Dhe a kem punu ne realitet pun ajo ta di sakt muhabetin”, ndersa që i akuzuari Sh K përgjigjet “11310 euro janë pranuar, 10 perqin te tyre janë punuar”, me çka vërtetohet kështu faktin se i akuzuari Sh si menaxher i Kontratës ka pasur gjithë dijen dhe me dashje ka zbatuar konkretisht urdhëzimet e pranuar nga i akuzuari B K dhe për më tepër nga përmbajtja e SMS-ve të shkëmbyer vërtetohet fakti se veprimet konkrete në funksion të përfitimit të kundërligjshëm kanë qenë autonome nga i njëjti, dhe janë përcaktuar nga kushtet në teren, ku i njëjti ka qenë i pranishëm gjithë kohën. Po ashtu, nenin 16 i KPRK-së ka paraparë qartë kushtet e nevojshme të cilat duhet të ekzistojn për të qenë në kushtet e zbatimit të institutit të urdhërit nga lartë, e që në rastin konkret nuk plotësohen asnjëra nga to, qoftë veq e veq qoft në mënyrë komulative siç e kërkon KPRK, e po ashtu as në kushtet e vepres penale të kryer me shtrengim të paraparë më nenin 15 të KPRK-së, pasi që nga gjendja faktike e vërtetuar në këtë çështje penale i akuzuari Sh K ka vepruar më gjithë vullnetin e tij duke qenë i vetëdijshme dhe duke dashur arritjen e përfitimit të kundërligjshëm. Gjithashtu edhe pretendimi i të akuzuarit Sh K se për 10 ditë ka munguar nga vendi punës gjegjësisht se ka qenë vetëm gjysëm apo një orë, dhe se gjatë asaj periudhe janë punuar shumica e rrugëve, është i pabazuar sepse gjykata jo vetem nuk ka admistruar asnjë provë që do vërtetonte një pretendim të tilla, mirëpo ky pretendim nga i njëjti nuk është përmendur në deklaratat që i njëjti ka dhënë në procedurën paraprake, kur kujtesa e tij ka qenë më e fresket dhe mundësia për të përshkruar më sakt të gjitha rrethanat ka qenë shumë më e madhe. Mirëpo, qenia e pabazuar dhe në funksion të ikjes së përgjegjësia penale e një pretendimi të tillë, vërtetohet edhe nga vetë i akuzuari, i cili duke pretenduar mungesën e tij, të gjithë punët e zhvilluar lidhur me realizimin e projektit i vendos në atë periudh kohore, kur ky kinse ka munguar, ani pse nga transkriptete telefonike të administruara në cilësinë e provës vërtetohet se i njëjti ka qenë gjithë kohën prezent në zhvillimin e punimeve dhe ka mbajtur ditarin e punimeve, fakt ky i pohuar nga vetë i akuzuari Sh K . Po ashtu, gjykata kishte parasyesh edhe pretendimi e mbrojtjes se mos zbatimi urdhërave nga i akuzuari Sh

K... do shkaktonte humbjen e vendit të tij të punës, mirëpo ky pretendim është në kundërshtim me vetë deklaratën e dhënë nga i akuzuari Sh... në prokurori dt.22.09.2014 ku ka pretenduar se nuk ka zbatuar udhëzimet e tani të akuzuarit B... K..., duke mos vepruar ashtu siç është kërkuar prej tij, e po ashtu gjykata vlerëson se frika nga humbja e vendit të punës nuk përlligj veprimet inkriminuese të akuzuarit Sh... K... dhe as nuk mund të shërbej si kusht për përjashtimin e përgjegjesis penale të tij.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit S... K..., dhe të njëjten e ka vlerësuar të pabazuar, dhe në kundërshtim të plotë provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor. Pretendim se ai vetëm formalisht ka qenë menaxher i projektit, ndërsa që realisht emri i tij është përdorur vetëm me rastin e dorëzimit të ofertës për tender dhe se nuk pasur vendim mbi caktimin e tij menaxher i projektit, është i pabazuar dhe në kundërshtim me provat e administruar, pasi që nga vendimi i dt.22.10.2012 i OE "D...-i" i administruar në cilësinë e provës në këtë çështje penale, vërtetohet se i akuzuari S... K... është emëruar si drejtues dhe përgjegjës për ekzekutimin e projektit "Vazhdimi i Asfaltimit të rrugës në Breznicë – Lagja Koskovik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kozaricë". Po ashtu, ky pretendim është në kundërshtim edhe me vetë pohimet e të akuzuarit Sh... K..., i cili po ashtu në mbrojtjen e tij ka pohuar se nuk e ka ditur se ka qenë i caktuar në cilësinë e mbikëqyrësit të projektit, pra që ai ka qenë i caktuar në cilësinë e mbikëqyrësit nuk është kontestuese për të njëjtin, mirëpo kinse nuk e ka ditur për këtë. Po ashtu edhe pretendimi që nuk e ka ditur bie ndesh me vetë pohimet e të akuzuarit i cili në mbrojtjen e dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se përgjegjësia tij ka qenë vetëm se kur kanë aplikuar në tender, është dashur me i plotësuar kushtet. Po ashtu, edhe pretendimin e të akuzuarit se ka qenë i angazhuar në projekte tjera dhe se ka qenë e pamundur që të angazhohet edhe në këtë projekt, gjykata e vlerëson të pabazuar pasi që gjykata nuk ka administruar asnjë provë se i njëjti ka qenë i anagzhuar në projekte tjera, dhe për me teper siq u thekësua më lart në bazë të provavë të administruar i njëjti është caktuar si mbikqyrës i projektit të lartëcekur, ndërsa që pohimi se ka qenë vetëm dy herë në teren, një herë kur është bërë pastrimi i terrenit dhe një herë kur ka filluar të shtrohet zhavori në rrugë, është në funksion të ikjes së përgjegjesis penale, duke pretenduar mungesene të tij, pikërisht në pjesen e punimeve që siq është vërtetuar nga Raportet e Institutit të materialeve ndërtimore dhe konstruksioneve, N.SH. "I..." janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në kontratë.

Me rastin e vlerësimit të rrethanave të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit të dënimit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit B... A..., Sh... K..., B... K..., E... S... dhe S... K..., në kuptim të nenit 74 dhe 75 të KPRK-së, gjykata ka vlerësuar si rrethana lehtësuese, faktin se të akuzuarit nuk kanë qenë më parë të gjykuar apo të dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, pra sjelljen e mëparshme të të akuzuarve, si dhe sjelljen korrekte gjatë zhvillimit të kësaj procedure penale, rrethanën se kanë shprehur gadishmerin për përmisimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhojë e veprimeve inkriminuese, se të njëjtit janë familjarë dhe mbajtës të vetëm të familjes, ndërsa për të akuzuarin B... K... si rrethana lehtësuese mori faktin se ka pranuar fajësin që në fillimit të procedurës penale, gadishmerinë e tij për kompensim dëmi, për ti rregulluar të gjitha lëshimet e bëra gjatë zbatimit të kontratës së lidhur me Komunën e Obiliqit, si dhe gjendjen e tij të rëndë shëndetësore ku i njëjti është në pritje të transplantimit të melqisë, ndërkaq rrethana rënduese nuk ka gjetur. Andaj, bazuar në këto rrethana, gjykata ju ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimet e shqiptuara janë në përputhje me shkallën e përgjegjesisë penale të të akuzuarve, intensitetin e rrezikimit të vlerave

të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e njëjtëve, si dhe do të ndikojë në vetëdijësimin dhe përmbajtjen e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas neni 41 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale, lidhur me të akuzuarit të shpallur të pafajshëm do paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës, konform neni 454 par.1 të KPPRK-së, ndërsa që lidhur me të akuzuarit të shpallur fajtor vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë duke pasur për bazë kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale, si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarve, konform neni 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me neni 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike në kontest të rregullt civil, është marrë pasi që pala e dëmtuar nuk e ka precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, dhe duke mos ja bashkangjitur provat konkrete, ashtu që, të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht lidhur me këtë çështje, konform neni 463 par.2 të KPPRK-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.271/2015, datë 19.05.2017**

**Procesmbajtësja,**  
**Fahrije Beha**



**Kryetarja e Grupit gjyqësor-gjyqtarja,**  
**Albina Bytyçi**



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa, Departamentit për Krime të Rënda në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.